



KOMUNA E GJILANIT
OPSTINA GNJILANE / GILAN BELEDIYESI / MUNICIPALITY OF GJILAN



BULETIN

REVISTË INFORMATIVE VJETORE
NJË VIT QEVERISJE
2014



Sujqesi



Diet buxhetore

Transparencë

Arsimim cilësor

Ëzuvillim lokal ekonomik

Shëndetësi

Infrastrukturë bazike

Mirëqenie sociale për të gjithë



Botoi

KK Gjilan

Zyra për Informim

E përgatiti

Stafi i Zyrës për Informim:

Ilmi Musliu

Ibrahim Ademi

Muhamet Pajaziti

Eroll Jonuzi - fotoreporter

kk.rks-gov.net/gjilan

0280/321 586

Lutfi Haziri për herë të tretë në krye të Gjilanit

Lutfi Haziri është kthyer në krye të Gjilanit, pas zgjedhjeve lokale të vitit 2013, duke fituar besimin më të madh që qytetarët e kësaj Komune i kanë dhënë ndonjëherë kujt do qoftë tjetër që ka garuar për të udhëhequr kryeqendrën e Anamoravës. Ai e ka kryer këtë detyrë edhe më parë, në dy mandate jo të plota, pasi gjatë mandatit të dytë ishte emëruar ministër i Pushtetit Lokal.

Haziri premton se mandatin e tretë të kryetarit të Komunës do ta çojë deri në fund. “Do të mbetem i juaji”, ka qenë përgjigja e tij, si sqarim ndaj disa pohimeve se Haziri mund të jetë kryeministër i Kosovës.



Haziri e ka marrë me seriozitetin më të madh të mundshëm mandatin e tretë dhe është përkushtuar për ta ndryshuar jetën e qytetarëve të Gjilanit. Në vitin e parë të qeverisjes, prioritet kryesorë të tij kanë qenë infrastruktura, uji i pijes, ujërat e zeza dhe ndriçimi publik. Me shumë përkushtim është trajtuar edhe arsimi, bujqësia, shëndetësia dhe sektorët tjerë.

Tani që jemi në fund të vitit të parë të qeverisjes së tij, Gjilani i ngulfatur në borxhe nga qeverisja e kaluar, frymon më ndryshe. Do të bëhej edhe më shumë punë, sikur mbi buxhetin e Komunës të mos rëndonin kaq shumë obligime, që bashkë me ato kontingjente, shkojnë në 9.6 milionë euro.

Brenda vitit 2014 Komuna i ka shlyer mbi 2 milionë euro të trashëguara nga ish-pushteti.

Një punë e madhe është filluar me aksionin për ndihmë familjeve që kanë problememe strehim. Mbi 120 raste janë identifikuar si më urgjente. Shtëpitë e para tashmë po ndërtohen. Shumë të tjera do të nisin ndërkohë. Fondi i Komunës prej 100 mijë euro dhe solidariteti i qytetarëve, në shumë prej rreth 300 mijë euro (i premtuar) e mundësojnë arritjen e këtij qëllimi.

Sidoqoftë, qeverisja Haziri do të ecën tutje. Në vitin 2015 priten edhe më shumë investime. “Dieta buxhetore” do të vazhdojë. Paratë që kursehen nga drekat, darkat dhe shpenzimet tjera të pushtetarëve, do të investohen në projekte që përmirësojnë jetën e qytetarëve. Ky është zotim i Hazirit.

Motoja e tij është: “Unë dhe këshilltarët komunalë kemi vetëm një detyrë dhe ajo është që t’iu shërbejmë qytetarëve me dinjitet dhe sa më mirë”.

Ai ka bërë një hap tjetër të rëndësishëm edhe në avancimin e barazisë gjinore në vendimmarrje, duke ia besuar postin e kryesueses së Kuvendit Komunal, Valentina Bunjakut-Rexhepit.

Haziri mori detyrën e kryetarit të Komunës, premton bashkëpunim me të gjithë

24 dhjetor 2013

Lutfi Haziri ka marrë qeverisjen komunale në Gjilan, të martën, në një seancë inauguruese të Kuvendit Komunal, ku ai ka bërë betimin. Betimin e kanë dhënë edhe 35 anëtarët e rinj të asamblesë komunale.



Seancën inauguruese e ka udhëheq anëtari më i vjetër i Kuvendit, Zijadin Maliqi (LDK). Pas dhënies së betimit, kryetari Lutfi Haziri, në një fjalë rasti, premtoi bashkëpunim me të gjitha grupimet politike, për interesa të qytetarëve të Gjilanit.

Ai ka thënë se kjo është një ditë e shënuar për Gjilanin dhe ka kërkuar nga këshilltarët që të angazhohen që Gjilani të jetë një vend i dashur për të jetuar e punuar në të. Haziri ka thënë se si kryetar i Komunës do të jetë i paanshëm, unifikues dhe do të punojnë bashkërisht që ta kthejë

dhe fuqizojë rolin e Kuvendit.

Ai tha se do të angazhohet që bashkërisht me të gjithë të marrin vendime meritore e të drejta, për të mirën e Komunës dhe të qytetarëve. Meritorë për këtë ndryshim, padyshim se janë qytetarët e Gjilanit dhe kjo është arsyeja që ne të gjithë, duke përfshirë edhe këshilltarët komunalë, do të punojmë për të përmirësuar shërbimet. Tani më shumë se kurrë kemi nevojë që t'i realizojmë kërkesat e qytetarëve .

”Do të punojmë me të gjitha grupimet politike dhe do të fitojmë besimin nga donatorët, sikurse do të kemi një buxhet rigoroz dhe të disiplinuar. Unë dhe këshilltarët komunalë e kemi vetëm një detyrë, që t’iu shërbejmë qytetarëve me dinjitet”, ka thënë kryetari Haziri. Haziri tha se do të jetë i pa kompromis ndaj korrupsionit, krimit dhe dukurive negative.

Njëherësh ka falënderuar të gjitha organet e sigurisë që kanë mundësuar që Gjilani të njihet dhe quhet si qytet i tolerancës ndëretnike. Haziri ka premtuar trajtim meritore për kategoritë e dala nga lufta, rastet sociale, sikurse ka premtuar përkujdesje edhe për qytetarët nga Lugina e Preshevës. Banorët e Luginës së Preshevës, të cilët jetojnë në Gjilan, do të jenë qytetarë të barabartë me të tjerët, sepse Gjilani do të jetë dhe është komuna dhe shtëpia e tyre. Ndërkohë, është zhvilluar edhe ceremonia e dorëzimit-pranimi të detyrës, në objektin e deritashëm të kryetarit të Komunës, të cilin Haziri ia ka premtuar Muzeut.

Duke e dorëzuar detyrën të kryetari i ri, kryetari i deritashëm, Qemajl Mustafa ka thënë se ndryshimet e pushtetit janë normale në një demokraci dhe e ka uruar Hazirin që të jetë i suksesshëm në detyrën e tij qeverisëse.

Ai ka premtuar bashkëpunim, nëse kjo i kërkohet nga kryetari i ri. Ndërkaq, Lutfi Haziri theksoi se parimi i vazhdimësisë, është kulturë e tij politike. Pjesa më e madhe e projekteve do të vazhdojnë, ndërsa një pjesë do të rishikohen sipas nevojës.

Edhe Haziri e ka nënvizuar nevojën që ka Gjilani për një unitet politik, sepse është Komuna më e dëmtuar në ndarjen e investimeve kapitale, ka thënë ai. Përndryshe, Kuvendi i ri Komunal i Gjilanit do të përbëhet prej 35 këshilltarëve që vijnë nga subjektet politike: LDK, PDK, AAK. Vetëvendosje, AKR, Vatra, PD, LR, ZEP, PSD dhe KDTP.

Gjunjëzohemi para veprës së dëshmorëve të kombit

25 dhjetor 2013



Kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, e ka nisur ditën e parë të punës me homazhe në Varrezat e Dëshmorëve në Gjilan, ku ka nderuar sakrificën e madhe të dëshmorëve për lirinë e vendit. “Në ditën e parë të punës është obligim parësor që të gjunjëzohemi para atyre që kanë dhënë jetën për lirinë e vendit dhe falë sakrificës së tyre, ne sot jemi në liri”, ka thënë Haziri.

Duke u gjunjëzuar para përmendoreve të dëshmorëve, Haziri ka thënë se pasardhësit e tyre do ta kenë kujdesin e shtetit dhe në këtë rast të Komunës. Përveç kompleksit memorial, i cili do të përfundojë me prioritet, Haziri ka premtuar rregullimin edhe të hapësirës përreth. “Nuk mund të jemi rehat kur shohim se si ata që s’janë sot me ne, ende kanë ambientin e parregulluar”, ka thënë kryetari Haziri.

Më pas kryetari Haziri ka nderuar dëshmorët dhe martirët në Lladovë, Zhegër, Llashticë, Velekincë e Përlepnice, për t’u kthyer në qytet, ku ka bërë homazhe para shtatoreve të Agim Ramadanit e të Rexhep Malës e Nuhi Berishës.

“Ne i nderuam sot dëshmorët Idriz Seferin, Agim Ramadanin, Mulla Idriz Gjilanin, Zija Shemsun, Rexhep Malën, Nuhi Berishën dhe gjithë dëshmorët tjerë të kombit, të cilët Gjilanin e bëjnë sa krenarë, po aq edhe të përgjegjshëm për t’i vlerësuar dhe për t’i nderuar”, tha kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri.

Problemi i ujit të pijes dhe ujërat e zeza do të zgjidhen me prioritet

26 dhjetor 2013

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri ka vizituar Kompaninë Regjionale për Ujë“Hidromorava”, ku është informuar se furnizimi me ujë në qytet është i kënaqshëm, derisa në fshatra, gjendja është më problematike. Problemi më i madh janë humbjet e ujit që arrijnë në 50 për qind.

Kryetari Haziri ka thënë se problemi i ujit të pijshëm dhe trajtimi i ujërave të zeza, duhet të zgjidhen me urgjencë. Duke i ofruar bashkëpunim kësaj kompanie, Haziri ka thënë se dy prej katër prioriteve të tij, kanë të bëjnë me ujin e pijes dhe ujërat e zeza. “Projektet duhet të realizohen me urgjencë, lagje për lagje, fshat për fshat, për t’ua zgjidhur problemet jetike qytetarëve”, ka thënë kryetari Haziri. Sipas tij, këto projekte mund të realizohen në bashkëpunim me Komisionin Evropian.

Kryetari Haziri kërkon nga administrata shërbime sa më të mira për qytetarë

26 dhjetor 2013

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka vizituar Administratën e Përgjithshme, respektivisht Shërbimin e Gjendjes Civile dhe Qendrën për Shërbime të Qytetarëve (QSHQ), ku ka kërkuar shërbime sa më të mira për qytetarë.

Me këtë rast Haziri është informuar me punën që është duke u bërë në administratë, përgatitjet për pritjen e bashkatdhetarëve, por edhe me nevojat emergjente, si dhe u ka dhënë mbështetje punëtorëve, duke kërkuar nga ata që t’i shërbejnë qytetarët të cilët u drejtohen këtyre sporteve, në mënyrën më të mirë të mundshme.



“Kërkoj nga të gjithë ju që të jepni maksimumin për t’i shërbyer qytetarët, të cilët u drejtohen sporteve”, ka thënë ai. Haziri tha se ka ardhur në administratë, sepse këtu është frekuentimi më i madh i qytetarëve dhe me qëllim që t’i inkurajojë zyrtarët komunalë që të punojmë bashkë për të mirën e Gjilanit dhe qytetarëve të tij.

Do të ketë disiplinë të ashpër buxhetore



31 dhjetor 2013

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, në konferencën e dytë për media pas marrjes së mandatit, ka thënë se Komuna e Gjilanit ka vendosur një disiplinë të rreptë buxhetore, pasi që është e zhytur në borxhe disa milionëshe. Investimet 2014 do të vazhdojë sipas programit tim të përbërë prej katër prioritetëve: investime në rrugë, trotuare, ndriçim publik dhe kanalizim e ujësjellës, ka thënë Haziri.

“Do të vazhdohet sipas programit i cili ka fituar në zgjedhje”, ka thënë Haziri. Po ashtu do t’i lëvizim përpara projektet e lëna përgjysmë, si Memoriali i Dëshmorëve, Biblioteka e Qytetit, lumi Mirusha dhe projekte të tjera, ka thënë ai. Sa i përket manifestimit kulturor “Flaka e Janarit 2014”, Haziri ka thënë se Këshilli do të kryesohet tash e tutje nga vet ai, ndërsa për të ardhmen do të shikohet mundësia që organizimi t’i besohet ndonjë shoqate që merret me kulturën. Sa i përket ligjshmërisë së vendimeve të marra nga data 3 nëntor e këndej, nga ish-qeverisja, Haziri ka thënë se kjo periudhë është e mbushur me ftesa për kuotizim dhe e ka quajtur si “periudhë e ofertave”. Haziri ka thënë se shumë shpejt do t’i bëjë ftesë një auditori të pavarur, për të konstatuar gjendjen në secilën drejtori dhe secilën zyre komunale. “Dua ta kem të qartë gjithçka që ka ndodhur deri më tani në Gjilan”, ka thënë Haziri.

Haziri: “Flaka e Janarit” është sinonim i respektit dhe nderit për familjet dhe për veprat e mëdha të dëshmorëve

11 janar 2014

Ka nisur sot manifestimi me karakter kombëtar “Flaka e Janarit 2014” që mbahet në nderim të 30-vjetorit të rënies së dëshmorëve të kombit, Rexhep Mala e Nuhi Berisha. Kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, fillimisht kanë bërë homazhe te varrezat e dëshmorëve të kombit. Me këtë rast, kryetari Haziri është shprehur se gjunjëzohet para veprave të dëshmorëve që dhanë më të shtrenjtën për lirinë e Kosovës.



“Ne gjunjëzohemi para atyre që kanë dhënë jetën për lirinë, që kanë dhënë më të shtrenjtën dhe falë sakrificës së tyre, martirizimit dhe heroizimit të dëshmorëve, ne sot jemi këtu në këtë ditë të bardhë, në këtë liri që Kosova po e gëzon”, ka thënë Haziri. Më pas kryetari Haziri ka bërë homazhe para lapidarit të dëshmorëve Rexhep Mala e Nuhi Berisha, për të vazhduar te busti i dëshmorit Agim Ramadani. Kryetari Haziri ka pritur edhe familjarët e dëshmorëve, për t’i falënderuar për sakrificën dhe qëndresën e tyre gjatë gjithë këtyre viteve. “Jam i vogël sot të flas para familjeve të mëdha dhe mbi të gjitha para veprës së madhe të dëshmorëve. Të gjithë dëshmorët para Rexhep Malës dhe Nuhi Berishës, por edhe ata pas tyre, kanë vazhduar të njëjtën rrugë për liri dhe të njëjtën rrugë për të drejtat e shqiptarëve, kudo që ata jetojnë ata. Kjo sot është më e plotë, por jo aq sa ishte aspirata dhe ideali i tyre. Natyrisht ne të gjallët e kemi për detyrë ta vazhdojmë rrugën drejt realizimit të plot të aspiratave të tyre”, ka thënë kryetari Haziri. “Flaka e Janarit” është sinonim i respektit dhe i nderit për familjet e dëshmorëve dhe për veprat e mëdha të dëshmorëve. Ky vit i përkushtohet veprave të tyre, si çdo vit por në ballë të tyre janë dy dëshmorë të mëdhenj që 30 vjet më parë bënë veprën e madhe dhe bënë thirrjen e madhe, që lufta të vazhdojë dhe ecjet tona të mos ndalen deri në realizimin e plotë të amanetit të tyre”, tha Haziri. Duke iu drejtuar familjarëve, Haziri ka thënë se e di që edhe më tutje, pos mungesës që ndjeni për të dashurit tuaj, keni edhe brenga, keni edhe kërkesa, por kjo mbetet detyra jonë e parë për ta përmbushur kundrejt jush”, ka thënë kryetari Lutfi Haziri. Ndërsa deputeti i Kuvendit të Kosovës, Ahmet Isufi, është shprehur se Rexhep Mala dhe Nuhi Berisha ranë dëshmorë për një ideal të madh kombëtar. Në mbrëmje, ndezjen e flakadanit, si simbolikë e manifestimit “Flaka e Janarit” e kanë bërë familjarët e dëshmorëve Rexhep Mala e Nuhi Berisha, së bashku me kryetarin e Komunës, Lutfi Haziri.

Heronjtë na mësuhan se duhet të luftojmë padrejtësitë

12 janar 2014

Me akademinë solemne kushtuar dëshmorëve të janarit Rexhep Mala e Nuhi Berisha, në 30-vjetorin e rënies së tyre, të dielën në Gjilan ka vazhduar manifestimi kulturor përkushtues “Flaka e Janarit”, që përmes artit letrar, skenik, pamor e muzikor nderon heronjtë e kombit.



Lutfi Haziri, kryetar i Komunës së Gjilanit, nën përkujdesjen e të cilit mbahet manifestimi, duke e hapur akademinë, ka thënë se të gjithë ne jemi të vogël para veprës së madhe të dëshmorëve të kombit, të cilët i përkujtojmë për të 23-tën herë me radhë përmes manifestimit “Flaka e Janarit”. Dëshmorët

janë ata më meritoret për këtë ditë të bardhë në Kosovë, për liri, për pavarësi dhe për bashkim të shqiptarëve. Nga dëshmorët ne kemi mësuar shumë, por mbi të gjitha ata na dhanë guximin e kurajën që të mos pajtohemi me të keqen dhe padrejtësitë, por të vazhdojmë rrugën tonë për liri, ka thënë Haziri. Sot, 30 vjet më parë, Rexhep Mala e Nuhi Berisha, në Prishtinë, në Kodrën e Trimave, me veprën e tyre heroike na bënë krenarë të gjithë neve si Gjilan, si Anamoravë e si Kosovë. Tani, është obligim yni që amanetin e tyre ta çojmë përpara, ka thënë Haziri.

Kryetari i Gjilanit ka thënë po ashtu se është vendosur që hapësira para shtëpisë së Rexhep Malës në Gjilan, do të emërohet “Sheshi i Ilegales”. Kurse Ahmet Isufi, deputet i Parlamentit të Kosovës, tha se Rexhep Mala dhe Nuhi Berisha janë më meritoret për organizimin e gueriles shqiptare në Kosovë, e cila filloi me ta dhe më vonë u shndërrua në ushtri çlirimtare, për të zhvilluar luftën e armatosur deri në çlirimin e vendit nga okupatori. Sipas shembullit të tyre, tani ne obligohemi që të punojmë për popullin tonë dhe ta bëjmë atë të barabartë me kombet tjera të liria, ka thënë Isufi, duke vënë në dukje edhe tipare të veçanta të dëshmorëve Rexhep Mala e Nuhi Berisha.

Fitore Mala ka thënë se ndihen mirë kur institucionet e vendit kujdesen t’i nderojnë e përkujtojnë heronjtë e Kosovës e të të gjithë kombit, që në këtë rast janë familjarë të tyre dhe bijë të

Gjilanit. Ajo ka bërë ftesë që bashkërisht të punojmë më shumë për ndërtimin e shtetit të Kosovës. Kurse Donika Gërvalla, në emër të familjes Gërvalla, tha se Gjilani është shembulli më i mirë se si duhet nderuar e respektuar heronjtë, edhe përmes aktiviteteve kulturore, për të mos i përkujtuar ata vetëm në ditët e rënies së tyre.

"Flaka..." vazhdon me ekspozitën e artit pamor

17 janar 2014

Komisioni vlerësues në përbërje: Demir Behluli, Rasim Vllasaliu e Sami Shabani ka shpallur fitues të kësaj ekspozite tre artistë: Agron Bytyqi (çmimi tradicional për pikturë), Arta Ramadani (çmimi për pikturë) dhe Blerta Hyseni (çmimi për skulpturë). Ndërsa çmimin blerës për fondin e Galerisë e ka marrë vepra e pedagogut Zejnullah Zejnullahu.



Është hapur sot ekspozita e artit pamorë Në kuadër të manifestimit "Flaka e Janarit 2014", është hapur ekspozita e artit pamor, ku morën pjesë kryetari i Komunës, Lutfi Haziri, regjisori Ekrem Kryeziu, artistë nga të gjitha trojet etnike si dhe shkrimtari Visar Zhiti, i cili kishte ardhur enkas për këtë aktivitet. Ekspozitën e hapi Afrim Behluli, drejtor i shkollës së arteve në Gjilan, i cili i vlerësoi lartë punimet e 46 autorëve të ndryshëm.

Kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, theksoi se përmes kësaj ekspozite e bëjmë nderimin për sakrificën e dëshmorëve të kombit, të cilën dhanë jetën për të gëzuar ditët e sotme.

“Nderin dhe respektin përmes këtij manifestimi po e bëjmë ndaj atyre që u flijuan, sakrifkuan dhe bënë gjithçka që është e mundur për të mirën e vendit. Gjilani ka zgjedhur artin për t’i nderuar përmes vlerave kulturore të gjithë të rënë për liri”, ka thënë Haziri. Gjilani shumë shpejt duhet të bëhet me Galeri, Muze dhe Kinema. Pa këto tri institucione kulturore nuk e ka kuptimin e plotë një qytet siç është Gjilani, ka thënë Haziri.

Festivali i dramës shqiptare “Talia e Flakës”

21 janar 2014

Mbrëmë në Gjilan është hapur Festivali i Dramës Shqiptare “Talia e Flakës”, si pjesë përbërëse e manifestimit shumëkulturore “Flaka e Janarit” që mbahet në nderim të heronjve, dëshmorëve dhe martirëve shqiptarë të rënë nëpër janarët dhe muajt tjerë të historisë së vështirë shqiptare për liri e identitet kombëtar.



Festivalin e ka shpallur të hapur kryetari i Komunës, Lutfi Haziri, i cili me këtë rast ka thënë se “Flaka...” si manifestim përkujtues për dëshmorët, ka ecur nëpër rrugë të vështira, por nuk është ndaluar asnjëherë. Duke rikujtuar nismën e këtij manifestimi, Haziri ka falënderuar mikpritësit e mëdhenj të “Flakës së Janarit” në Përlepnice, Bresalc, Gjilan e gjetiu, në kohën kur Kosova jetonte në okupim, sikurse edhe aktorët, regjisorët dhe gjithë të tjerët që kanë qenë pjesë përbërëse e manifestimit, që Gjilanin e ka kthyer në një qendër mbarëkombëtare të kulturës.

Falë këtij manifestimi, që sivjet mbahet për herë të 23-të me radhë, pesë ditë në Gjilan jetohej me teatër dhe një muaj në Gjilan jetohej me kulturën kombëtare, ka thënë Haziri. Ndërkohë, natën e parë është dhënë shfaqja premierë “Zonja me maskë” e Teatrit të Gjilanit, e autorit Osman Goranci, me regji të Fatmir Hysenit, e cila nga kritika u vlerësua si një dramë e nivelit mesatar, një shfaqje e atmosferës. Festivali i Dramës Shqiptare “Talia e Flakës” që po mbahet në Gjilan, në kuadër të manifestimit shumëkulturore “Flaka e Janarit”, ka vazhduar me shfaqjen “Gishti” të Teatrit Shqiptar të Shkupit, me tekst të Doruntina Gashit, regji të Agon Miftarit dhe lojën skenike të aktorëve Armenis Jovanovska-Nokshiqi, Zarije Jonuzi e Drita Kaba. Natën e tretë u dha shfaqja “Shembja e Kullës së Ajfelit” e Qendrës Multi Media Prishtinë, me autor Jeton Nezirajn dhe regji të Blerta Nezirajt.

Natën e katërt, të parafundit të Festivalit “Talia e Flakës”, që po mbahet në Gjilan, u dha shfaqja “Dëshmitari” e Teatrit Kombëtar të Kosovës, me autor dhe regji të Selami Tarakut dhe lojën e

aktorëve Aida Alidemi, Hysen Binaku e Basri Lushtaku. ‘Talia e Flakës’ mbyllet sonte (e premte) me shfaqjen “Tri mendje në ankand” të Teatrit Metropol nga Tirana. Festivali është përmbyllë me shfaqjen “Tri mendje në ankand”, të Teatrit Metropol të Tiranës, me tekst të Ferdinand Hysit dhe regji të Elma Doesit. Çmimin për tekstin-dramën më origjinale e mori Ferdinand Hysi (Metropol), kurse çmimi - regjia më e mirë e Festivalit iu dha Blerta Neziraj-Rustemi (Qendra Multi-Media Perishtinë). Çmimin aktori më i mirë i Festivalit e mori Gëzim Bucolli (Teatri i Gjilanit), ndërsa epiteti i aktorese më të mirë i takoi aktorese Amernis Jovanovska – Nokshiqi (Gishti). Aktorja më me perspektivë u shpall Tringa Hasani (Teatri i Gjilanit), derisa aktorja Elona Hyseni (Metropol Tiranë) u vlerësua për rolin më të mirë dytësor. Çmimi për realitet të ri teatror iu dha Fatmir Hysenit, regjisor i dramës “Zonja me maskë” (Teatri i Gjilanit). Nexhmedin Ymeri, i cili pas pak ditësh shkon në pension, u nderua me çmimin e veçantë për arritje jetësore nga Tetari i Gjilanit. Rajmonda Bulku, kryetare e jurisë ka falënderuar publikun gjilanas për interesimin e madh që pati për Festivalin e Dramës Shqiptare, duke stërmbythur sallën e Teatrit në Gjilan. Brenda kësaj atmosfere, regjisorja e dramës “Tri mendje në ankand”, Elma Doesi do të thotë se “publiku është çmimi më i madh për ne”. Këtë çmim do ta ëndërronte çdo regjisor, ka thënë Doesi. Asaj, çmimin kryesor të Festivalit ia dorëzoi kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, që edhe e shpalli të mbyllur këtë pjesë të manifestimit “Flaka e Janarit”, i cili vazhdon edhe dy ditë të tjera, me pjesën letrare dhe muzikore. Në kuadër të festivalit “Talia e Flakës” janë mbajtur edhe debate për shfaqjet si dhe ligjërata lidhur me artin skenik nga dramaturgë dhe përfaqësues të tjerë të jetës teatrale.

Çmimin “Pena e Flakës” e fitoi Mimoza Erebara nga Tirana

31 janar 2014

Me Orën e madhe letrare dhe shpalljen e rezultateve të konkursit letrar shërbyes, të premtën në Gjilan është përmbyllur “Pena e Flakës” si pjesë e manifestimit “Flaka e Janarit”, që këtu mbahet në nderim të dëshmorëve të kombit. Vendi i parë në poezi iu dha “Mbrëmje pavarësie” (pa shifër), që doli të jetë e Agim Deskut, ndërkaj në prozë - “(Sh) Krimi” (Liria për ty), që doli të jetë e autorit Mehmetali Rexhepi. Juria ndau edhe çmimet e dyta e të treta në poezi e prozë.

Në orën e madhe letrare, me poezitë e tyre të pabotuara më parë, janë prezantuar mbi 50 krijues nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Lugina e Preshevës dhe diaspora. Veçmas ka qenë i madh kësaj here numri i poetëve nga Shqipëria, të cilët e kanë begatuar orën letrare. Juria në përbërje Nehat Sopaj, Ana Kove dhe Linditë Ramushi, çmimin e Orës letrare “Pena e Flakës” ia ndau poetes nga Tirana, Mimoza Erebara, për poezinë “Uni im në vetën e tretë”. Ndërkohë, edhe juria e konkursit shpërblyes, në përbërje Musa Ramadani, Zejnepe Alili-Rexhepi e Nexhat Rexha i ka komunikuar vendimin e saj për punimet e shpërblyera në poezi dhe prozë. Zejnepe Alili-Rexhepi tha se konkursit i kanë arritur 276 punime, në të dy gjinitë. Juria ka ndarë këto çmime në poezi: Vendi i parë – poezia me titull “Mbrëmje pavarësie” (pa shifër), autor Agim Desku, vendin e

dytë e ndanë poezitë “Hiri” (pa shifër), që doli të jetë e autores Entela Kasi dhe “Vjeshta e një gruaje” (shifra: 2463) që doli të jetë e autorit Agim Bajrami, vendi i tretë – “Një femër” (shifra: 13), e autores Edona Haliti. Edhe në prozë, juria ka ndarë tri çmime: Vendi i parë – “(Sh) Krimi” (shifra: Liria për ty), me autor Mehmetali Rexhepi, vendi i dytë u nda për dy tregime - "Vdekja banale" (shifra: Miku i vjetër) e autorit Biser Mehmeti dhe “Përballë jetës” (shifra: Hylli) e Lindita Dodës, vendi i tretë – “Kalorësi i pestë” (shifra: Sigmund frend), me autor Ismet Aliu. Në përputhje me rregullat e konkursit, juria ka përzgjedhur edhe një numër të punimeve në poezi e prozë, të cilat do t’i propozohen për botim revistës “Agmia”.

Përmbillet manifestimi “Flaka e Janarit” 2014

1 shkurt 2014

“Fest Flaka” ka mbyllur mbrëmë manifestimin “Flaka e Janarit” në Gjilan, që organizohet në nderim të dëshmorëve, nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës. Gjatë tri javëve, sa zgjat manifestimi, në Gjilan zhvillohen aktivitete të shumta e të ndryshme kulturore në artin skenik, pamor, letrar dhe muzikor. Çmimi "Fest Flaka" iu nda Enkelejda Arifit për këngën e Qerqiz Topullit. (Me vendim të kryetarit të Komunës, ky çmim u anulua ndërkohë, për të shmangur konfliktin e interesit).

Vendin e dytë e kanë ndarë Ylberina Avdyli dhe Besa Krasniqi, sikurse edhe vendin e tretin, që e ndanë Mallëngjim e Majlinda Bajrami dhe Jetmir Rexhepi.

Vlerësimin e ka bërë juria profesionale, në përbërje Naim Xhoshi, kompozitor, Besiana Mehmeti, soliste dhe Adhurim Rasimi, profesor në Shkollën e Muzikës në Gjilan.

Po ashtu, organizatori i “Flaka e Janarit” ka nderuar me plaketën e manifestimit solistin dhe kompozitorin Ilir Shaqiri, me plaketën e festivalit është nderuar edhe prezantuesja televizive Silvana Braçe, ndërsa për veprimtari jetësore është nderuar kompozitori Naim Xhoshi.

Në përmbillje të manifestimit të sivjetmë “Flaka e Janarit 2014”, kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri ka thënë se tash e 23 vjet me radhë, janari është kthyer në muaj të vlerësimit, gjuhëzimit dhe nderimit për gjithë heronjtë e kombit.

“Sot “Flaka...” është e të gjithë shqiptarëve, sepse në organizimin e saj ka pjesëmarrës nga të gjitha trojet”, ka thënë Haziri. Ky vit iu kushtua 30-vjetorit të rënies së dëshmorëve Rexhep Mala e Nuhi Berisha, këtyre burrave të mëdhenj, që nga “Kodra e Trimave” në Prishtinë na treguan se si luftohet për liri dhe pavarësi, duke rënë dëshmorë në moshë shumë të re. Haziri tha se Gjilani ka filluar të mendojë për zgjerimin e “Flakës...” shumë më shumë se sa është tani.

“Flaka e Janarit 2015” do t’i kushtohet 70-vjetorit të masakrës së më shumë se 2 mijë

shqiptarëve në Gjilan si dhe 25-vjetorit të rënies heroike të dëshmorit Reshat Ymeri”, ka thënë Haziri.

Ai e ka shpall të mbyllur manifestimin shumë kulturor, duke i falënderuar artistët dhe artdashësit nga të gjitha trojet shqiptare, të cilët për tri javë rresht ishin bashkë me ne në Gjilan, për të madhështuar “Flakën e Janarit”. Bujar Haziri, drejtor për Kulturë, ka thënë se “Flaka e Janarit” sivjet ka kushtuar 50 për qindmë lirë se vitin e kaluar.

Të kursehet në maksimum, borxhet e Komunës shumë të mëdha

12 janar 2014



Kryetari i Komunës së Gjilanit Lutfi Haziri ka kërkuar nga Këshilli i Drejtorëve uljen maksimale të shpenzimeve në secilin sektor të Komunës, sepse borxhet që ka trashëguar Komuna janë të mëdha.

“Bashkërisht, të gjithë ne, duke u nisur nga zyra ime, duhet t’i ulim shpenzimet në maksimumin e mundur, sepse nëse nuk kursehet maksimalisht nuk mund t’i shlyejmë këto borxhe të trashëguara nga qeverisja paraprake”, ka thënë Haziri, duke shtuar se rendi dhe rregulli duhet të niset nga vetvetja për të vazhduar pastaj në secilin sektor.

“Ne duhet të punojmë jashtëzakonisht shumë që qytetarëve të Komunës së Gjilanit t’u krijojmë kushte më të mira, por kjo mund të bëhet duke kursyer në maksimum dhe duke punuar po ashtu në maksimum, pa shikuar orar, pa shikuar vikende. Duhet të jemi në shërbim të qytetarëve”, ka thënë ai. Ndërkaq, për uljen e shpenzimeve, ka thënë se bashkërisht dhe me arsye të plotë do të shikojmë edhe mundësinë e ndërprerjes së ndonjë kontrate të shërbimeve, që ka Komuna me operatorët ekonomikë.

E marta, ditë e qytetarëve

14 janar 2014

Kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, ka vendosur që dita e martë, prej mëngjesit e deri në mbrëmje, të jetë ditë e pritjes dhe shqyrtimit të kërkesave të qytetarëve.

Kryetari Haziri ka pritur deri sot mijëra qytetarë për urim, ndërsa ka shqyrtuar edhe dhjetëra kërkesa të tyre. Gjatë këtyre takimeve, kryetari Haziri sërish ka rikonfirmuar se dyertë e Komunës do të jenë të hapura 24 orë për qytetarët. “Komuna është e qytetarëve. Mos hezitoni të na vizitoni për çfarëdo kërkesë që keni. Ju kemi thënë se do të punojmë 24 orë për të pasur ju. Ne gjithmonë do të jemi në shërbimin tuaj”, ka thënë ndër të tjera, kryetari Haziri. Haziri ka apeluar qytetarët që për çfarëdo kërkesë që kanë t’i drejtohen atij në ditën e martë që është e rezervuar ekskluzivisht për shqyrtimin e kërkesave të gjilanasve.

Trashëgimia kulturore është vlerë që duhet të mbrohet

15 janar 2014



Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka pritur përfaqësuesin e organizatës joqeveritare suedeze “Trashëgimia Kulturore pa Kufi”, Sali Shoshi, me të cilin ka biseduar për bashkëpunimin, për projektet dhe mundësitë e investimeve në këtë sektor.

Gjatë takimit, kryetari Haziri ka theksuar se trashëgimia kulturore është vlerë që duhet të mbrohet, duke shtuar se në këtë sektor do të bëjë maksimumin e mundshëm si kryetar i Komunës së Gjilanit.

“Trashëgimia kulturore është vlerë e jona dhe si e tillë duhet të mbrohet. Unë edhe sa kam qenë

ministër i Kulturës e kam bërë maksimumin për të mbështetur këtë fushë dhe këtë do ta bëjë fuqishëm edhe si kryetar i Komunës”, ka thënë Haziri.

Ai ka kërkuar nga Ministria e Kulturës që të bëjë sa më parë shenjëzimin e të gjitha objekteve të mbrojtura, për t’i ruajtur nga rrënimet.

Sali Shoshi tha se ka ardhur në Gjilan për të shprehur vullnetin e bashkëpunimit me këtë Komunë, duke ia dorëzuar kryetarit Hazirit 40-projekte për investime në trashëgiminë kulturore, për t’i vlerësuar e shqyrtuar, në mënyrë që të dakordohen për implementimin e tyre.

Të dyja palët janë dakorduar që fokusi kryesor i investimeve të jetë “Kalaja e Pogragjës” dhe ndërtimi i Urës afër kësaj Kalaje. Kryetari Haziri ka pohuar se brenda javës do t’i dërgojë emrat e Forumit Lokal të Trashëgimisë së Gjilanit, për t’u përfaqësuar në organizatën “Trashëgimia Kulturore pa Kufi”.

Nuk mund të bëjmë Komunë të pasur në kurriz të qytetarëve të varfër

16 janar 2014

Interesimi i qytetarëve të Gjilanit për t’i paraqitur vërejtjet dhe sugjerimet e tyre në projekt-rregulloren për taksa komunale, e cila i është nënshtruar të enjten dëgjimit të parë publik, nuk ka qenë asnjëherë më i madh. Ata kanë kërkuar ulje të tatimit në pronë, qira më të vogla për objektet komunale, heqje të taksës për kompanitë e kontrollimit teknik, ulje të taksës për



operatorët kabllorë si dhe harmonizim të taksave tjera me kushtet ekonomike të qytetarëve, për t’i bërë ato sa më të përballueshme.

Përfaqësuesi i kompanisë “Kujtesa”, Armend Ukshini, ka thënë se çmimi prej një euro për çdo metër kabëll të shtrirë, është shumë i lartë dhe kërkoi të rishikohet kjo taksë. Skënder Kçiku, tha se qiraja e propozuar për objektet komunale që i shfrytëzojnë zejtarët, është i madh. Mejd

Zymberi kërkoi të hiqet taksa edhe për ndërmarrjet e kontrollimit teknik, sikurse që është bërë për bizneset tjera, sikurse kërkoi një taksë më të arsyeshme kadastrale sa i përket matjes së tokës ndërtimore, që tani është 0.50 euro për metër. Taksa për këtë shërbim duhet të jetë e krahasueshme me koston e shërbimit që bëhet, ka thënë ai. Riad Rashiti tha se qeveria e kaluar komunale ka bërë lehtësira taksash për çdo vit, por duke mos dëmtuar buxhetin e Komunës. Edhe ai ishte dakord që taksa për kontrollime teknike të automjeteve të hiqet krejtësisht. Sipas Sali Kçikut, drejtor i Zhvillimit Ekonomik, te bizneset e mëdha është bërë një specifikim i obligimit sipas madhësisë, që në total nënkupton ulje të taksës. Ndërkaq, Shaban Terziu nga shoqëria civile ka thënë se taksat duhet të ekzistojnë patjetër, sepse shteti mbahet prej tyre. Lutfi Haziri, kryetar i Komunës, i ka inkurajuar qytetarët, afaristët dhe grupet tjera të interesit, që t'i paraqesin të gjitha vërejtjet e tyre në këtë projekt-dokument, në mënyrë që para Kuvendit Komunal të shkojë një rregullore sa më e pranueshme për të gjithë. "Nuk mund të bëjmë Komunë të pasur në kurriz të qytetarëve të varfër", ka thënë Haziri. Sipas tij, qeveria duhet të jetë realiste dhe të grumbullojë vetëm atë që i takon shtetit dhe jo në emër të ndërtimit të diçkaje të grumbullohen para në formë të haraçit. Ai ka paralajmëruar një ulje të ndjeshme të taksave të shumica e kategorive, ndërsa të disa, siç ka thënë, do të jenë zero. Edhe sa i përket tatimit në pronë, Haziri ka thënë se shumë shpejt do të formohet një task-forcë për përcaktimin e vlerës së pronave dhe mbi këtë kriter do të caktohet pastaj tatimi në pronë, meqë te norma nuk mund të ndërhyhet, sepse është politikë e nivelit qendror.

Vizioni i Rugovës për pavarësi u bë vizion i gjithë popullit të Kosovës

21 janar 2014



jeta politike e kulturore në vend.

Nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës, Lutfi Haziri, në Gjilan është mbajtur akademia përkujtimore kushtuar 8-vjetorit të vdekjes së Presidentit Ibrahim Rugova. Në akademi kanë marrë pjesë nënkryetari i LDK-së, Sabri Hamiti, kryetari i Podujevës Agim Veliu, kryetari i Vitisë, Sokol Haliti, kryetari i degës së LDK-së në Kamenicë, Shaip Surdulli si dhe përfaqësues e veprimtarë të tjerë nga

Në fjalën e rastit, kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri ka thënë se prania shpirtërore, prania vizionare dhe prania frymëzuese e Ibrahim Rugovës për asnjë moment nuk mungoi e as nuk do mungojë për ne. Ai tha se Kosova, pas 21 Janarit 2006, me kërkesën për liri, pavarësi e demokraci, nuk e pati lehtë të ecë vertikalisht, pa presidentin Rugovë. “E di se nuk e kemi lehtë, siç nuk e patëm lehtë as më 21 Janar 2006 kur lajmi i pikëllueshëm ngriu për një moment zemrat tona, na la pa frymë. Thjeshtë, as nuk mund ta besonim. As nuk deshëm ta besojmë. Sepse ai na duhej si kurrë më parë. Ish afruar momenti i realizimit të vizionit të tij, që u bë vizion i një populli. Ëndrra e tij dhe jona për një Kosovë të njohur ndërkombëtarisht, për një Kosovë të lirë dhe të pavarur, po bëhej realitet i prekshëm”, ka thënë Haziri. Haziri ka vazhduar duke thënë se “ne, si kurrë më parë, donim që ai të ishte prezent në realizimin, në shijimin dhe në zhvillimin e mëtejshëm të këtij vizioni, sepse ishte ideator e autor, ishte prijësi pas të cilit ne ishim mësuar të ecim. Pas tij e kishim më lehtë, ishim më të mbrojtur, më të paqtë, më të dashur. Ishim në shërbim të atij vizioni, të cilin me padurim e prishte një popull që aq shumë kish dhënë, kish gjakuar për të. Dhe, ajo ditë ishte në prag, dita që Ai, sikur nëpër legjenda, na iku papritur. Por, na iku vetëm fizikisht”, ka thënë kryetari Haziri. Kryetari Haziri është shprehur po ashtu se presidenti ynë historik, Dr. Ibrahim Rugova, na nxori në rrugë të drejtë, na nisi drejt familjeve demokratike, drejt një civilizimi perëndimor, drejt shteteve prej të cilave ne kishim interes jetik, pa ndihmën e të cilave as që do ishim këtu ku jemi sot. “Prandaj, edhe pas tetë viteve, ne s’mund të pajtohemi se Ai na iku fizikisht, atëherë kur na duhej më së shumti.

Na iku duke na lënë në rrugën e Tij, në mësimet e Tij, në përmbushjen e vizionit të Tij, në filozofinë dhe trashëgiminë e Tij politike, në Shtetin që Ai e projektoi dhe po e gëzojmë dhe ndërtojmë sot, ne pasardhësit e Tij. Jemi të vetëdijshëm për rrugën që e bëmë pa të. Patëm sfida të mëdha. Përplasje. Goditje, nga më të ndryshmet. Madje edhe ndërskamza, nga brenda, nga jashtë. Patëm e ç’nuk patëm... dhe ecëm, nuk u ndalëm, i qëndruam besnik themeluesit të këtij vizioni, të kësaj filozofie politike, po edhe të vetë këtij shteti. Dhe, këtë duhet ta themi shumë më zëshëm. Ai është babai i kësaj Kosove të re që rrodhi prej asaj Dardanie të lashtë, në thellësitë e së cilës prehet Ai, përjetësisht në atë paqe që aq shumë e ëndërroi”, tha Haziri. Për më tepër, ai ka pohuar se Presidenti Rugova ishte i lidhur shumë me Gjilanin dhe miqtë e tij i kishte pikërisht nga Gjilani, si Beqir Musliun, Musa Ramadanin, Ibrahim Kadriun etj. “Besnikët më të mëdhenj të vizionit të tij i gjeti këtu. Vizitën e parë në liri e bëri po këtu ku u prit si Shenjt, si Hero më 17 qershor të vitit 2000. Po, edhe vizitën e fundit jashtë Prishtinës, e bëri po në Gjilan, kur na e bekoi Bukën e Re të tokës sonë, më 19 korrik 2005”, ka thënë Haziri.

Ndërsa nënkryetari i LDK-së, Sabri Hamiti, tha se ne e kemi vepër punën e Rugovës dhe kjo vepër duhet të ruhet brez pas brezi. “Rugova është përherë me ne. Ai është programi i shkuar e i pashkruar për ne dhe mendoj se është edhe për Kosovën Evropiane. Unë them që njerëzit që kujtohen kanë intensitet, ata janë gjallë, janë vlera. Përmes Presidentit Ibrahim Rugova është provuar që LDK i përket të kaluarës, të tashmes dhe të ardhmes”, tha me këtë rast Hamiti.

Valentina Bunjaku Rexhepi zgjidhet kryesuese e Kuvendit Komunal

21 janar 2014

Vendimmarrësit komunale të Gjilanit kanë zgjedhur të martën kryesuesen e Kuvendit Komunal, kanë miratuar orarin e punës për vitin 2014, numrin e Komiteteve si dhe kanë miratuar vendimin për emërimin e komisionit statutar si dhe akteve të tjera normative. Opozita (PDK) nuk ka marrë pjesë në votimin për zgjedhjen e kryesueses, por nuk ka hezituar që ta urojë atë. Valentina Bunjaku Rexhepi është femra e parë që vjen në krye të asamblesë komunale.



Kurse propozim-vendimi për miratimin e nismës së kryetarit të Komunës për ndryshimin dhe plotësimin e statutit të Komunës, u shty për një seancë tjetër, me kërkesën e opozitës (PDK). Me 23 vota për dhe 4 fletëvotime të pavlefshme, kryesuese e Kuvendit Komunal u zgjodh Valentina Bunjaku Rexhepi (LDK). Në votimin për zgjedhjen e saj morën pjesë 27 anëtarë të Kuvendit Komunal nga të gjitha grupimet politike, me përjashtim të atyre të PDK-së (8 këshilltarë), të cilët paraprakisht u deklaruan se nuk do të marrin pjesë në këtë proces. AAK u deklarua publikisht se do ta mbështes propozimin e LDK-së. Valentina Bunjaku Rexhepi, femra e parë kryesuese e asamblesë komunale në Gjilan, mori urime nga të gjitha grupimet politike, përfshirë edhe PDK-në, e cila nuk mori pjesë në votim. Ajo premtoi se do të punojë me të gjitha grupimet politike në Kuvend Komunal, për t'i realizuar interesat e qytetarëve të Gjilanit, në mënyrën më të mirë të mundshme. Valentina Bunjaku Rexhepi zgjidhet vendimmarrëse komunale për herë të parë dhe njëkohësisht edhe kryesuese e Kuvendit Komunal. Ndërkaq, Lutfi Haziri, kryetar i Komunës, duke u ndërlidhur me kërkesën e opozitës (PDK) për heqjen nga rendi ditës i propozimit për ndryshimin e statutit të Komunës, meqë nuk kanë marrë material për këtë pikë, ka thënë se qëllimi ynë kryesor është që të funksionalizojmë sa më parë Kuvendin Komunal dhe trupat e tij.

Haziri nderohet me diplomën “Pllaka e nderit” nga Akademia Europiane e Arteve

23 janar 2014



Akademia Europiane e Arteve me seli në Paris i ka ndarë diplomën “Pllaka e nderit” kryetarit të Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, për arritjet në fushën e kulturës dhe si promotor i shumë zhvillimeve në Kosovë.

Çmimin ia ka dorëzuar piktori Jetullah Haliti, kryetar i Seksionit Shqiptar të Akademisë Europiane të Arteve me seli në Paris, i cili me këtë rast ka thënë se kryetari Haziri ka dhënë kontribut në shumë nivele, edhe si ministër i Kulturës, si lider e njëherit si promotor i shumë lëvizjeve në Kosovë. Ndërkaq, kryetari Haziri ka thënë se është shumë i lumtur që nderohet me diplomën “Pllaka e nderit” nga Akademia Europiane e Arteve, me të cilën më parë është nderuar edhe Presidenti i ndjerë, Ibrahim Rugova. “Akademia Europiane e Arteve është institucion jashtëzakonisht i respektuar në Europë dhe në botë. Jam shumë i lumtur që këtë diplomë po e marr pas presidentit Ibrahim Rugova.

Ky çmim është nder dhe në të njëjtën kohë edhe përgjegjësi më e madhe për mua”, ka thënë kryetari Haziri.

Arsimi -

Prioriteti i parë dhe më i madhi në qeverisjen time

23 janar 2014

*Kryetari i
Komunës së
Gjilanit, Lutfi
Haziri, ka
vizituar
Drejtorinë
Komunale të
Arsimit, ku nga
drejtori Nazmi
Musa është
informuar për
gjendjen në
shkollat e
Gjilanit.*



Me këtë rast, drejtori i DKA-së, Nazmi Musa, ka thënë se nuk do të kursehem për asnjë moment, që të punojë me gjithë kapacitetin, dijen dhe përvojën që kam, për të mirën e arsimit në Gjilan. “Kemi shumë sfida, ka shumë probleme të trashëguara, por bashkërisht me punëtorët e Drejtorisë do t’ia dalim t’i zgjidhim të gjitha këto”, ka thënë Musa.

Ndërsa kryetari Haziri, duke i ofruar mbështetjen e tij maksimale drejtorit të Arsimit, ka thënë se arsimi është prioriteti më i madh gjatë qeverisjes time. “Bashkërisht do t’i zgjidhim të gjitha problemet e grumbulluara dhe pastaj do ta realizojmë gjithë programin për arsimin, me të cilin kemi marr besimin e qytetarëve të Gjilanit. Duhet të bëjmë zgjidhje edhe për institucionet parashkollore dhe sektorët tjerë brenda Komunës. Përkrahja ime do të jetë e vazhdueshme.

Do të jem përherë pranë kërkesave tuaja, që secilin problem ta zgjidhim së bashku”, ka thënë kryetari Haziri.

Kemi një numër të madh të projekteve për aplikim në grantet e KE-së

29 janar 2014



Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka marrë pjesë në prezantimin e projektit të Komisionit European “Kosova e Bukur”, i cili ka për qëllim të krijojë vende pune dhe në të njëjtën kohë të përmirësojë kushtet socio-ekonomike të popullsisë në Gjilan.

Kryetari Haziri së bashku me Bordin e drejtorëve, kanë përpiluar projektet për aplikim në grantet e Komisionit European, e që lidhen me bashkëpunimin ndërkuftar, pastaj programin EURED, i cili ka të bëjë me zhvillimin ekonomik rajonal, e projekte të tjera. Gjilani deri më 28 shkurt do të dorëzojë projekte, të cilat do të jenë në përputhje me kriteret e Komisionit European. Ndërkohë, kryetari Haziri ka pritur një delegacion të Ministrisë së Integrimeve Europiane të Republikës së Kosovës, i kryesuar nga drejtori i Departamentit për Asistencë, Florim Canolli. Qëllimi i takimit ka qenë bashkërendimi dhe koordinimi i aktiviteteve mes donatorëve të ndryshëm dhe Komunës së Gjilanit, përmes të cilave Gjilani do të përfitonte donacione të ndryshme. Drejtori i Departamentit për Asistencë në Ministrinë e Integrimeve Europiane, Florim Canolli, ka thënë se tashmë do të ketë komunikim direkt mes Ministrisë dhe komunave, duke i ofruar kryetarit Haziri ndihmesë në asistencë teknike në këto projekte. Kryetari Haziri, ka falënderuar përfaqësuesit e Ministrisë së Integrimeve Europiane, ndërsa ka pohuar se shpreson në ndihmën e kësaj ministrie në përfitimin e granteve të Bashkimit European. “Kemi interes jashtëzakonisht të madh të konkurrojmë në të gjitha grantet e Komisionit European. Kemi aplikuar edhe në programin e BE-së “Kosova e Bukur”. Kemi bashkëpunim të mirë me komunat në lindje dhe poashtu do të aplikojmë edhe për projekte të bashkëpunimit ndërkuftar. Kemi një numër të madh të projekteve që tashmë janë gati për aplikim”, ka thënë Haziri.

Do t'i promovojmë dhe mbrojmë prodhimet vendore

30 janar 2014



Kryetari i Komunës së Gjilanit Lutfi Haziri, ka pritur në një takim pune kryetarin e Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gërxhaliun me bashkëpunëtorët e tij, nënkryetarin dhe bordin dhe bizneset e Gjilanit, me të cilin ka biseduar për bashkëpunimin në të ardhmen për të krijuar lehtësira dhe hapësirë për vende të reja pune, por edhe për mbështetje të biznesit vendor në përgjithësi. Kryetari Haziri dhe kryetari Gërxhaliu, janë zotuar për partneritet dhe bashkëpunim në

mbështetje të bizneseve dhe prodhimeve vendore.

Me këtë rast kryetari Haziri ka thënë se bashkëpunimi në nivelin lokal është më se i domosdoshëm mes dy institucioneve, për të krijuar impulse pozitive për zhvillimin ekonomik dhe zgjerim të mëtutjeshëm të bizneseve. “Komuna e Gjilanit jo që njihet më parë si një vend industrial, por edhe tani me këta prodhues dhe ndërmarrës e mbajnë jetën gjallë. Janë këta më meritoret për gjendjen që e kemi në zhvillimin ekonomik, në rrugën të cilën e kemi marr për të ecur përpara”, ka thënë Haziri. Për më tepër ai nënvizoi faktin që në cilësinë e kryetarit të Komunës ka ofruar partneritet të plotë për bizneset. Produktet që sot prodhohen në Gjilan janë me kualitet të lartë dhe plotësojnë të gjitha standardet. Ndërmarrjet e Gjilanit na bëjnë krenar si brenda ashtu edhe jashtë Kosovës. Në tregun evropian kemi sot produktet tona në tetë shtete të BE-së, ka thënë Haziri. Ndërsa Safet Gërxhaliu, kryetar i OEK, ka thënë se bizneset janë heronjtë e Kosovës pas luftës, sepse familjet gjilanase po sigurojnë jetesën nga puna dhe veprimtaria e këtyre ndërmarrjeve. Sipas tij, prioritetet e Komunës së Gjilanit janë në harmoni me ato të OEK. Nëse synohet hapja e vendeve të punës, sjellje të investimeve të huaja këtu, duhet të krijohet një zonë e lirë industriale dhe duhet të bëhet ende më tepër për mbështetjen e sektorit privat, në veçanti atij prodhues në Kosovë, gjë për të cilën ne gjithmonë do ta lavdërojmë dhe mbështesim Komunën e Gjilanit në këtë rrugë për ta lëvizur përpara ekonominë e vendit. Ndryshe kryetari Haziri ka bërë të ditur se këtë vit do të rikthehet panairi me traditë 100-vjeçare i prodhimeve vendore që do të mbahet gjatë muajit korrik dhe panairi tjetër që do të mbahet në muajin tetor.

Me ushqime dhe dru për ngrohje ndihmohen 700 familje

30 janar 2014

Për të lehtësuar sadopak pak jetën e familjeve skamnore, Komuna e Gjilanit ka filluar me shpërndarjen e pakove ushqimore dhe drurëve për ngrohje. Mursel Zymberi, ushtrues i detyrës së drejtorit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, ka thënë se në programin e dimërimit, janë përfshirë gjithsej 700 familje të kësaj komune.

Sipas Zymberit, 400 familje do të marrin pako ushqimore, ndërsa 300 të tjera do të ndihmohen me nga 2 metra dru për ngrohje. Në fshatra paraqitet nevoja më shumë për ushqime, ndërsa në qytet kërkesat për dru janë më të mëdha. Në Gjilan, në asistencë sociale janë të përfshirë mbi 1100 familje. Kërkesat për asistencë janë shumë më të mëdha, sipas zyrtarëve të Qendrës për Punë Sociale, por kriteret për të qenë përfitues, janë shumë të ashpra.

Haziri: Gjilani është shtylla më e fortë e pavarësisë së Kosovës

17 shkurt 2014

Nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri është mbajtur sonte një koncert i madh para Teatrit të Qytetit, për nderë të gjashtë vjetorit të shpalljes së pavarësisë së Kosovës.



Duke folur para mijëra të pranishmëve, kryetari Haziri, njëri prej nënshkruesve të deklaratës së pavarësisë së Kosovës, tha se jam krenar që jam para jush, para qytetarëve të mi, para bashkëkombësve, para familjes sime, që të festoj 6-vjetorin e pavarësisë së Republikës së Kosovës.

Më tutje Haziri tha se kjo rrugë e jona nuk ka përfunduar, përderisa ne nuk ia arrijmë qëllimit tonë, përderisa të vendosim barazi ekonomike, sociale, barazi për gjithë shqiptarët kudo që janë. Më lejoni sonte që përveç Gjilanit, t'i urojë Preshevës, Bujanovcit, Medvegjës, e kudo që jetojnë

shqiptarët sepse festa pa ta është e mangët. Festa pa të drejtat e tyre nuk është e plotë. Festa pa veriun e Kosovës nuk është e plotë. Ne si gjilanas, e festojmë sonte pavarësisë më mirë se Prishtina, Peja e Prizreni, jo për diçka tjetër, por sepse ne jemi Anamoravë që e bashkon Karadakun e Gollakun, bashkon shqiptarët e Preshevës, Bujanovcit Medvegjës, Gjilanit Kamenicës, Vitisë. Në veçanti jemi të nderuar për të shënuar këtë përvjetor të madh dhe për të siguruar që do të ecim bashkë deri në realizimin e integritit kombëtar. Jam në veçanti i nderuar që në këtë 6-vjetor, kthehem në Gjilan si i pari i qytetit, duke qenë në mesin tuaj, ansamblit të Gjilanit, doajenëve, rapsodëve dhe njerëzve si Demir Krasniqi dhe shumë emrave të tjerë që Gjilani u ka borxh për t'i vendosur aty ku e meritojnë. Ju siguroj që tash e tutje nuk do të ketë ndërtesa komerciale, këste 24 muaj e etj., por do të ketë emra të dëshmorëve, emra të përvjetorëve, data të mëdha dhe mbi të gjitha respektin për ata që sot na mungojnë – dëshmorët dhe heronjtë e kombit. Ky qytet është i Idriz Seferit, i Mulla Idriz Gjilanit, Agim Ramadanit dhe ne sonte i nderojmë të gjithë dëshmorët, familjet e tyre dhe sonte Gjikani i duartroket këta tre emra të mëdhenj, që në mesin e tyre, janë edhe mijëra qytetarë, dëshmorë, martirë, që e meritojnë të përmenden. Gjilani ka dhënë altarin e lirisë, ka vënë themelet e lirisë dhe ne gjuhëzohemi para tyre. Në 7-vjetorin e pavarësisë, në vitin e ardhshëm, këtu do ta kemi edhe Idriz Seferin së bashku me Agim Ramadanin. Do t'i kemi të gjithë ata që duhet t'i nderojmë, sepse Gjilani është shtylla më e fortë e pavarësisë së Kosovës. Kjo shtyllë do të jetë e fuqishme, do të sigurojë të gjithë shqiptarët kudo që jetojnë se liria dhe pavarësia është për të gjithë dhe kudo që jetojnë shqiptarët do ta gëzojnë. Mos t'i harrojmë njerëzit si Ibrahim Rugova, presidentin themelues të pavarësisë e komandantin legjendar Adem Jasharin etj., ka thënë Haiziri.

Sovraniteti i Kosovës duhet të shtrihet në kufijtë e vitit 1974

17 shkurt 2014

Amaneti i dy emra të mëdhenj të këtij vendi, presidentit historik, Ibrahim Rugova dhe komandantit legjendar Adem Jashari kërkojnë nga ne që jo vetëm ta ruajmë, por edhe ta zhvillojmë shtetin dhe të drejtat tona politike, ka thënë Lutfi Haziri, kryetar i Komunës, duke folur në seancën solemne të Kuvendit Komunal, kushtuar 17-shkurtit -Ditës së Pavarësisë.

Për nder të 6-vjetorit të pavarësisë së Kosovës, Kuvendi Komunal i Gjilanit ka mbajtur seancë solemne, ku fillimisht, kryesuesja Valentina Bunjaku-Rexhepi ka thënë se shteti i Kosovës është rezultat i sakrificës së gjatë të bijve dhe bijave tona, i njerëzve tanë që luftuan me penë e me pushkë për këtë ditë.



“Ne kemi obligim dhe përgjegjësi që amanetin e presidentit Rugova për një Kosovë të pavarur dhe të lirë ta qojmë në vend”, ka thënë ajo. Ndërkaq, kryetari i Komunës, Lutfi Haziri, duke iu drejtuar këshilltarëve komunalë si dhe pjesëmarrësve tjerë të seancës solemne, ku ishte i pranishëm edhe Mehmet Halimi, qytetar nderi i Gjilanit, ka thënë se 17 shkurti është meritë e të gjithë atyre që punuan, u angazhuan dhe u

sakrifikuan për këtë ditë të bardhë, që shënon përmbylljen e procesit politik të statusit të Kosovës dhe natyrisht shënon kthesën e madhe për të drejta politike të të gjithë shqiptarëve, kudo që janë. 6 vjet pas pavarësisë, ka mbetur ende shumë për t’u bërë. Pavarësia dhe sovraniteti jonë nuk shtrihet ende në të gjitha pjesët e Republikës.

Ky sovranitet duhet të shtrihet në territorin e kufijve të vitit 1974, duhet të shtrihet deri në ato fshatra, qytete e vendbanime ku jetojnë qytetarët e Republikës së Kosovës, pavarësisht a janë në lindje a në veri, a janë në jug apo në perëndim, ka thënë Haziri. Haziri tha se Kosova vjeneze, e cila përmbylli kapitullin e pavarësisë së Kosovës, nuk i ka zgjidh të gjitha problemet sikur nuk janë zgjidhë të gjitha problemet e Shqipërisë londineze. Ne sot kemi për obligim që të punojnë në realizimin e të drejtave të qytetarëve në Gjilan, pa pretenduar asnjëherë për të dalë jashtë asaj që kemi mandat politik. Obligimi që kemi na bënë thirrje që t’i trajtojmë barabar qytetarët. Në radhë të parë, sundimi ligjit duhet të vendoset në të gjitha zyrat, ambientet, rrugë dhe në të gjitha segmentet tjera të punës. Detyrë e të gjithë neve së bashku është që ai amanet i madh i dëshmorëve, ai mision i madh i tyre, të shkojë në vend. Ata na mësuan ta luftojnë padrejtësinë, ata na mësuan ta kërkojmë lirinë, ata na bënë që ne sot ta shënojnë këtë ditë. Prandaj, ne nuk kemi detyrë tjetër më të rëndësishme se kjo. Haziri ka kërkuar angazhim në dy binarë. Njëri prej këtyre angazhimeve duhet të jetë ai për ushtrimin e sovranitetit tonë në tërë territorin, ndërsa tjetri, ka të bëjë me realizimin e kërkesave të qytetarëve. Njerëzit sot duan të dinë se di do të jetë e ardhmja e tyre. Haziri ka thënë se liria dhe demokracia, pa sundimin e ligjit, janë të kërcënuara. Ai garantoi se këto vlera, në Gjilan do të mbisundojnë mbi çdo ego a interes tjetër grupor, klanor a politik. Duke e përmbyllur fjalën e tij, Haziri ka thënë se amaneti i dy emra të mëdhenj të këtij vendi, presidentit historik, Ibrahim Rugova dhe komandantit legjendar Adem Jashari kërkojnë nga ne që jo vetëm ta ruajmë, por edhe ta zhvillojmë shtetin dhe të drejtat tona politike. Për t’i lëvizur sa më shpejt këto procese, ai e ka nënvizuar edhe nevojën për bashkëpunim të brendshëm. Integrimi ynë i brendshëm, është parakusht për integrim evropian, ka thënë Haziri.

Dëshmorët vunë themelet e shtetit të Kosovës

17 shkurt 2014

*Kryetari i
Komunës së
Gjilanit, Lutfi
Haziri, i
shoqëruar nga
zyrtarët
komunalë, ka
bërë sot homazhe
te Varrezat e
Dëshmorëve dhe
tek Lapidarët, në
ditën e shënimit
të gjashtë vjetorit
të shpalljes së
pavarësisë së
Kosovës.*



Në fjalën e rastit, kryetari Haziri ka thënë se 17 shkurti shënon kthesën e madhe historike të popullit të Kosovës, ndërsa tha se po i nderon dëshmorët për nderë të sakrificës së tyre, të cilët për këtë ditë të bardhë nuk kursyen as jetën.

“Ky 6-vjetor duhet të na motivojë dhe obligojë të vazhdojmë rrugën tonë për shtrirjen e plotë të pavarësisë dhe lirisë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës e në veçanti për ata që sot vazhdojnë me qenë të diskriminuar siç është rasti me shqiptarët e Kosovës Lindore.

Përderisa nuk zgjidhet problemi i tyre, ata mbeten një Kosovë e vogël në afërsi të Kosovës vjeneze që është padrejtësi e kohës së vet, por besojmë shumë se ecja jonë, rruga jonë drejt një integrimi të brendshëm dhe një integrimi më të madh shqiptar, do të shkoj paralelisht me integrimin europian që është aspiratë.

Në këtë ditë të bardhë ne i falënderohemi familjeve të dëshmorëve pasardhësve të atyre që sakrifikuan dhe gjaku i tyre në themelet e lirisë së Kosovës u bë shkas që ne sot të jetojmë në liri dhe të jetojmë në këtë shtet”, ka thënë Haziri. Me këtë rast, kryetari Haziri ka thënë se projekti i parë i Komunës është rregullimi i varrezave të dëshmorëve sepse, siç tha, nuk mund të ndihemi rehat që dëshmorët akoma nuk kanë vend të rregulluar si i ka hije.

“Rregullimi i varrezave do të jetë projekti i parë që qeverisja komunale do ta bëjë. Ky nuk është vetëm prioritet por është edhe obligim kjo detyrë e pakryer dhe e mbetur përgjysmë. Kjo nuk i lë rehat, edhe neve të gjallëve që jemi sot, sepse qytetarët meritojnë që në një ambient ku prehen dëshmorët dhe heronjtë e kombit që kanë dhënë shumë jo vetëm për Kosovë”, ka thënë Haziri. Natyrisht, do të shikojmë mundësinë edhe të varrit të Idriz Seferit dhe varrezave të dëshmorëve dhe heronjve të padeklaruar që janë shumë në anën tonë dhe natyrisht që kanë mbetur ende të pandriçuar.

Ky vend do të bëhet një vend për të gjithë qytetarët, por ky vend ku prehen heronjtë dhe dëshmorët duhet të jetë një vend vërtet i rregulluar mirë dhe do të jetë detyrë e parë e Komunës, tha Haziri.

Manifestimi për nderë të gjashtë vjetorit të shpalljes së Kosovës realizohet nën përkujdesjen e kryetarit Haziri dhe vazhdon me seancën solemne në Kuvendin Komunal, koncertin për fëmijë, koncertin e muzikës klasike, për të përfunduar me koncertin e madh festiv.

Administrata e heq pauzën në shërbimet për qytetarë

27 shkurt 2014

Drejtorja e Administratës së Përgjithshme në Gjilan ka marrë vendim që prej datës 27 shkurt 2014 të heq pauzën ditore për dhënien e shërbimeve për qytetarë, e cila deri tani ka qenë prej orës 12:00-13:00. Drejtori i Administratës së Përgjithshme, Nazim Gagica, ka thënë se heqja e pauzës është bërë për të shmangur tollovinë që krijohet në ora 13:00 nga qytetarët që presin në radhë për të marrë shërbimet.

Ky vendim është marrë për t’iu ofruar qytetarëve shërbime më të mira, duke iu dhënë mundësi që këtë ta bëjnë edhe gjatë kohës së pauzës, ka thënë drejtori Nazim Gagica.

Me këtë rast, Gagica tha se ky vendim ka qenë sfidë për Drejtorinë, duke e marrë parasysht mundësinë e stafit. “Është dashur që të bëjmë ndryshime në dhënien e shërbimeve, për shkak se kemi mungesë të stafit, por në bashkëpunim me punëtorët, kemi arritur që të krijojmë një organizim të brendshëm funksional dhe efikas në të gjithë sektorët”, ka thënë ai. Tani e tutje, edhe punëtorët e sektorit publik dhe privat do të kenë mundësi që ta shfrytëzojnë kohën e pauzës për të nxjerrë dokumente në administratë.

Haziri premtom përkujudesje për personat me nevoja të veçanta

28 shkurt 2014



Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka vizituar sot Shoqatën e të Verbërve në Gjilan dhe i ka siguruar drejtuesit e saj për mbështetjen e vazhdueshme të institucioneve lokale, për të qenë sa më afër shoqërisë dhe realizimit të planit dhe programit të tyre.

Me këtë rast kryetari Haziri ka thënë se sot është në këtë shoqatë vetëm për t'u konfirmuar atyre se mbështetja dhe kujdesin e Komunës i cili do të jetë përherë në interes dhe shërbim të qytetarëve-anëtarëve të kësaj shoqate që numri i tyre është mbi 500. Nga ana tjetër Bajram Spahiu, kryetar i Shoqatës së të Verbërve, e ka falënderuar kryetarin Haziri për vizitën dhe mbështetjen e Komunës për këtë kategori të shoqërisë, duke e informuar me gjendjen në të cilën është shoqata, nevojat por edhe organizime të ndryshme që bëhen nga shoqata.

Mirëpriten investimet e bashkatdhetarëve në energjinë solare

1 mars 2014

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka pritur në zyrën e tij një grup bashkatdhetarësh që jetojnë në Gjermani, të cilët dëshirojnë të investojnë në Gjilan. Daniel Hagemann, drejtor i kompanisë gjermane “e2tc” i ka prezantuar kryetarit Haziri projekte për energjisë solare dhe ka kërkuar mbështetjen e tij.

“Jemi të interesuar për investime në Gjilan, meqë jam me prejardhje nga Gjilani. Projektet kanë të bëjnë me investimet në energjinë solare dhe në këtë mënyrë do të përfitojmë edhe vende të reja të punës. Kërkojmë mbështetjen tuaj si Komunë për projektet tona”, është shprehur z. Hagemann. Kryetari Haziri është shprehur shumë mirënjohës për interesimin e kësaj kompanie për të investuar në Gjilan, duke i ofruar mbështetje me gjithë kapacitetet komunale. “Komuna

mirëpret çdo investim, veçanërisht nga bashkatdhetarët tanë”, ka thënë Haziri. Edhe në Kosovë kërkohet që 20 për qind e energjisë të jetë solare, alternative. Energjia solare është diçka e re për ne në Kosovë, ka thënë Haziri, duke shtuar se do të jetë një investim shumë i mirë. Gjithçka që është në përgjegjësi të Komunës, si për sigurimin e çështjeve administrative, pronës e çështje të tjera, do të jemi qind për qind në dispozicionin tuaj, ka thënë kryetari Haziri gjatë takimit me përfaqësuesit e organizatës “e2tc”, të cilët në Gjilan parashikojnë investime milionëshe.

Të shpëtohet një jetë do të thotë të shpëtohet bota

10 mars 2014



Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, i shoqëruar nga nënkryetari Rexhep Kadriu dhe drejtorët komunalë, kanë marrë pjesë sot në aktivitetin bamirës të organizuar në Teatrin e Qytetit, nga Forumi i Rinisë i Lidhjes Demokratike të Kosovës në Gjilan, për ndihmë Omer Mehmetit, i cili vuan nga një sëmundje e rëndë. Në këtë ngjarje ka marrë pjesë edhe kryetarja e këtij Forumi, Rina Ahmeti

Në fjalën e rastit, kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, ka thënë se aktiviteti i sotëm tregon ditë të bardhë për gjilanasit, të cilët janë të gatshëm për të ndihmuar njerëzit që kanë nevojë. Ai tha se Komuna e Gjilanit do ta mbështesë me mundësitë e saj këtë djalosh për t’iu kthyer jetës normale. “Jam shumë krenar me solidaritetin tuaj që keni treguar sot për Omerin. Ai ka nevojë për mbështetje nga të gjithë ne. Kemi ardhur sot për t’u solidarizuar me Omerin. Komuna e Gjilanit do të bëjë të pamundurën për ta ndihmuar këtë djalosh. Po ashtu, do të kërkojmë ndihmë edhe nga Ministria e Shëndetësisë. Zoti ju shpërbleftë për këtë humanizëm. Të shpëtohet një jetë do të thotë të shpëtohet bota”, ka thënë kryetari Haziri. Në këtë aktivitet, u tha po ashtu se solidariteti dhe bamirësia kanë qenë tipare që gjithmonë e kanë karakterizuar popullin tonë, duke kërkuar që edhe në të ardhmen të vazhdojnë të ndihmojnë njerëzit që kanë nevojë. Më pas është shfaqur filmi “The bodyguard” me regji të Mirton Xhekaj, i cili ka karakter socio-ekonomik. Bileta ka kushtuar 1 euro dhe të gjitha mjetet që janë mbledhur do të shkojnë për në fondin e Omer Mehmetit.

Haziri mban takimin e Bordit të drejtorëve në prani të mediave

Gjilan, 20 mars 2014

Lutfi Haziri, kryetar i Komunës së Gjilanit e ka nisur praktikën e re të mbajtjes së mbledhjeve me Bordin e drejtorëve të Komunës së Gjilanit të hapur për mediat dhe shoqërinë civile, që është e 32-ta që nga marrja e pozitës së kryetarit.

Kjo praktike e re e punës, kryetari Haziri tha se po bëhet për të qenë transparent qind për qind me qytetarët e Komunës së Gjilanit. Me të nisur mbledhja, Haziri tregoi edhe për praktikën e re të ekspozitave në Zyrën e kryetarit, ku për çdo muaj do të promovojnë veprat e tyre artistët gjilanas. Sot është hapur ekspozita e profesoreshës Magbule Xhemajli dhe veprat e saj do të promovohen për një muaj.

“Mbledhja e kësaj natyre po bëhet në mënyrë që mediat, shoqëria civile dhe qytetarët të përcjellin angazhimet tona, modelin e punës, formën e punës, formatin e punës, dhe vendimmarrjen në Komunës tonë lidhur me zgjidhjen e problemeve”, tha Haziri.

Kryetari Haziri ka deklaruar se me sukses po përmbyllet faza e parë e punëve, që ka të bëjë me tranzicion të pushtetit, implementim të rezultateve zgjedhore, identifikim të problemeve etj.



“Për hirë të njoftimit të qytetarëve, prej 24 dhjetorit e deri më sot, duke pasur parasysh edhe një periudhë kohore ku drejtorët e rinj janë angazhuar më vonë, pasi ka pasur angazhime të ushtruesve të detyrave, deri sot ne kemi arritur ta përmbyllim fazën e parë të punëve që ka të bëjë me tranzicion të pushtetit, implementim

të rezultateve zgjedhore, identifikim të problemeve, prerje buxhetoreve, dëgjim të qytetarëve. Në zyrat tona, prej 24 dhjetorit i kemi dëgjuar kërkesat problemet dhe hallet e mbi 4000 qytetarëve, të cilat janë kryesisht kërkesa sociale, të strehimit dhe punësimit”, ka thënë Haziri.

Më pas janë dëgjuar raportet e të gjithë drejtorëve të drejtorive të Komunës së Gjilanit, për punën

e tyre që nga marrja e pozitës udhëheqëse.

Kryetari Lutfi Haziri, pasi ka dëgjuar raportet e secilit drejtor, ka bërë publike formimin e dy Task Forcave, atë për bujqësinë dhe për grumbullimin e listës së borxheve që i kanë qytetarët dhe subjektet ndaj Komunës, pas Task Forcës së themeluar më herët për menaxhimin e thatësisë.

Gjithashtu, në këtë mbledhë të Bordit është publikuar alokimi i 100 mijë eurove për rastet sociale, me të cilën do të merret Drejtoria e Shëndetësisë, që përfshinë renovimin, rehabilitimin, ndërtimin e shtëpive për skamnorët dhe rastet e rënda sociale. Këto mjete përfshinë edhe rastet më të rënda si të moshuarit, familjet me jetim dhe me probleme sociale që gjendja apo jeta i ka rënduar në këtë pozitë që janë.

Poashtu, në 3 mujorin e parë janë ndarë 2.5 milionë euro për investime në infrastrukturë rrugore, kanalizime, ujësjellës, trotuare dhe ndriçim. Komuna e Gjilanit në ka konkurruar në 12 programe të donatorëve të ndryshëm, ndërsa në konferencën e donatorëve ka konkurruar me 4 projekte të regjionit lindje.

Projekti i parë që do të nis është rregullimi i varrezave të dëshmorëve, pastaj rregullimi u rrugës me 4 korsi nga rruga e Malishevës në drejtim të rrugës së Bujanocit.

Kryetari Haziri e informoi Këshillin të Drejtorëve për hapin e madh për përfshirjen e Gjilanit në zonën e lirë ekonomike, ku Gjilani është qendër e mikro-regjionit të lindjes, Gjilan- Preshevë- Kumanovë, në të cilin marrin pjesë edhe 17 komuna të tjera.

Ai tha se në këtë fazë hyjnë edhe ndërtimi i shkollës së arteve dhe qendrës për rini.

Kryetari i Gjilanit ka thënë se si nevojë e realizimit të shpejt, është ndërtimi i dy çerdheve, njëra në Dardani dhe tjetra në qendër sepse duhet larguar nga objektet që janë me qira.

Projekt tjetër me rëndësi është Tregu i Gjelbër, ku do të themelohet ndërmarrja për tregjet në mënyrë që të bëhet modernizimi i atij lokacioni, në të cilin qarkullon një numër i madh i qytetarëve.

Projekti tjetër është ndërtimi i kinemasë së qytetit dhe zgjidhjes së problemit të statusit të Teatrit të qytetit, si dhe ndihmesa për kulturën, rininë dhe sportin.

Vendimi tjetër është vendimi për shpalljen e ankandit për shitjen e veturave të vjetruara pasi shpenzimet dhe mirëmbajtja e tyre rëndojnë buxhetin e Komunës.

Gjithashtu, Haziri ka informuar se ditëve në vazhdim do ta marrim vendimin që ushtrimin pozitës së kryetarit, nënkryetarit dhe kryesueses për njëditë ta bëjnë fëmijët nga mosha 13 deri 17 vjeçare.

Haziri poashtu tha se që nga sot, ka nisur zhvendosja e stafit të zyrës së Kryetarit, për t'ia liruar

objektin Muzeut të Gjilanit, e që ishte edhe premtim i tij nga fushata elektorale.

Ndryshe, kjo mbledhje e Këshillit të Drejtorëve është transmetuar drejtpërdrejtë në dy radio lokale; radio viktoria dhe radio star.

Haziri inkurajon bujqit që të punojnë çdo cep të tokës

21 mars 2014



Lutfi Haziri, kryetar i Gjilanit i ka nxitur bujqit e kësaj komune që të punojnë çdo pëllëmbë toke. Ai ka folur në një debat me fermerë, të organizuar nga Drejtoria e Bujqësisë, ku kanë marrë pjesë deputeti Ramiz Kelmendi, nënkryetari i Komunës, Rexhep Kadriu si dhe drejtori për Bujqësi, Ramiz Ramadani. Punimi i tokës bujqësore, pos që

sjellë të mira për familjen, krijon mundësi për gjenerim të vendeve të reja të punës, fitim dhe eksport të prodhimeve, u tha në këtë debat. Haziri tha se Anamorava është zona më e madhe agro-industriale në Kosovë.

“Anamorava është zona më e madhe agro-industriale në Kosovë dhe duhet që të punohet çdo cep i tokës bujqësore në regjionin tonë. Vetëm me punë në bujqësi mund të gjenerojmë sa më shumë vende pune në Komunën tonë dhe në këtë regjion”, ka thënë Haziri. Në nivelin lokal së bashku me juve fermerët, me donatorët dhe me nivelin qendror po mundohemi që ta kthejmë namin të cilin e meriton Anamorava.

Në së bashku duhet të përqendrohemi në prodhim dhe shtim të buxhetit për bujqësinë”, ka thënë ndër të tjerë kryetari Haziri. Ndërsa, deputeti Ramiz Kelmendi, referues në këtë debat, ka thënë se duke u bazuar në praktikën reale në Kosovë shihet qartë se e vetmja rrugë për të punësuar sa më shumë njerëz dhe për të sjellë përfitime për vendin është bujqësia si tërësi. “Nevojat e Kosovës janë shumë të mëdha për produktet bujqësore”, ka thënë Kelmendi. Për më tepër ai ka

thënë se bujqësia është një degë e vështirë, mirëpo është rruga e vetme për të punësuar qytetarët tanë, për të siguruar produkte nga toka e Kosovës dhe për të siguruar fitime për vendin. Toka e Kosovës duhet të mbulohet me serra. Prodhimi i produkteve bujqësore është prodhimi më i sigurt në vend kur e kemi parasysh konsumin shumë të madh.

Nëse merren me kujdes dhe shikohen statistikat reale të ekspertëve tanë shohim qartë se nevoja për prodhim është e domosdoshme. Brenda një viti në Republikën e Kosovës konsumohen rreth 16 milionë kg domate, rreth 32 milionë kg shalqinj, mbi 45 milionë kg mish ose 420 krerë gjedh brenda ditës etj. Hapat lehtësues që duhet të merren nga qeveria janë ndryshimi i politikave ligjore për kreditë, subvencionimi i një përqindje të kamatës për fermerët, mbështetja me grante dhe subvencione direkte për bujqësinë, sigurimin e autostradave për ujitjet bujqësore etj, tha Kelmendi. Ndryshe, në këtë debat interesimin me pyetje e kanë shprehur fermerët për tema të ndryshme lidhur me bujqësinë, prodhimin, eksporti, kreditë, fitimin dhe çështje të tjera bujqësore.

Asnjë cent për dreka zyrtare

28 mars 2014

Komuna e Gjilanit në krye me Lutfi Hazirin, që nga marrja e detyrës më 24 dhjetor e deri më sot, nuk ka harxhuar asnjë cent për dreka zyrtare. Kryetari Haziri ka thënë se do të jemi edhe më shumë në dietë buxhetore, për shkak të vështirësive që kemi, sepse nëse nuk parandalohet tash, Komuna shkon drejt falimentimit buxhetor. Haziri tha se duke e rritur disiplinën buxhetore, krijojmë fonde e buxhet për investime, që është efekti më i madh.

“Duke e rritur disiplinën buxhetore ne krijojmë fonde, buxhet për investime që është efekti më i madh, sepse mjetet që ruhen do të shkojnë në investim, si në rrugë, shkolla, kanalizime dhe infrastrukturë tjetër publike, e jo ajo çfarë ka ndodhur që gati gjysmë milion euro harxhohen në ushqim dhe pije, e që faturat janë ato që nuk dëshmojnë për një ligjshmëri të atij shpenzimi”, ka thënë kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri.

Ndërsa, vetëm në vitin 2013, qeverisja e kaluar ka harxhuar për dreka zyrtare, ushqim dhe pije hiç më pak se 466 mijë euro. Për dreka zyrtare janë harxhuar mbi 316 mijë euro, ndërsa për ushqim dhe pije mbi 150 mijë euro që nëse përpjesëtohen me 288 ditë pune i bie që 1,618 euro janë shpenzuar për një ditë pune për dreka zyrtare, ushqim dhe pije.

Para veprave të dëshmorëve e martirëve ne gjithmonë jemi të vegjël

30 mars 2014

Në shkollën fillore që e mban emrin e dëshmorit Agim Ramadani në Zhegër, është mbajtur sot një manifestim përkujtimor kushtuar martirëve të Grykës së Karadakut, të cilët u vranë nga forcat militare e paramilitare serbe në mbrojtje të pragut të shtëpisë më 30 mars të vitit 1999. Në këtë manifestim ishte i pranishëm kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, nënkryetari i Komunës, Rexhep Kadriu, me drejtorët komunal, si dhe përfaqësues nga jeta politike, e shoqërore, veprimtar e aktivist të Gjilanit.



Kryetari i aktivitetit në Zhegër, Rrahman Agushi, ka thënë se ky përvjetor na ka bashkuar gjithmonë pa dallim partie dhe përkatësie fetare, që të jemi bashkë më familjarët në këto ditë të rënda, ku të gjithë kthejmë memorien dhe i përkujtojmë tmerret që i përjetuan familjet tona. Ndërsa, kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, tha se falë martirëve e dëshmorëve tanë ne sot po e gëzojmë lirinë e Kosovës. Ai tha se para veprave të dëshmorëve e martirëve ne gjithmonë jemi të vegjël. “Sot i përkujtojmë martirët e kësaj ane dhe i falënderojmë ata e familjet e tyre për këtë sakrificë sepse ata dhanë gjënë më të shtrenjtë për lirinë e popullit të Kosovës. Ata e mbron pragun e shtëpisë së tyre dhe ajo rezistencë dhe intervenimi i NATO-s u bënë shkas për të fituar lirinë dhe pavarësisë e Kosovës.

Ne e kemi për obligim të kujdesemi për familjet e të martirëve dhe dëshmorëve. Para veprave të dëshmorëve e martirëve ne gjithmonë ndihemi të vegjël”, tha Haziri.

Në emër të familjeve të të rënve për liri foli Tahir Tahiri, i cili tha me dhembje e kujtojmë këtë ngjarje, por në të njëjtën kohë edhe me krenari, pasi që martirët e kësaj ane u flijuan për të gëzuar ditët që sot po jetojmë. Ai kërkoi mbështetje institucionale për familjet e tyre, pasi sipas tij, deri me tash ka munguar.

Një fjalë rasti pati edhe shkrimtari i Karadakut, Sabit Rustemi, i cili theksoi se ky përvjetor le të na mobilizojë, në rend të parë për t’i vu para drejtësisë urdhërdhënësit dhe ekzekutorët e këtyre martirëve, gjë që nuk është bërë deri tash, përkundër një padie të ushtruar si dhe kërkesës së vazhdueshme. Në fund, për të begatuar këtë manifestim, nxënësit e shkollës fillore “Agim Ramadani” shfaqën një program, me theks të veçantë recituan poezi patriotike.

Gjilani si qendër e mikro-regjionit evropian duhet të përfshihet në makro-planet investuese të qeverisë

1 prill 2014

Ideja për krijimin e një zone të lirë ekonomike në rajonin e Anamoravës, është diskutuar në Gjilan nga zëvendëskryeministri Behxhet Pacolli dhe drejtuesit e Komunave Gjilan e Kamenicë, Lutfi Haziri e Begzad Sinani, me ekonomistët e kësaj pjese të Kosovës, ku kanë marrë pjesë edhe ministrat Fadil Ismajli (MZHE) e Bernard Nikaj (MTI). Gjilani është Komuna ku në dhjetëvjeçarin e fundit nuk është investuar në asnjë infrastrukturë regjionale, edhe përkundër faktit që Gjilani është qendër regjionale e Anamoravës dhe ka korridorin ndërkombëtar shumë afër, ka thënë Haziri.

Fillimisht, Lutfi Haziri, kryetar i Komunës së Gjilanit, ka thënë se vizitat e këtyre ditëve të qeveritarëve në Gjilan, janë shenjë se po kthehet kujdesi i munguar për këtë rajon, për disa vite. Haziri tha se Gjilani është komuna e vetme në Kosovë që ka pasur më shumë shpenzime për mallra dhe shërbime se sa për investime, ndonëse është një qytet i rëndësishëm për këtë rajon. Rruga Gjilan-Prishtinë, Gjilan-Ferizaj, Gjilan – Dheu i Bardhë, Gjilan-Kumanovë, nëpërmjet Stançiqit dhe Gjilan-Preshevë, sikurse dhe infrastruktura tjetër rrugore, janë detyra që duhet të realizohen sa më shpejt, ka thënë ai. Prej vitit 2004, Gjilani është qendër e mikro-regjionit evropian dhe si i tillë duhet patjetër të përfshihet në makro-planin investues të qeverisë së vendit. Gjilani është në përparësi nga regjionet tjera, sepse Gjilani e ka emblemën e Parlamentit Europian për qytet të paqes, që pak Komuna në Ballkan e kanë. Kjo emblemë, Gjilanit i jep mundësi që përveç qeverisë dhe institucionet financiare të kontraktuara nga ana e qeverisë, të ketë të drejtë dhe mundësi të fitimit të projekteve të ndryshme që mund t'i realizojmë. Mikro-regjioni nuk e përfshinë vetëm Anamoravën, por ka 17 Komuna dhe kalon në tri shtete, duke e prek edhe kufirin e Bullgarisë përmes një Komune. Ky mikroregjion duhet të shtyhet në plane dhe master plane të qeverisë, tha kryetari Haziri. Kurse Ismajl Januzi, drejtor i Zhvillimit Ekonomik, ka thënë se gjatë viteve të kaluara, në këtë regjion është investuar më së paku dhe kjo ngecje në ndërtimin e infrastrukturës, ka ndikuar edhe në moszhvillimin ekonomik.

Ndërkaq, Behxhet Pacolli, zëvendëskryeministër i qeverisë së Kosovës, tha se Gjilani dhe Kamenica duhet të gjejnë një hapësirë prej mbi 200 hektarësh, për të krijuar një zonë të madhe ekonomike, e cila gjithsesi duhet të jetë afër me Serbinë dhe Maqedoninë, për shkak të shqiptarëve që jetojnë në këto dy shtete fqinje. “Zona e lirë ekonomike mund të ndihmojë fuqishëm zhvillimin e një ane”, ka thënë Pacolli. Duke folur në cilësinë e zëvendëskryeministrit, Pacolli tha se kësaj ane i është bërë një dëm i madh deri tani, duke e anashkaluar padrejtësisht nga investimet, edhe pse është pjesë e rëndësishme e Kosovës. Sa i përket projektit të autostradës Prishtinë-Shkup, Pacolli tha se ai është kundër saj, sepse e redukton për 60 për qind qarkullimin

në autostradën e kombit dhe e dëmton projektin për tregun kombëtar, që ka filluar me energjetikën. Sipas meje, ka thënë Pacolli, autostrada duhet të bëhet deri në Ferizaj dhe prej aty të devijojë në drejtim të Gjilanit, për t'u lidhur me pikën kufitare 'Dheu i Bardhë'. Ndërkohë, si resurse të veçanta në këtë regjion, pos platformës agro-ekonomike, ai ka përmendur ujët e kuq mbi Zhegër, që është shumë i rrallë në botë dhe ku mund të bëhet një qendër e fuqishme shëruese dhe rehabilituese. Ndërkaq, Kamenica e ka kaolinin, që është material shumë i rrallë në botë dhe ka vlerë të madhe, ka thënë Pacolli. Fadil Ismajli, ministër i Zhvillimit Ekonomik e Bernard Nikaj, ministër i Tregtisë dhe Industrisë, premtuan përkrahje për krijimin e zonave të lira ekonomike, përfshirë edhe Gjilanin.

Për bizneset prodhuese është siguruar një fond prej 4 milionë euro dhe javën e ardhshme do të shpallet ftesa e parë për aplikim, ka thënë Nikaj, duke inkurajuar bizneset që të shfrytëzojnë këtë mundësi, që është krijuar nga Bashkimi Evropian, me 3 milionë euro dhe MTI-ja, që ka siguruar një milion tjera.

100 ditë qeverisje

4 prill 2014

Në mbledhjen e drejtorëve të mbajtur sot për 100 ditëshin e qeverisjes Haziri, është konfirmuar efikasitet më i madh në punë, shërbime më të shpejta dhe kursim të buxhetit të Komunës për një përqindje të pakrahasueshme në raport me vitet më parë. Këshilli i Drejtorëve i udhëhequr nga kryetari Haziri ka bërë publik për qytetarët e Komunës së Gjilanit punën, vështirësitë, përparimet dhe sfidat me të cilat përballlet qeverisja.

Efikasitet dhe shërbimet më të shpejta e kursimi vërehen në secilën drejtori dhe sektorë të tjerë që mbikëqyren ashpër nga Drejtoria e Financave për çdo shpenzim, sepse siç ka thënë me këtë rast kryetari Haziri, duhet të punojmë me këtë intensitet të punës së madhe dhe me kursime maksimale në mënyrë që efikasiteti dhe shërbimet të jenë në dobi të qytetarit. "Komuna është në shërbim të qytetarëve, këtë po e bëjmë dhe dëshmojmë", tha ai. Ndërsa nënkryetari i Komunës Rexhep Kadriu ka thënë se problem i parë me të cilin është përballur kjo qeverisje është mungesa e ujit, për të cilin tashmë me task-forcën e themeluar nga kryetari kemi nisur t'i prekim rezultatet e para nga burimet alternative, të cilat do ta ndihmojnë furnizimin me ujë, siç është lokacioni në livadhet e Koretishtës, lokacionin e "Fidanishtes" dhe tek kazerma e FSK-së, ku jemi në fazën e testimit dhe përgatitjes për hapjen e puseve të reja në këto lokacione.

Ndërsa në projektin e Mirushës ai ka thënë se nga dita e caktimit në këtë projekt për 30 ditë punë janë kryer 400 metra kanalizim dhe deri në fund të projektit kemi edhe 1100 metra por me shtimin e dinamikës në punë kanalizimi do të kryhet në shtator.



Nga java e ardhshme fillon faza e dytë e projektit, mbulimi i lumit nga hoteli “Kristal” deri tek ura që shpie për në shkollën fillore “Musa Zajmi”. Edhe në infrastrukturën rrugore ai ka thënë se janë shpallur rrugët Pogradjë – Bilinicë, Lladovë – Nasal, rrugët në lagjen dheu i bardhë që përfshinë rreth dhjetë rrugë atje, poashtu në lagjen “Dardania” si rrugën “Ali Hadri dhe rrugën 7, 10 dhe 12. Ai ka thënë se këtu nuk përfundon asgjë sepse jemi në përgatitje të projektit dhe në ditët në vijim do të shpallen edhe rreth 20 rrugë të tjera. Në këtë takim Kadriu ka përmendur edhe punët që janë duke u bërë në projektin e hyrjes së rrugës Gjilan – Prishtinë dhe Gjilan – Bujanoc që do të jenë me katër korsi. ‘Është në përgatitje e sipër shpallja e punëve për rregullimin e projektit të varrezave të dëshmorëve, projekt i cili është ndërprerë nga muaji maj i vitit 2012, pa u dhënë asnjë arsye, ky tender për këtë projekt do të shpallet deri kah fundi i javës së ardhshme, ndërsa mjetet për këtë projekt janë nga të hyrat vetanake”, tha Kadriu.

Nënkryetari Kadriu ka thënë se punët që do të shpallen këtë vit Gjilanin e kthejnë në arenën e ndërtimit dhe punës së pandalshme. Në Zhvillimin Ekonomik, pritet ndryshimi i gjendjes për një përqindje shumë të madhe kur kihet parasysh numri i madh i projekteve me të cilat është konkurruar në shumë programe dhe tek shumë donator, ka njoftuar drejtori i Ismail Januzi. Këtë muaj e kemi konferencën e donatorëve, që jemi të bindur se do të përfitoj shumë Gjilani për arsye që seriozitetit dhe profesionalizmit dhe rëndësisë që kanë projektet”, tha Januzi. Projekte të rëndësishme kanë mundur që një numër shumë i madh i fermerëve të përfitojnë, duke nisur nga mbjelljet pranverore, furnizimit me foli plastike, trajnime dhe donacione, që në total për këta

tre muaj janë ndihmuar rreth një mijë fermer, ka thënë drejtori i kësaj drejtorie Ramiz Ramadani.

Kemi projekte serioze që janë duke i prekur fermerët tanë. Duke u nisur nga bashkëpunimi i Komunës me Karitasin, ku kanë përfituar 40 fermer në malësinë e Kishnapoles me mekanizëm bujqësor, 307 fermer me foli plastike, 350 fermer me farë misri, rreth 300 fermer janë trajnuar nga ekspertët, është duke u përgatitur investimi i donatorëve nga Tiroli Austriak për ujitje dhe ndihmë në blegtori, do të nisë ripyllëzimi në Llashticë dhe pyllëzimi në Nasal, janë bërë të gjitha përgatitjet për rrallimin dhe pastrimin e pyjeve në fshatin Zhegër, e që në raport me 100 ditëshin është një punë voluminoze që është bërë nga drejtoria jonë.

"Kështu dhe me intensitet edhe më të shtuar do të ecim përpara, sepse kjo kërkohet nga fermerët tanë dhe ne do të jemi pranë tyre", ka thënë ai ndër të tjerash. Risi do të ketë edhe në drejtorinë e Administratës, pas eliminimit të tolloive para sporteleve dhe neglizhencës në punë që ishte më parë, ku sipas raporteve të një viti më parë janë dhënë shumë më pak shërbime për qytetarët në raport me të punësuarit atje, ka thënë drejtori Nazim Gagica. "Tani me më pak punëtor kemi dhënë shumë më tepër shërbime. Kemi rreth 12 mijë lëndë të shqyrtuara më shumë se periudha e njëjtë e vitit paraprak. Janë kryer të gjitha përgatitjet për fillimin e projektit të ofrimit të shërbimeve në shtëpi për qytetarët përmes Postës, që është një risi për qytetarin dhe shkarkim të pritjeve para sporteleve. Do të avancojmë bashkërisht edhe më shumë punën në Administratë. Poashtu kemi të hyra shumë më të mëdha për këtë tremujor në raport me atë të vitit 2013", ka spikatur ai. Bashkëpunimi dhe funksionimi i hallkave Urbanizëm – Kadastër – Inspeksion, është duke shkuar gjithnjë e më mirë. Drejtorët e këtyre drejtorive, pos efikasitetit të shtuar në drejtoritë e tyre, kanë rritur të hyrat e Komunës dhe janë zotuar se do të jenë kujdestar të zbatimit të ligjit gjithandej Komunës. "Kjo nuk bëhet për ta penguar askë, por për të ndihmuar qytetarin dhe për t'ia lehtësuar atij zhvillimin në familje, biznes apo planifikim", janë shprehur ata. Manifestimi "Flaka e Janarit 2014" këtë vit i ka kushtuar Komunës së Gjilanit për 52 % më lirë se një vit përpara dhe numri i pjesëmarrësve në këtë manifestim është mbi shtatë mijë vetash që i kanë përcjellë aktivitetet e pasura kulturore të manifestimit, ka thënë U.D. i drejtorit Bujar Haziri. Në Shërbimet Publike, Shëndetësi dhe Mbrojtje e Shpëtim, ka po ashtu efikasitet dhe ngritje të shërbimeve për qytetarët.

Është duke u punuar gjithandej nëpër secilin sektor për t'i kryer punët kanë njoftuar drejtorët e drejtorive përkatëse. Në arsim, drejtori Nazmi Musa, ka thënë se janë bërë dhe po bëhen përgatitjet për përmbylljen e suksesshme të vitit shkollor, duke nisur nga testet e maturës e deri edhe te regjistrimi i nxënësve në klasë të parë dhe të dhjetë, sikur që po punohet vazhdimisht në monitorimin e shkollave në punën e tyre. Ai ka informuar edhe për shuarjen e klasës së XIII, por edhe zbatimin e ligjit në çdo aspekt, për të mirën e qytetarëve të Komunës së Gjilanit. Sfidë është borxhi shumë i madh i gjetur, që ishte mbi 800 mijë euro. Sa i përket financave, për këtë ka raportuar drejtori Salih Kqiku, i cili në detaje ka paraqitur të hyrat në secilin sektor, që siç ka thënë ai, ka tejkalime të planifikimit sa i përket të hyrave dhe se trendi i të hyrave është pozitiv.

Gjithashtu ai ka informuar këshillin se është bërë edhe shpërndarja e 24 mijë faturave të tatimit në pronë dhe janë duke i bërë edhe pagesat e borxheve të trashëguara.

“Shpenzimet janë ulur për 50 % në të gjithë sektorët dhe të hyrat kanë shënuar një rritje të cilën ne do të punojmë përdit që ajo të jetë edhe më e madhe. Është shumë e rëndësishme të thuhet që asnjë punë nuk është nisur në Komunë pa i ndjekur procedurat e prokurimit në bazë të ligjit. Disiplina buxhetore do të vazhdoj gjatë gjithë këtij mandati”, ka thënë Kqiku. Ndërsa, në përfundim të takimit të Bordit, kryetari Haziri ka thënë se e gjitha ajo që është thënë deri më tash, është ajo çfarë është gjetur në Komunën e Gjilanit. Borxhet e Komunës janë krijuar dhe kanë të përbashkët një “I” në katror; me Inate dhe me Inercion. “Nuk po e them këtë për të reaguar ndaj askujt, por është një konfirmim i realitetit që e kemi gjetur. Ne do të vazhdojmë qeverisjen tonë me logjikë dhe kulturën e detyrave të hapura dhe transparente. Barometri i punës suaj si drejtor por edhe e imja si kryetar dhe e secilit brenda Komunës është puna juaj, e secilit veç e veç”, ka përfunduar kryetari Haziri.

Krenaria e Gjilanit e ka emrin Agim Ramadani

11 prill 2014



Edhe nipi i dëshmorit Agim Ramadani, që është foshnje disamuajshe dhe që mban emrin e këtij kolosi të luftës për liri, ka bërë homazhe së bashku me kryetarin e Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, para përmendores në qendër të qytetit. Homazhet janë bërë për nderë të shënimit të 15 vjetorit të rënies së dëshmorit Agim Ramadani në Betejën e Koshares.

Homazhet janë bërë për nderë të shënimit të 15 vjetorit të rënies së dëshmorit Agim Ramadani në Betejën e Koshares, ku të pranishëm ishin edhe bashkëluftëtarët e tij, Rustem Berisha, deputeti Anton Çuni etj., familjarë, shokë e miq të Agimit. Kreu i Gjilanit tha se prezenca e Agimit të vogël tregon se Agim Ramadani ka luftuar për gjeneratat e ardhshme. “Kjo është ajo për të cilën Agimi ka luftuar, për gjeneratat e reja, për gjeneratat e ardhshme. Agim i vogël, do të jetë

trashëgues i asaj vlere, i asaj embleme të madhe të luftës për liri. Sigurisht që familja e tij e mban me krenari, por gjithë kjo zonë e Kosovës dhe e shqiptarisë do të jetë histori e shënuar me shkronja të arta”, tha Haziri. Haziri theksoi se Gjilani sot është krenar me Agim Ramadanin, që është sublimim i luftëtarit të Karadakut. “Gjilani sot është krenar. Krenaria e ka emrin Agim Ramadani që është sublimim i luftëtarit të Karadakut, luftëtarit të Gjilanit dhe kësaj pjese të madhe të Kosovës. Lufta për Kosovë dhe për shqiptari ka qenë mision i tij. Fatkeqësisht gjysma e rrugës është realizuar. Amaneti i tyre është që të gjithë shqiptarët, kudo që janë, duhet të jetojnë të lirë e të bashkuar. Sot në Kosovën e lirë duhet të punojmë shumë që ata të pushojnë të qetë. Sakrifica e madhe, gjaku i derdhur, thyerja e kufirit, mbeten simbolika më e madhe, që Agimi dhe bashkëluftëtarët e Brigadës 138 dhe të gjithë bashkëluftëtarët e luftës çlirimtare, e kanë vulosur njëherë e përgjithmonë në Kosovë dhe Gjilan, pohoi Haziri.

Llashtica është Reçaku i Lindjes së Kosovës

13 prill 2014



Në fshatin Llashticë në 15 vjetorin e rënies së martirëve sot është mbajtur Tubim përkujtimor, ku të pranishëm ishin kryetari i Komunës së Gjilanit, z.Lutfi Haziri, nënkryetari Rexhep Kadriu, kryesuesja Valentina Bunjaku – Rexhepi, deputetja Lirije Kajtazi, familje të dëshmorëve dhe banorë të kësaj ane.

Me këtë rast kryetari i Komunës, Haziri, para të pranishmëve ka thënë se pa të rënët e shumë të luftën e fundit të vitit '99, liria që sot po e gëzojmë nuk do të vinte. “Sot përkujtojmë 15 vjetorin e vrasjes së martirëve të këtij fshati të Karadakut, përkujtojmë edhe 70 vjetorin e masakrës së madhe të po këtij fshati dhe do të përulemi përherë para atyre që dhanë gjakun dhe gjithçka nga vetja e tyre, që ne sot të jetojmë e punojmë të lirë. 26 martir të Llashticës dhe shumë të tjerë nga fshatra tjera, janë ata që sot dhe çdo ditë tjetër na bëjnë krenar të gjithë



neve për këto ditë të bardha që po i jetojmë tani. Llastica është Reçaku i Lindjes së Kosovës. Ky është vendi që armiku edhe gjatë tërheqjes së tij ka ushtruar dhunë dhe ka kryer krime ndaj popullatës së pafajshme civile, duke mos kursyer as foshnjat në djep dhe as personat e shtyrë në moshë. Llashtica, Lladova, Zhegra, Llovca, Karadaku dhe gjithë Gjilani kanë dhënë shumë për lirinë e këtij vendi”, ka potencuar ndër të tjerash kryetari Haziri. Në anën tjetër drejtori i shkollës “Esat Berisha”, Nehat Shabani, ka thënë se Llashtica është pjesë e rrugëtimit faqebardhë në lirinë të cilën sot e gëzojmë të gjithë bashkërisht. “Llashtica është pjesë e rrugëtimit faqebardhë në lirinë e Kosovës. Ky fshat i tillë ishte në çdo etapë të historisë që nga 1912-ta. Është fshat që pos martirëve të dhënë për liri edhe në anën materiale kishte dhënë shumë, ku pjesa më e madhe e shtëpive ishin djegur e plaçkitur nga okupatori serb”, ka spikatur ai ndër të tjerash.

Ndërsa në emër të familjeve të martirëve nga Llashtica, Emrush Selimi, i ka falënderuar të gjithë të pranishmit për pjesëmarrjen, duke porositur dhe kërkuar në emër të tyre që një rrugë e qytetit të Gjilanit në të ardhmen të emërtohet me emrin e martirëve të Llashticës. Më pas janë lexuar poezi të përgatitura nga nxënësit e shkollës “Esat Berisha”, me tematikë patriotike dhe në kujtim të të rënëve. Pas tubimit të gjithë bashkërisht kanë bërë homazhe tek varret e të rënëve dhe kanë bërë zbulimin e pllakës së njërës nga martirët, asaj të Ali Selimit. Ndryshe në Llashticë janë vrarë nga okupatori serb, 26 martir duke nisur nga foshja tri javësh e deri tek martiri i moshës 90 vjeçare.

Në Gjilan është zgjeruar hapësira e përfaqësimit të gruas në vendimmarrje

14 prill 2014

Grupi i Grave të Gjilanit (GGGJ) ka diskutuar me Grupin e Grave Deputete të Parlamentit të Kosovës, çështje që kanë të bëjnë me barazinë gjinore, përfaqësimin e femrave në pushtetin ekzekutiv, ligjin e punës dhe zbatimin e tij, sidomos në sektorin privat, buxhetimin gjinor, disa probleme të veçanta në arsim si dhe çështje të tjera.

Gratë deputete, Suzan Novobërdali, Lirije Kajtazi, Salihe Mustafa dhe të tjera thanë se kërkesat e Grave të Gjilanit do të përcillen si rekomandime në nivel qendror të pushtetit, përkatësisht në Komisionet Parlamentare. Valentina Rexhepi-Bunjaku, kryesuese e Kuvendit Komunal në Gjilan, tha se femrat në këtë Komunë, vazhdimisht po fitojnë hapësira përfaqësimi, duke nënvizuar faktin se në vendimmarrje, ato kanë mbi 38 për qind të vendeve, kryesojnë tri

komitete, derisa në ekzekutiv, numri i tyre nuk është ende i mjaftueshëm, por me siguri se do të rritet në të ardhmen, kur të ndahet në tre sektorë Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Ajo tha se personalisht ka qenë dhe mbetet një lobuese e fuqishme e të drejtave të grave, si në vendimmarrje dhe ekzekutiv, ashtu edhe në politikë-bërje. Kryesuesja e GGKGJ-së, Jehona Hyseni tha se kjo vizitë e GGD tregon edhe një herë për vullnetin e bashkëpunimit të nivelit qendror dhe nivelit lokal dhe ndërkohë paraqiti treguesit e përfaqësimit të femrës në nivelin lokal, si në drejtoritë komunale, ashtu edhe nëpër komitete, duke thënë se tri komitete udhëhiqen nga femrat. Komiteti për Politike dhe Financa udhëhiqet nga Valentina Bunjaku, Komiteti për Zhvillim Ekonomik - nga Jehona Hyseni dhe Komiteti për Kulturë, Rini, Sport dhe Çështje Gjinore - nga Shpresa Kurteshi. Udhëheqje e Kuvendit Komunal prej femrave, që po ndodh për herë të parë në Komunën e Gjilanit, konsiderohet sukses, tha Hyseni. Drita Klaiqi, zyrtare për Barazi Gjinore, tha se barazia gjinore nuk është dhuratë e burrave për gratë, por është një e drejtë ligjore. Sadete Trnava (OSBE) tha se gratë duhet të jenë më aktive, sikurse edhe bashkëpunimi mes tyre duhet të jetë më i madh, nëse duan t'i avancojnë të drejtat e tyre edhe më tepër. Ajo tha se Gjilanit i mungon rregullorja për barazi gjinore dhe i inkurajoi gratë që ta bëjnë edhe atë. Suzan Novobërdali ka premtuar se të gjitha këto kërkesa të GGGJ do të përcillen në nivelin qendror. Edhe ajo u pajtua se ligji i punës ka probleme jo vetëm te pushimi i lehonisë, por edhe në disa pika tjera.

Paja, Albani dhe dëshmorët tjerë u bënë drita e lirisë së sotme

15 prill 2014



“Sot, respektojmë Zhegocin dhe Verbicën e Zhegocit, ata që para 15 viteve së bashku me ushtarët e lirisë, përballuan ofensivën më të madhe të regjionit të Gjilanit, ofensivë e cila u shënua me derdhjen e gjakut dhe dëshmorët e parë të luftës çlirimtare në Komunën tonë. Paja, Albani dhe shumë dëshmorë të tjerë, u bënë drita e lirisë së sotme”. Kështu është shprehur kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, në shënimin e përvjetorit 15 jubilar të Betejës së Zhegocit, në të cilën ranë shumë dëshmorë e martirë.



Në këtë manifestim ka marrë pjesë edhe nënkryetari Rexhep Kadriu, drejtorët komunal, kryetari i AAK-së Ramush Haradinaj, deputetë, veteranë të luftës, FKS-ja, policia, aktivist e veprimtar të çështjes kombë-tare.

Kryetari Haziri tha se këtë 15 vjetor kanë vendosur ta mbajnë në

oborr të Shtabit, të familjeve në Zhegoc, në shenjë respekti, nderimi dhe për-kulje për krejt këtë sakrificë të madhe të tyre. Haziri ka pohuar se edhe pas 15 vjetëve rruga në këtë pjesë akoma nuk është përfunduar, ndërsa tha se shumë shpejt vendime të përbashkëta për ta zhvilluar Zhegocin dhe Malësinë e kësaj ane. “15 vjet pas luftës nuk është përfunduar rruga të cilën e kemi nisur, rruga është në gjysmë dhe Kosova po vazhdon të përballet me probleme. Luftëtarët e saj edhe më tutje po vazhdojnë të problem të panevojshme. Gjilani edhe më tutje ka mbetur zonë e harruar, e pas Gjilanit edhe Zhegocin edhe Verbicën kanë mbetur nën harresë. Detyrë e jona është që ta kthejmë shikimin nga Gjilani, Anamorava dhe nga Verbica e Zhegocin. I falënderoj këta njerëz që vazhdimisht punojnë që kjo rrugë njëherë e përgjithmonë të rregullohet, e cila e lidhë Gjilanin me Lipjanin”, tha ai. Kreu i Gjilanit ka potencuar se Verbica dhe Zhegocin duhet të shpallen zona memoriale të luftës së fundit, në mënyrë që të gjithë fëmijët tanë, që nga shkolla fillore e deri te studentët, t’i vijin këtu dhe ta kalojnë pushimin, ekskursionin dhe aktivitetin e paraparë. Haziri tha se këtu duhet të vendoset edhe kazarma e ushtrisë, t’i kthehet vendi, roli dhe fuqia. “Ushtarët duhet të jenë këtu sepse shënon diçka që për të ardhmen e vultos këtë pjesë si territor të mbrojtur, të zhvilluar dhe zonë e cila do ta ketë kujdesin më të madh nga të gjithë ne”. Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, tha se pajtohet me kryetarin Haziri se kjo zonë është harruar, por që duhet t’i kthehet kujdesi, ndërsa shtoi se harta jonë e lirisë është më e mirë dhe më e bukur nëse jemi të bashkuar dhe në këtë mënyrë edhe dëshmorët do të ndihen më mirë. Fjalë rasti patën edhe deputeti Ahmet Isufi dhe kryetari i Veteranëve të Luftës së UÇK-së në Gjilan, Ahmet Daku, të cilët vlerësuan se familjet e dëshmorëve duhet të jenë krenar për sakrificën e bijëve të tyre. Ky manifestim është përmbyllur me një program të pasur kulturor-artistik, të cilin e ka përgatitur Këshilli i fshatit Zhegoc. Në betejën e Zhegocit u vranë tetë ushtarë të UÇK-së: Pajazit Ahmeti, Alban Ajeti, Hanumshahe Abdullahu, Tefik Zymberi, Sahit Baftiu, Shahin Baftiu, Kastriot Baftiu, Njazi Osmani dhe 18 civilë. Ndërsa në fshatin Sllovi u vranë 49 civilë.

Haziri e informon Kuvendin për punën 100 ditëshe

16 prill 2014

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri ka prezantuar para këshilltarëve komunalë, në një seancë të veçantë të Kuvendit Komunal, informatën e tij për punën 100 ditore, duke nënvizuar se mënyra e tij e qeverisjes bazohet mbi parimin e delegimit të detyrave dhe jo e centralizimit, siç ishte në qeverisjen e kaluar.

Haziri tha se sfida serioze në këtë periudhë kanë qenë borxhet e trashëguara si dhe mbingarkimi me staf, që janë konstatuar edhe nga auditori i pavarur. Kategorisë së parë të punëtorëve të pranuar pa konkurs, iu është ndërprerë marrëdhënia e punës më 24 dhjetor, në bazë të një vendimi që ka lënë ish-kryetari i Mustafa. Kategorisë së dytë të të punësuarve, që kanë qenë staf i angazhuar përmes kompanive private, si shërbime të kontraktuara, marrëdhënia e punës iu është ndërprerë më 31 janar, duke respektuar procedurat ligjore. Kategoria e tretë, ka qenë e punësuar kryesisht në QKMF, përmes një marrëveshje me Karitasin, ku Komuna ka paguar 60 për qind të shumës. “Ne jemi detyruar që t’i ndërpresin të gjitha këto punësime të parregullta, të cilat si



mbingarkesë stafi i kushtojnë 2 milionë euro Komunës së Gjilanit”, ka thënë Haziri.

Kryetari i Komunës ka folur edhe formimin e grupeve punuese për zbardhjen e borxheve, për menaxhimin e thatësisë, pasi gjendja e furnizimit me ujë, ishte

alarmante, pastaj grupit për bujqësi dhe aktivitete të tjera, të cilat janë kryer gjatë kësaj periudhe në të mirë të jetës së qytetarëve. Duke i marrë parasysh borxhin e lartë që është trashëguar nga qeverisja e kaluar, Haziri tha se ky do të jetë një vit i rëndë buxhetor, pavarësisht se të hyrat vetanake të tre mujorit janë të kënaqshme, derisa shpenzimet janë ulur në minimum.

Sa u përket borxheve të qytetarëve ndaj obligimeve komunale, Haziri tha se po shikohen mënyrë për arkëtimin e këtyre mjeteve përmes formave stimuluese. Përndryshe, kryetari i Komunës e ka vlerësuar lajm të mirë për qytetarët e Gjilanit ndarjen e 2.5 milionë eurove për investime kapitale, duke filluar nga infrastruktura rrugore, kanalizimet, ndriçimi publik dhe projektet tjera

që përmirësojnë jetën e qytetarëve. Në vijim të seancës, kryesuesja e Kuvendit Komunal, Valentina Bunjaku-Rexhepi ka ftuar nënkryetarin e Komunës, Rexhep Kadriu, për të folur për angazhimet e tij në këtë periudhë, si dhe drejtorët komunalë Nazim Gagica (DAP), Labinotë Demi-MURtezi (DSHMS), Nazmi Musa (DKA), Salih Kqiku (DBF), Valon Shefkiu (DUMM), Selver Xhelili (DIK), Sokol Haziri (DSHP), Ramiz Ramadani (DBP), Bujar Haziri (DKRS), Sadudin Berisha (DKGJP), Halit Rexhepi (DMSH) dhe Ismajl Januzi (DZHE), të cilët kanë paraqitur sfidat dhe sukseset e këtij 100-ditëshi në sektorët që udhëheqin. Kadriu ka thënë se problem i parë me të cilin është përballur kjo qeverisje, është mungesa e ujit, ku tani rezultatet janë të dukshme në sigurimin e burimeve alternative, po vazhdojmë me Mirushën, janë shpallur tenderët për rrugët Pogragjë – Bilinicë, Lladovë – Nasalë, për rrugët në lagjen “Dheu i Bardhë”, “Dardania”, kurse jemi në përgatitje të projektit për shumë rrugë të tjera, sikurse edhe për rrugët hyrëse Gjilan – Prishtinë dhe Gjilan – Bujanoc që do të jenë me katër krosi. “Gjilani do të jetë kantier ndërtimi”, ka thënë Kadriu. Kurse në emër të shefave të grupeve të këshilltarëve komunalë, vërejtjet dhe vlerësimet e tyre për punën 100-ditëshe të qeverisjes së Hazirit, i kanë paraqitur Sahit Abazi (PDK), Avdyl Aliu (LDK), Selami Xhemajli (AAK) e Nevzad Isufi (VV). Avdyl Aliu tha se punët e kryera për 100 ditë janë të dukshme, kurse të tjerat do të shihen më vonë dhe janë të shumta. Edhe Selami Xhemajli tha se kjo periudhë 100 ditëshe është menaxhuar mirë dhe përmirësimet në ofrimin e shërbimeve janë të dukshme.

Haziri: Jam i nderuar që isha shok i Ibrahim Uruqit në kohë të rënda për Kosovën

21 prill 2014



Është përkujtuar dëshmori i kombit Ibrahim Uruqi në 15 vjetorin e rënies për lirinë e Kosovës. Fillimisht, kryetari i Komunës së Gjilanit Lutfi Haziri me bashkëpunëtorë kanë bërë homazhe te varrezat e dëshmorëve. Më pas është kremtuar dita e shkollës në Bresalc, që e mban emrin e këtij kolosi të kombit. Tubimi përkujtimor është mbajtur pikërisht në sallën

e sportit të shkollës, ku kishte stërvitur Uruqi për të bërë rezistencë ndaj forcave ushtarake e paramilitare serbe. Të pranishëm në tubim ishin edhe kryesuesja e Kuvendit, drejtorët komunal, deputetë e veprimtar të çështjes kombëtare.

Në fjalën e rastit, kryetari i Gjilanit Lutfi Haziri ka thënë se dëshmorit Ibrahim Uruqi ra në altarin e lirisë për ne të gjallët që po jetojmë sot e po kremtojmë lirinë e pavarësinë e Kosovës. Sot mbi të gjitha, është vepra e madhe e Ibrahim Uruqit që na ka bashkuar. Ibrahim dhe të gjithë dëshmorët tanë, sot na bëjnë të ndihemi të vegjël, na bëjnë të ndihemi të obliguar dhe të përgjegjshëm që amaneti i tyre, sakrifica e tyre të çmohet dhe të ecim përpara. "Kjo sallë, ka qenë njëra prej sallave ku Ibrahim ka bërë stërvitjet ushtarake. Jam i nderuar, që unë jam njëri nga shokët që ka ecur në një kohë të vështirë, të gjatë e të rëndë me Ibrahimin", tha Haziri. "Atë që e kam thënë në përvjetorin e parë dhe të gjithë përvjetorët tjerë është se falë Ibrahim Uruqit dhe rezistencës së tij dhe idealit të tij një numër i madh i njerëzve sot janë këtu gjallë dhe jetojnë. Falë asaj sacrifice të madhe të tij dhe luftës së tij, ne sot jemi dëshmitarë të gjallë dhe e kemi këtë ditë të bardhë të lirisë. Gjunjëzohemi para veprës së tij, ju gjenerata e nxënësve jeni krenar që mësoni këtu dhe në librat, fletoret e ditarët tuaj e shkruani emrin e Ibrahim Uruqit", ka thënë Haziri. Haziri premtoi se do ta rregullojmë këtë shkollë në mënyrë që emri i Ibrahimit të jetë gjithmonë i ndritur, çfarë ka qenë gjithmonë ai. Një fjalë rasti patën edhe drejtori i arsimit Nazmi Musa dhe deputeti Ahmet Isufi, të cilët vlerësuan lartë figurën e dëshmorit Ibrahim Uruqi. Kremtja e ditës së shkollës u mbyllë me një program të pasur kulturor-artistik nga nxënësit e shkollës fillore "Ibrahim Uruqi" të fshatit Bresalc.

Kryetarët e komunave të lindjes koordinojnë projektet

23 prill 2014

Kryetari i Komunës së Gjilanit Lutfi Haziri ka qenë nikoqir i takimit të kryetarëve të 11 komunave të regjionit lindje, për koordinimin e projekteve të përbashkëta. Në takimin e përbashkët, të cilin e ka organizuar Komuna e Gjilanit në bashkëpunim me Agjencionin Zhvillimor Rajonal–Lindje, kanë marrë pjesë, pos Gjilanit, edhe Kamenica, Vitia, Ferizaj, Kaçaniku, Novobërda, Hani Elezit, Parteshi, Klllokoti, Ranillugu e Shtërpca si dhe komandanti i KFOR-it për sektorin jug-lindje, Zorlu Topaloglu dhe drejtori i Zyrës Rajonale të OSBE-së, Ulrich Biffar.

Kryetari Haziri, në konferencën për media, ka falënderuar kryetarët e komunave të sipërpërmendura për prezencën, duke thënë se ky është një hap i mirë për koordinim sa më të mirë ndër komunal dhe ndër regjional.



“Ne jemi angazhuar sot për programet e përbashkëta ndër komunale dhe ndër regjionale. Aktiviteti ynë ka të bëjë me koordinim sa më të mirë ndër komunal në mënyrë që konferenca e donatorëve dhe programet tona të mbështeten nga donatorët dhe të përfitojnë qytetarët e tanë”, ka thënë Haziri, njofton Zyra për Informim e Komunës së Gjilanit. Ndërsa, kryetari i Kamenicës, njëherësh kryesues i Bordit të Partnerëve të Agjencionit Zhvillimor Rajonal – Lindje, Begzad Sinani, tha gjatë takimit janë ngritur disa shqetësime nga të pranishmit, bie fjala për lënien anash të rajonit të anamoravës nga investimet qeveritare. “Ne paraqitëm disa aspekte tona, jo vetëm si kryetar të Komunave, por edhe si rajon, pasi që është nxjerrë një konkluzion që është debatuar mjaft në kohën e fundit, ku kanë paraqitur shqetësime të ndryshme jo vetëm të qytetarëve, por edhe të strukturave të ndryshme, pasi që rajoni i anamoravës thuhet se ka mbetur anash”, ka thënë Sinani. Është një përkushtim i yni që si përfaqësues të qytetarëve, të ndajmë shqetësimet tona, që në të ardhmen të jemi të koordinuar jo vetëm me këtë format, por edhe me delegatët e zgjedhur të Kuvendit të Kosovës që të kenë një përkushtim duke arritur standardet, në realizimin e projektet tona të kërkuara, jo nga kryetarët e Komunave, por nga qytetarët e këtioj rajoni, ka thënë Sinani.

Vendimmarrësit komunalë miratojnë raportin tremujor financiar

24 prill 2014



Kuvendi Komunal i Gjiçanit ka mbajtur të enjten mbledhjen e 6-të të radhës për këtë vit, nën kryesimin e Valentina Bunjakut-Rexhepit, ku ka miratuar raportin financiar tre mujor janar-mars 2014 si dhe rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) për anulimin e dy vendimeve të mëhershme, njërit ndalimin e shitjes së pronave publike nga AKP-ja si dhe tjetri për emërimin e Komisionit për

zgjedhjen e Këshillave lokale. Përndryshe Jonuz Hasani u bë anëtar i ri i Kuvendit Komunal, duke e zëvendësuar Selver Xhelilin (LR), i cili është emëruar drejtor i Inspeksionit.

Po ashtu Kuvendi Komunal i Gjiçanit, në këtë seancë, ka miratuar edhe vendimin për emërimin e Komisionit për zgjedhjen e Këshillave lokale, vendimin për ndarjen e bursave dhe shpërblimeve për studentë të dalluar si dhe njëkohësisht edhe vendimi për formimin e Komisionit për ndarjen e bursave, pastaj vendimin për ndarjen e mjeteve financiare në shumë 3.960 euro për Turnirin e boksit “Agim Rashiti” në Gjiçan si dhe vendimin për ndarjen e shumës prej 4.964 euro për konservimin dhe mirëmbajtjen e stadiumit të qytetit.

Në këtë seancë është bërë edhe themelimi i Këshillit të Ekspertëve si dhe është prezantuar një informatë për Manifestimin “Flaka e Janarit”. Raportin financiar tre mujor e ka prezantuar drejtori i Financave, Salih Kqiku, i cili ka thënë se të hyrat vetjake të kësaj periudhe janë realizuar 98 për qind, ndërkaq plani vjetor është 3.780.000, mjete këto që marrin pjesë në buxhetin e përgjithshëm të Komunës prej 20.125.842 euro. Nga kjo shumë, për subvencione janë të planifikuara 558.800 euro, ndërsa për shpenzime kapitale - 3.806.055 euro. Ndërkaq, duke folur për shpenzimet, Kqiku ka thënë se ato janë 4.528.875 euro, por në këtë shumë hyjnë edhe shpenzimet e bartura nga viti 2013, si borxhe, në shumë prej 577 mijë euro. Në përgjithësi, shpenzimet e këtij tre mujori kanë shënuar rënie të dukshme në të gjitha kategoritë, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, ka thënë Kqiku. Opozita (PDK), ka thënë se të hyrat janë më të ulëta se planifikimi, ndërsa shpenzimet nuk të njëjta. Drejtori i Buxhetit Salih Kqiku ka

thënë se opozita duhet ta bëjë analizën e shpenzimeve pa borxhet e trashëguara, për të parë se sa realisht janë shpenzimet kësaj periudhe, por ka qenë kategorik se shpenzimet janë shumë-shumë më të ulëta se ato të tre mujorit të vitit të kaluar, në qeverisjen e PDK-së. Sipas tij, në këtë tre mujor, shpenzime për ushqime dhe pije janë bërë vetëm të “Flaka e Janarit” dhe “Dita e Mësuesit”, ndërsa dreka zyrtare tjera nuk ka pasur. Kuvendi ka anuluar vendimin për ndalimin e shitjes së pronave publike, me arsyetim se kërkesat për pronat shoqërore, të cilat janë të nevojshme për realizimin e interesit publik, bëhen në harmoni me dispozitat e Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme komunale, i datës 22 nëntor 2012 dhe me dispozitat e Rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme komunale, të datës vitit 2013. PDK votoi kundër.

Ndërkaq anulimi i vendimit për Këshillat lokale u bë me arsyetim se Komisioni për zgjedhjen e këtyre këshillave nuk ka arritur të udhëheq dhe të koordinojë punën në zgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në afatin e paraparë dhe as që ka paraqitur raport të punës para Kuvendit të Komunës. Kuvendi miratoi edhe vendimin për ndarjen e bursave, duke e rritur shumën e propozuar nga Drejtoria e Arsimit, prej 30 mijë në 70 mijë, të cilin e paraqiti drejtori Nazmi Musa. Fillimisht ishte paraparë ndarja e 55 bursave për studentë të dalluar të Komunës së Gjilanit, 30 bursa në lartësi prej 60 euro, për studentët e Komunës së Gjilanit, të cilët studiojnë në Universitetet e Kosovës, jashtë Komunës së Gjilanit si dhe 25 bursa të tjera, në lartësi prej 40 euro, për studentët e Komunës së Gjilanit, të cilët studiojnë në Universitetet brenda Komunës së Gjilanit.

Po ashtu, me këtë vendim lejohet ndarja e 10 shpërblimeve, në lartësi prej 200 euro, për studentë të dalluar të Komunës së Gjilanit. Kuvendi ka themeluar edhe Këshillin e Ekspertëve, i cili do të kujdeset për sigurimin e kushteve për planifikim të qëndrueshëm dhe të barabartë hapësinor të territorit të Komunës së Gjilanit, mbështetjes profesionale dhe shkencore të dokumenteve të planifikimit hapësinor dhe dokumenteve tjera.

Këshilli i Ekspertëve përbëhet nga 9 anëtarë, që janë kuadër profesional, shkencor, publik dhe persona tjerë kompetent për planifikim hapësinor. Përbërja e këshillit duhet të reflektojë barazi gjinore dhe mundësi të barabarta. Jehona Hyseni (LDK) kërkoi që në këshill dhe komisione të respektohet përfaqësimi gjinor, gjë që është përkrahur edhe nga kryesuesja Valentina Bunjaku-Rexhepi.

Ndërkaq, një informatë për manifestimin “Flaka e Janarit 2014” e ka paraqitur drejtori i Kulturës, Bujar Haziri, i cili ka thënë se përmes këtij aktiviteti nderohen dëshmorët dhe martirët e kombit, të rënë që nga epoka e lavdishme e Skënderbeut deri në ditët e sotme. Po ashtu Kuvendi miratoi edhe vendimin, sipas kërkesë së DKRS-së për ndarjen e shumës prej 11.281 euro për Teatrin e qytetit, për të paguar obligimet e vitit 2013 ndaj këtij institucioni si dhe ka hapur mundësinë për të bërë zgjidhje të këtij problemi për këtë vit.

Manifestimi “Ditët e Agimit 2014”

3 maj 2014



Në Zhegër të Gjilanit është mbajtur manifestimi tre ditor “Ditët e Agimit 2014”, gjatë të cilave janë zhvilluar aktivitete kulturore, artistike, muzikore e sportive, virtyte këto që i kishte heroit Agim Ramadani. Nënkryetari i Komunës, Rexhep Kadriu, ka thënë se emri i Agimit dhe shokëve të tij janë skalitur në rrënjët e historisë kombëtare, por edhe të shtetësisë dhe lirisë që ne po gëzojmë sot.

Emri i Agimit dhe i shokëve të tij, dhe i të gjithë të rënëve për liri është në themelet e historisë kombëtare. Organizimi i UÇK-së, kushtrimi i Jasharajve, trimëria e Haradinajve dhe dora e këmba e Agimit bëri që ne sot të mos kemi më kufij artificial siç na ishin vënë nga okupatori serb. "Agim Ramadani, ra heroikisht në thyerjen e kufirit, për të mos vdekur kurrë. Gjithnjë kur flitet për Kosharen kryefjala e kësaj historie është vetëm emri i Agim Ramadanit. Duke nderuar jetën, kontributin dhe sakrificën e heroit Agim Ramadani, nderohen të gjithë dëshmorët që me luftën e tyre e bëjnë të pavdekshme Betejën e Koshares", ka thënë ndër të tjera Kadriu. Ndërsa në emër të familjes, bashkëshortja e Agimit, Shukrie Ramadani, ka falënderuar të pranishmit për prezencën, ka kujtuar disa fjalë të Agimit e ndër to edhe atë "Nuk ka më mirë se të vdiset për lirinë e vendit tënd", kështu thoshte Agimi, tha ajo, duke shtuar se organizimet për shënimin e "Ditëve të Agimit 2014", por edhe për gjithë dëshmorët tjerë të rënë kah do në hapësirën shqiptare janë krenaria e të gjithë ne të gjallëve. Ish-bashkëluftëtari i Agimit, Rustem Berisha, tha se emri dhe ideali, por edhe vepra e komandantit asnjëherë nuk mund të përmblihet me fjalë dhe as nuk mund të shkruhet. "Ai ishte një njeri që sado që të flasim, shkruajmë asnjëherë, nuk do të mund ta themi të tërën. Vepra e tij përherë për ne do të mbetet e shenjtë dhe një rrugë për të ecur përpara ballëhapur", tha ai. Dita e parë të këtij manifestimi u karakterizua me turnirin në futboll të vogël të mbajtur në fshatin Zhegër "Edhe me sport e kujtojmë Agimin" me pjesëmarrje të 24 ekipeve nga të gjitha trojet shqiptare si dhe flakadanët në përkujtim të 114 dëshmorëve të Betejës së Koshares. Në ditën e dytë është mbajtur aktiviteti sportiv në hendboll dhe ora e madhe letrare "Muza e Agimit", ndërsa sot dita e tretë ka nisur me homazhe para lapidarit të Agim Ramadanit, për të vazhduar me programin e shkollës "Agim Ramadani" në fshatin Zhegër në ora 12:00, ndërsa në ora 16:00 ka kulmuar me këtë tubim qendror "I këndojmë Agimit", ku kanë marrë pjesë përfaqësues nga të gjitha nivelet e qeverisjes, përfaqësues fetarë, artistë dhe qytetarë

të shumtë. Ndërkohë juria e Orës së Madhe Letrare, në përbërje: Shefik Shkodra, Shukrije Ramadani e Bilall Maliqi, shpalli fitues të çmimit "Muza e Agimit" poetët Sarë Gjergji dhe Bujar Salihu. "Muza e Agimit" është aktivitet i manifestimit "Ditët e Agimit" që mbahet nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës, Lutfi Haziri.

Zija Shemsu - themel i lirisë dhe simbol i bashkimit të të gjithëve

5 maj 2014



*Në nderim të dëshmorit
Zija Shemsu është
mbajtur Akademi
përkujtimore, me ç'rast
kryetari i Komunës,
Lutfi Haziri, ka thënë se
Zija Shemsu do të
mbetet përherë një njeri
i madh dhe me një rol të
veçantë për lirinë e
vendit.*

“Zija Shemsu është një njeri i madh, familja Shemsu po ashtu është me vlera shumë të mëdha për Gjilanin dhe Anamoravën, në rolin e tyre për lirinë e vendit. Në këtë moment kujtojmë arrestimin e Zija Shemsut e Sami Kurtshit dhe familjes Shemsu, hapjes barbare të varrezave, porse rruga dhe ideali i tij na bëjnë krenarë dhe i kujtojmë me pietet të lartë dhe me nderime të veçanta këtë kolos të madh të lirisë. Ai ra më 5 maj, por Përlepnica, Gjilani dhe Anamorava u vendosën në historinë e lirisë së Kosovës. Ne do të gjunjëzohemi përherë para veprës së dëshmorëve”, ka thënë Haziri. Ndërsa nënkryetari i Komunës së Gjilanit, Rexhep Kadriu, ka thënë se Gjilani dhe Anamorava, në çdo periudhë të historisë kanë dhënë kontributin dhe sakrificën e tyre në përpjekje për ndërrimin e regjimit dhe lirinë e vendit. I tillë ishte edhe Zija Shemsu. “Zija Shemsu i takon periudhës së artë të organizimit të grupeve ilegale për liri dhe pavarësi, që nga protestat e ‘68-shit e deri te ato të ‘81-shit. Ishte njëri nga organizatorët e protestave në Kosovë dhe Europë.

Ai me shokë ishte mobilizuar që kudo të shpërndajë frymën e atdhetarizmit për t’iu bashkuar protestave e demonstratave paqësore, sepse kjo ishte e vetmja rrugë e arritjes së synimeve. Ai u

flijua për atdhe por nuk u dorëzua dhe nuk u gjuhëzua para torturave të mëdha që iu bënë nga forcat serbe. Bashkë me kryetarin Haziri kemi marrë vendim që njëra nga shkollat e qytetit të Gjilanit të bartë emrin e Zija Shemsiut.

Në vitin e ardhshëm, Komuna e Gjilanit, do ta bëjë renovimin e shtëpisë së Zijahit dhe ajo do të shndërrohet në muze”, ka thënë ai. Deputeti i Kuvendit të Kosovës, Ahmet Isufi, me këtë rast ka thënë se ndjehet krenar që kishin një bashkëveprimtar i cili ka rënë dëshmorë për të mos u harruar kurrë. “Zijahi ishte i vendosur që të sjell armatim në Kosovë, për t’i kthyer pushkën armikut. Ai ishte përkrah Rexhep Malës, Nuhi Berishës, të frymëzuar nga ideali i Kadri Zekës e të tjerëve dhe këta janë themeli i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe i lirisë së vendit. Ndërsa në emër të familjes, Shaban Shemsiu, ka thënë se organizimi i këtij aktiviteti nga institucionet lokale ka ngjallur interesimin e familjeve të dëshmorëve nga gjithë Kosova, Mali i Zi, Maqedonia, Lugina e Preshevës dhe nga diaspora, ndërsa neve familjes na keni bërë krenarë me veprimin tuaj në kujtim dhe nderim të dëshmorit. “Dëshmorët janë të gjithëve”, ka thënë ai.

Haziri ia dërgon në shtëpi certifikatën aplikuesit të parë online

7 maj 2014

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ia ka dërguar në shtëpi certifikatën e parë një qytetarit Eugen Iseni, i cili ka aplikuar përmes sistemit "online".



“Ndryshimet për të cilat kemi folur më parë tashmë kanë nisur të shihen edhe në praktikë. Ne jemi në shërbim të qytetarëve dhe tashmë kemi filluar me programin e ofrimit të shërbimeve online. Me këtë projekt do të eliminohen radhët e gjata dhe do të ofrohen më shumë mundësi për shërbime në të njëjtën kohë”, ka thënë Haziri. Ky projekt po realizohet në bashkëpunim me postën dhe shërbimi qytetarit i dërgohet brenda 24 orëve. Edhe për bashkatdhetarët tanë kjo është

një mundësi shumë e mirë, sepse ata mund të aplikojnë derisa janë jashtë dhe kur të vijnë këtu e kanë të gatshme atë që kanë kërkuar. "Do të pretendojmë që radhët e qytetarëve dhe pritjet para sporteleve të vijnë në pikën zero, sepse pretendojmë që shërbimet t'i ofrojmë në shtëpi", ka thënë kryetari Haziri. Ai po ashtu ka publikuar edhe projektin e dytë që do të implementohet e që ka të bëjë përsëri me dhënien e shërbimeve, por me një dimension edhe më të gjerë. "Po e publikoj këtu edhe projektin e dytë të dhënies së shërbimeve përmes programit të dytë "One Stop Shop", ku të gjitha dokumentet e Gjendjes Civile mund të merren në një vend. Gjithashtu do të trajtohet dhe riorganizohet ai objekt tek Administrata e Përgjithshme", ka përfunduar Haziri, duke shtuar se programet online gjithmonë dhe në çdo vend kanë pasur sukses dhe sigurisht që edhe në Gjilani kështu do të ndodh. Ndërsa Nazim Gagica, drejtor i Administratës së Përgjithshme, ka thënë se ky projekt është realizuar falë insistimit të kryetarit Haziri. Kurse Eugen Iseni, të cilit iu dorëzua zyrtarisht certifikata nga kryetari Haziri, është shprehur i lumtur për këtë mundësi të ofruar, duke thënë se kjo është punë e madhe e bërë nga ana e Komunës së Gjilanit.

Haziri: Bashkësitë fetare janë pjesë e zhvillimeve pozitive

7 maj 2014

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri ka marrë pjesë në një takim të organizuar nga OSBE me bashkësitë fetare të regjionit të Gjilanit, ku temë e debatit ishte dialogu ndërfeetar në Kosovë, ndërsa janë paraqitur të arriturat dhe sfidat që janë identifikuar gjatë funksionimit. Me këtë rast, kryetari i Komunës, Lutfi Haziri, ka thënë se bashkësitë fetare në këtë regjion janë pjesë e zhvillimeve pozitive.

"Për të gjitha zhvillimet që kanë ndodhur në qeverisjen tonë lokale dhe në jetën në përgjithësi, një kontribut të çmueshëm kanë dhënë edhe bashkësitë fetare, në këtë rrugë të cilën e pretendojmë të gjithë. Një bashkëpunim i juaji me institucionet, por edhe i juaji mes vete ndikon që të kemi progres ndërmjet besimtarëve. Ju si bashkësi fetare keni nevojë të mbështetjes ligjore. Mbështetja nënkupton jo vetëm kompetencën tuaj por buxhet vjetor dhe mjete të tjera karshi institucioneve të vendit, duke mos e cenuar asnjëherë pavarësinë e ushtrimit të aktivitetit – misionit tuaj fetar që e keni në Kosovë. Sa i përket nivelit lokal, përherë do të jem afër jush dhe kërkesave tuaja. Në rrafshin e parë dialogu fetar intensiv, që Komunën tonë ta bëjmë vend të bashkëpunimit të mirë ndërfeetar dhe pajtim ndëretnik, ndërsa e dyta është aspekti i vazhdimit të thellimit të mirëkuptimit mes vete", ka thënë kryetari Haziri. Ndërsa Naim Aliu nga Bashkësia Islame, Dominik Qerimi nga "Don Bosko" dhe Naim Bllaca nga Kisha Protestante, kanë konfirmuar bashkëpunim mes vete, duke e paraqitur si një sfidë për Gjilanin punën e Varrezave të Qytetit, ku hapësira tashmë është shumë e limituar. Për këtë kanë marrë mbështetjen e kryetarit lidhur me atë se Komuna është duke punuar në këtë drejtim për gjetjen e një vendi adekuat për varrezat e reja dhe konservimin – ruajtjen e varrezave të tashme të qytetit. Ndryshe

me iniciativën e kryetarit është ftuar një takim i përbashkët në zyrën e kryetarit javën e ardhshme me bashkësitë fetare të katër religjioneve nga ky regjion. Pas debatit do të vizitohet Bashkësia Islame në Gjilan dhe Qendra “Don Bosko”.

Hapet ekspozita e nxënësve të artit pamor në Zyrën e Hazirit



Gjilan, 9 maj 2014 - Është hapur sot në Zyrën e kryetarit të Komunës ekspozita e nxënësve të shkollës së mesme të artit pamor në Gjilan që korrespondon me “Ditën e Europës” me mesazhin “Të kultivojmë vlerat europiane si parakusht në që në një kohë të afërme të jemi edhe ne pjesë e kësaj familje”.

Në shënimin e kësaj ngjarje ka marrë pjesë kryetari Lutfi Haziri, nënkryetari Kadriu si dhe

përfaqësues së bashku me nxënës të kësaj shkolle.

Me këtë rast, kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, u ka thënë nxënësve që sot e kanë bërë Gjilanin krenarë me këtë ekspozitë, ndërsa tha se edhe Komisioni European në Kosovë e ka shënuar këtë ditë të hapjes së kësaj ekspozite në Gjilan.

“Kjo ditë e shënuar e Europës së Schumanit Gjilanin e bënë të vacantë sot për shkak të hapjes së kësaj ekspozite. Sot e keni madhështuar zyrën e kryetarit sepse shënimi i kësaj dite si aspiratë e popullit tonë, në veçanti e të rinjve, nxënësve dhe ju artistëve të rinjë, nesër do të na bëni krenar jo vetëm në Kosovë, por edhe në Europë kudo që shkoni me punimet tuaja, na obligon që ne të kujdesemi për ju, për edukimin e mirëfilltë, për avancimin e këtyre vlerave, në mënyrë që vërtet t’i mbërrijmë, jo vetëm sot të jemi aspirant për të qenë pjesë e Europës, por ashtu siç e ka parë Schumani, që të gjithë europianët të jetojnë në një familje, në një shtëpi, pa probleme, me një tolerancë, multietnicitet e diversitet kulturor dhe etnik”, tha kryetari Haziri.

“Ari i Gjilanit është arti pamor, ndërsa përkrahja e juaj zotëri kryetar është ari për Gjilanin”

Sipas Hazirit, 9 maji tash e tutje do të shënohet në mënyrë tradicionale nga nxënësit e shkollës së artit, në mënyrë të veçantë, për të shtuar se do të punohet që të hapet edhe ekspozita në Galerinë e qytetit, që Komuna do ta sponsorizoj plotësisht.

Në emër të shkollës së artit pamorë ka folur profesor Zejnullah Zejnullahu, i cili e ka falënderuar kryetarin e Komunës z. Haziri, duke thënë se u ka bërë nderë profesorëve dhe nxënësve që ua ka dhënë këtë mundësi për promovimin e veprave të tyre.

Ekspozita përbëhet nga 60 punime, që përfshihen piktura, punime të dizajnit grafik dhe një skulpturë.

Në kuadër të punimeve të nxënësve është edhe portreti i kryetarit Haziri, që e ka bërë nxënësi i kësaj shkolle Sabri Shaqiri.

Në këtë ngjarje u tha nga të pranishmit se “ari i Gjilanit është arti pamor, ndërsa përkrahja e juaj zotëri kryetar është ari për Gjilanin”.

Kjo ekspozitë do të qëndroj e hapur për një muaj. Kryetari Haziri ka vendosur që në zyrën e tij të promovoj veprat e artistëve, nxënësve e studentëve për çdo muaj, ndërsa për një muaj rresht ka qëndruar e hapur ekspozita e profesoreshës Magbule Xhemali.

Haziri mban ligjëratë para studentëve të Universitetit "Kadri Zeka"

15 maj 2014



Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri ka mbajtur sot një ligjëratë para studentëve të Universitetit "Kadri Zeka", në kuadër të programit "Guest Speaker", të cilin e ka moderuar profesori Flamur Hyseni. Kryetari Haziri, ndër të tjera ka folur për karrierën e tij politike, që daton nga vitit 1990 si student i Universitetit të Prishtinës, e deri në ditët e sotme.

Gjatë karrierës 24 vjeçare, Haziri tha se ka marrë pjesë në të gjitha proceset politike të Kosovës, duke e përshkruar me shumë sfida e suksese dhe në të njëjtën kohë ndihet krenarë për gjithçka që i ka dhënë Kosovës. Ai tha se karrierën e tij e karakterizojnë 3 faza të rëndësishme. E para, ka të bëjë me rezistencën aktive politike kundër Serbisë për liri dhe demokraci të Kosovës. E dyta, për

procesin e pasluftës, që ka të bëjë me shtet-ndërtimin dhe e treta për angazhimet e mëdha në periudhën post-pavarësi, pra nga viti 2008 e këndej.

Gjatë rezistencës aktive kundër Serbisë për liri dhe demokraci, ka qenë periudha më e rëndë e z. Haziri, ku është spikatur përgatitjen e tij në kampet në Shqipëri për t'iu kundërvënë me luftë, derisa periudha më e rëndë ka qenë ajo kur në nëntor të vitit 1998, u arrestua dhe u burgos nën akuzat e udhëheqjes së strukturave të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Zonën e Karadakut të Gjilanit. Për fazën e dytë, theksoi se ka qenë po ashtu e vështirë, me shumë sfida, probleme, e debate të brendshme e të jashtme lidhur me shtet-ndërtimin, që përfshinë standardet para statusit, periudhën e rëndë të negociatave të Vjenës e deri te përgatitja për shpalljen e pavarësisë.



Ndërsa për fazën e tretë, ka folur për mbikëqyrjen ndërkombëtare pas shpalljes së pavarësisë, për misionin e EULEX-it, të cilit i janë dhënë kompetenca ekzekutive, e deri tek rrugëtimi drejt rizgjedhjes kryetar i Gjilanit në mënyrë plebishitare, me mbi 26 mijë vota. Pas ligjërates, pasuan pyetjet dhe interesimet e shumta të studentëve, të cilave i është përgjigjur kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri.

Sigurohen investimet për parkun në lagjen “Dardania”

19 maj 2014

Qytetarët e lagjes “Dardania” kanë arsye të gëzohen, ngase në pjesën ku aktualisht shiten dru për ngrohje, do të ndërtohet një park modern. Ky projekt kap vlerën mbi 240 mijë euro dhe Komuna e Gjilanit e ka fituar në kuadër të programit “Kosova e Bukur”, që financohet nga Komisioni European. Komuna participon me 10 për qind në këtë projekt.



Lajmin e ka bërë të ditur, në një konferencë për media, kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, i cili shoqërohej nga nënkryetari Rexhep Kadriu dhe kryesuesja e Kuvendit Komunal, Valentina Bunjaku-Rexhepi. “Përveç punimeve që jemi në fazën e përfundimit, nënshkrimit të kontratave me operatorë, për asfaltimin e rrugëve në qytet dhe në vendbanimet më të mëdha, ne kemi marrë konfirmimin nga Komisioni Europian për projektin në lagjen “Dardania 1”.

Shitblerja e druve që bëhet aktualisht në atë pjesë, do të kthehet në park me interes të qytetarëve në atë lagje dhe përreth, që përfshin rregullimin e infrastrukturës, gjelbërimin e zonave dhe rregullimin e traseve dhe të çerdhes për fëmijë të lagjes”, ka thënë Haziri.

Ky projekt jashtëzakonisht i madh që është fituar në kuadër të programit “Kosova e Bukur” që e financon Komisioni Europian dhe ku Komuna e Gjilanit merr pjesë me 10 për qind, ka thënë Haziri.

Ndërsa, nënkryetari Kadriu e ka shpjeguar në detaje mënyrën e realizimit të këtij projekti, duke thënë se destinimi i mëhershëm i asaj pjese për ndërtimin e një qendre tregtare, është zëvendësuar me një park modern për qytetarët. Ai tha se projekti do të fillojë të realizohet brenda dy muajve.

Në kuadër të këtij projekti do të marrin pjesë në punë edhe personat me nevoja të veçanta, që përfshin shoqatat "Handikos", të verbrit dhe shurdhmemecët, cilët do të kompensohen nga Komisioni Europian. Kryetari Haziri përmendi edhe projekte të tjera që janë të konfirmuara dhe që pritet të realizohen në vazhdim, ndërsa një pjesë e tyre janë në pritje të konfirmimit.

Këto projekte kanë të bëjnë me bashkëpunimin ndërkufitar Kosovë-Maqedoni, në bashkëpunim me komunën e Çairit për artizanatet; projektet për zhvillim ekonomik lokal dhe të bujqësisë të financuara nga “CARE”, IADK dhe EURED; finalizimi i kabinetit të informatikës financiar nga IOM; projekti në bashkëpunim me MAPL që përfshin ndërtimin e trotuarit në rrugën “Mulla Idrizi” deri në lagjen Zebeli i Sahit Agës; projekti i Trashëgimisë Kulturore Pa kufij për ndërtimin e urës në fshatin Pogragjë. Projekte të tjera që do të realizohen janë edhe ndërtimi i trotuarit në lagjen “Arbëria” deri te shkolla “Mulla Idriz Gjilani” në fshatin Velekincë, rregullimi i trotuarit në fshatin Zhegër, pastaj do të ketë investime nga qeveria zvicerane për ndërtim të ujësjellësit dhe kanalizimeve në fshatra.

Projektet e konfirmuara nga donatorët kapin shifrën e mbi 600 mijë eurove, ndërsa të gjitha këto projekte do të realizohen edhe në bashkëfinancim shtesë nga Komuna e Gjilanit. Kreu i Gjilanit tha se në ditët në vazhdim do të nis implementimi i këtyre projekteve në terren.

Bunjaku-Rexhepi: Gjilani, qendër e demokracisë

22 maj 2014

Kuvendi Komunal i Gjilanit, që nga dita e parë e kësaj nomenklature ka funksionuar shumë mirë. Thënë të drejtën në punën tonë është vërejtur një dozë e kënaqshme demokracie, ku e drejta e diskutimit nuk është cenuar asnjëherë. Kemi bërë konsolidim të shpejtë dhe kualitativ të të gjitha trupave të Kuvendit, duke përfshirë edhe zgjedhjen time në pozitën e Kryesueses dhe falë besimit të pjesës dërmuese të asamblistëve unë jam sot aty, thotë Valentina Rexhepi-Bunjaku, kryesuee e Kuvendit Komunal.

Unë do të jem këtu që të respektoj parimin e barazisë në mes të këshilltarëve, duke mos dalluar pozicionin pozitë-opozitë, me qëllim që Kuvendi i Komunës të jetë vend ku dëgjohej zëri i qytetarëve dhe punohet me sinqeritetin më të lartë në zgjidhjen e problemeve të tyre.

Në këta muaj qeverisje ne, thotë ajo, kemi demonstruar gatishmërinë e bashkëpunimit edhe me opozitën, që është e përfaqësuar në çdo trupë të Kuvendit, por edhe iu kemi dhënë mundësinë e diskutimeve edhe përtej masës që lejon rregullorja e punës së Kuvendit.

Me punën tonë çdo ditë e më tepër jemi duke i dhënë rëndësi institucionit me të lartë legjislativ të Komunës sonë.

Ne sot kemi bashkëpunim të shkëlqyer me të gjitha institucionet qendrore dhe ato ndërkombëtare, si dhe me shumë suksese jemi duke ecur në realizimin e shumë projekteve të përbashkëta.

Me një fjalë, Kuvendi i Komunës është duke reflektuar zërin e vërtetë të qytetarit të Gjilanit.

Kështu që ne si legjislativ lokal, misionin për të cilin na kanë besuar qytetarët do e realizojmë me çdo kusht dhe puna jonë do të kurorëzohet suksesshëm në bashkëpunim të shkëlqyer me Kryetarin e Komunës, Lutfi Haziri, i cili është duke bërë të pamundurën që edhe kjo pjesë e harruar e Anamoravës t'i gëzohet të mirave që meriton, thotë Valentina Bunjaku-Rexhepi, kryesuese e Kuvendit Komunal.

Drejtoria e Bujqësisë subvencionon fermerët me 250 shtëpiza bletësh

26 maj 2014

Drejtoria e Bujqësisë në Gjilan ka shpërndarë sot 250 shtëpiza bletësh trekatëshe, ku përfitues kanë qenë 104 bletarë. Me këtë rast, drejtori Bujqësisë Ramiz Ramadani, tha se ky është një



subvencion simbolik, por do t'i ndihmojë fermerët për ta zhvilluar këtë veprimtari, duke theksuar se në të ardhmen subvencionet e kësaj natyre do të jetë shumëfish më të mëdha.

“Kjo është një ndihmë simbolike, mirëpo kemi vlerësuar se pjesa e cila mbetet e pa mbuluar nga Ministria e Bujqësisë, të trajtohet nga Drejtoria e

Bujqësisë, pra ata që i kanë 1 deri 29 shoqëri bletësh i kemi trajtuar. Vlera e këtij projekti është 9600 euro, kjo është mundësia jonë kësaj radhe, duke shpresuar që lerave të tjera të jetë shumëfish më i madh”, tha Ramadani.

Ai tha se po bëhet përpjekje që mos ta shohim këtë veprimtari thjeshtë si një përfitim familjar, por t'i japim karakterin e biznesit, për t'u marrë me këtë punë edhe të rinjtë, gratë, e të moshuarit.

Para se t'u shpërndahen shtëpizat e bletëve, është mbajtur edhe një seancë trajnuese për fermerët nga ekspertët e Drejtorisë së Bujqësisë, për t'i dhënë atyre njohuri shtesë për të pasur sukses më të madh në veprimtari.

Vlerësohet se Gjilani ka resurse shumë të mira natyrore për t'u marrë me mbarështimin e bletëve, ka kullosa të begatshme me florë të pasur me shumëllojshmëri që paraqet një potencial të mirë ushqyes.

Komuna numëron 155 bletarë me 3074 shoqëri dhe me këto kapacitete nevojat e konsumatorëve plotësohen vetëm 20 për qind.

Kuvendi i Gjilanit përkrah themelimin e Komitetit dhe Zyrës për Preshevë, Medvegjë e Bujanoc

27 maj 2014

Kuvendi Komunal i Gjilanit, të martën, në seancën e radhës, të udhëhequr nga Valentina Bunjaku-Rexhepi, kryesuese, ka shqyrtuar dhe miratuar Rregulloren për përgjegjësitë disiplinore dhe materiale të punonjësve të arsimit, Planin e veprimit për transparencë, vendimet për qasje në tri plane rregulluese të qytetit, themelimin e Komitetit dhe Zyrës për të drejtat e shqiptarëve të Luginës së Preshevës si dhe çështje të tjera.

Vendimi për themelimin e Komitetit si dhe Zyrës për të drejtat e shqiptarëve në Preshevë, Medvegjë e Bujanoc, është përkrahur nga të gjitha grupimet politike. Sejdulla Kadriu (Vatra), ka thënë se ky është ndër vendimet më të rëndësishme që ka marrë Kuvendi Komunal i Gjilanit në këta 6 muaj. Kuvendi ka miratuar edhe rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, si kërkesë e Drejtorisë së Administratës, për mbulimin e shpenzimeve të shërbimit të pilot-projektit “Shtëpi-Komuna” për një periudhë 6-mujore. Valentina Bunjaku-Rexhepi tha se në Komitetin për Politikë dhe Financa jemi dakorduar që të rekomandojmë për Kuvend Komunal kërkesën e Drejtorisë së Administratës, për nxjerrjen e një vendimi për heqjen e shpenzimeve të postës për projektin “Home-Shtëpia”, që qytetarëve u ofron mundësi aplikimi “online” për dokumente të gjendjes civile si dhe marrjen e shërbimit në shtëpi, përmes postës. Edhe ky rekomandim ka marrë përkrahjen e të gjitha grupeve politike në Kuvend Komunal, duke marrë parasysh se Gjilani është komuna e parë që ka filluar me projektin “Home –Shtëpia”. Nazim Gagica, drejtor i Administratës, ka thënë se për të mbuluar këtë shërbim për periudhën 6 mujore, nevojiten përafërsisht 2 mijë euro. Sipas tij, deri tani në adresën elektronike të Drejtorisë së Administratës kanë arritur 412 kërkesa dhe 314 prej tyre i kanë marrë tashmë dokumentet e kërkuara, ndërsa 68 të tjera janë në proces. Sa i përket Rregullores për përgjegjësitë më arsim, ku këshilltarët paraqitën disa vërejtje rreth formulimeve e sidomos kërkuar që të ndalohen kurset me nxënës të së njëjtës shkollë ku punojnë mësime të ndryshme, sqarime kanë dhënë drejtori i Arsimit Nazmi Musa si dhe përfaqësuesi i kësaj Drejtorie, Bardhyl Sylja, të cilët thanë se projekt-rregullorja është hartuar nga komisioni i ekspertëve, i është nënshtruar dëgjimit publik si dhe diskutimit në grupe më të ngushta të mësime të ndryshme. Kuvendi miratoi edhe Planin e veprimit për përmbushjen e transparencës, të cilin e paraqiti Sadri Arifi, shef i Shërbimit të Kuvendit, ndërsa këshilltarët komunalë kërkuar që ai të zbatohet në praktikë, sepse rrit besueshmërinë e publikut ndaj institucioneve komunale. Kuvendarët miratuan edhe propozimet për nevojën e qasjes në planet rregulluese “Qendra”, “Qarku” dhe “Fidanishtja”, të cilat i prezantoi dhe arsyetoi drejtori i Urbanizimit, Valon Shefkiu. Shefkiu tha se plani për lagjen “Qendra” përfshin një sipërfaqe prej 72 hektarësh, plani i zonës “Qarku” kap një hapësirë prej 139 ha, kurse zona “Fidanishte” shtrihet në 107 hektarë. Ai ka thënë se mbeten edhe 300 hektarë zonë urbanen për t’u mbuluar me plane rregulluese në vitin tjetër. Duke u përgjigjur në disa pyetje të këshilltarëve, Shefkiu sqaroi se të “Fidanishtja” bëhet fjalë për një zonë të re, që nuk ka qenë e përfshirë në plane detaje

deri tani, ndërsa sa i përket lagjes “Zabeli”, ai tha se atje është duke vazhduar planifikimi që ka filluar më herët. Kuvendi Komunal është plotësuar me anëtarin Rina Ahmeti (LDK), e cila erdhi si zëvendësim në vend të Florina Zymberi, që është tërhequr për shkak të konfliktit të interesit me vendin tjetër të punës.

Nis ndërtimi i rrugëve

30 maj 2014

Kanë nisur punimet për asfaltimin e rrugës Lladovë-Nasalë, me gjatësi prej 2 kilometrash. Ky projekt pritet të realizohet shumë shpejt, dhe do të jetë një lehtësim i madh i banorëve të kësaj ane. Edhe në fshatin Përlepnice, ka nisur rregullimi i tri rrugëve të vjetra. Asfaltimi i rrugës ka nisur edhe në fshatin Bilincë, ku jetojnë rreth 60 familje. Kurse në lagje Dheu i Bardhë ka filluar asfaltimi i katër rrugëve. ”Jemi duke punuar me intensitet të lartë në asfaltim të



rrugëve, kanalizime, ujësjellës, ndriçim publik dhe trotuare. Qëllimi ynë është që infrastrukturën bazike t’ua afrojmë të gjithë qytetarëve”, ka thënë Rexhep Kadriu, nënkryetar i Komunës. Këtë vit në lagjen Dheu i Bardhë do të përfundohen të gjitha rrugët, por në të njëjtën kohë do të vazhdojmë edhe në lagjet tjera dhe fshatrat e Komunës së Gjilanit. Vetëm këtë vit do të investohen mbi 2.5 milionë euro në infrastrukturën rrugore. ”Është shumë keq që edhe pas 15 viteve flitet në Gjilan për infrastrukturë rrugore. Është keq që edhe pas 15 vjetëve, qytetin e kemi në këtë gjendje”, ka thënë ai.

Haziri: Po e heqim lloçin dhe vadat

5 qershor 2014

Qeveria komunale e Gjilanit, e udhëhequr nga kryetari Lutfi Haziri po vazhdon me suksese të mëdha në përmbushjen e obligimeve që ka ndaj qytetarëve të saj. Pas nisjes së asfaltimit të rrugës Lladovë-Nasalë, tri rrugëve në Përlepnice, rrugës Pogragjë-Bilinicë, rrugës në lagjen “Dheu i Bardhë” dhe 11 rrugicave të tjera, sot po përfundohet me sukses edhe asfaltimit i rrugës “Halim Orana”, ndërsa është në përfundim e sipër rregullimi i rrugës në varrezat e qytetit.

Kryetari Lutfi Haziri, i shoqëruar nga nënkryetari Rexhep Kadriu, drejtorët komunal dhe shefi i këshilltarëve të LDK-së, Avdyl Aliu, i ka inspektuar sot punimet në varrezat e qytetit dhe asfaltimin e rrugës “Halim Orana”, duke vlerësuar se nuk po bëhet asgjë më shumë, pos po i realizon premtimet e katërshe të madhe të prioritetëve, në rregullimin e rrugëve, trotuareve,



kanalizimit, ujit dhe ndriçimit publik. “Të gjitha këto projekte po i realizojmë në një kohë shumë të shkurtër të qeverisjes pesë muajsh, të cilat po ndërtohen në mënyrën më të mirë. Jam zotuar se në mandatin tim do ta heq lloçin dhe vadat dhe kjo po ndodhë sepse ua kemi për obligim qytetarëve tanë t’u sigurojmë jetë të

dinjitetshme”, ka thënë kryetari Haziri. Nga mjetet e zotuar nga Ministria e Infrastrukturës për dy projektet për asfaltimin e rrugëve Lladovë-Nasalë dhe Pogragjë-Bilinicë janë mbi 202 mijë euro, ndërsa Komuna për këto dy rrugë ka participuar në vlerë prej mbi 140 mijë eurosh. Nga projektet në rrugët e qytetit, “Dheu i Bardhë”, “Dardania” dhe në rrugën “Ali Hadri”, nga Ministria e Infrastrukturës janë zotuar mbi 374 mijë euro, ndërsa Komuna ka participuar në shumën prej mbi 70 mijë eurosh. Mbeten edhe mbi 375 mijë euro mjete, të cilat planifikohen për asfaltimin e rrugëve të qytetit të cilat janë në fazën e tenderimit dhe atë: rrugët e Zabelit të Sahit Agës dhe një pjesë e rrugëve në lagjen e VIII. Në vazhdimësi të kësaj, po vazhdon edhe projekti për rregullimin e rrugëve brenda varrezave të qytetit. Po ashtu, do të nis ndërtimi i trotuarit nga shkolla fillore “Abaz Ajeti” deri në fshatin Velekincë. Për terrenin sportiv në fshatin Livoq i Epërm, janë zotuar mjete në shumë prej mbi 15 mijë eurosh, ndërsa për rregullimin e terreneve

sportive në pesë fshatra të Komunës së Gjilanit në shumë prej mbi 114 mijë eurosh.

Komuna ka filluar punët në realizimin e projekteve nga vitet paraprake dhe atë: rregullimi infrastrukturës në fshatin Shillovë, asfaltimi i rrugës “Halim Orana”, asfaltimi i rrugës “Vëllezërit Hyseni”, asfaltimi i rrugëve në lagjen Zabeli i Sahit Agës, asfaltimi i rrugicave në fshatin Përlepnicë, rregullimi i kanalizimit atmosferik në lagjen “Arbëria”, rregullimi i kanalizimit atmosferik në lagjen “Baja”.Përveç projekteve të mëdha që janë realizuar në qeverisjen Haziri, janë paguar edhe mbi 1.5 milionë borxhe trashëguara nga ish-qeverisja. Për paga dhe mëditje janë paguar mbi 23 mijë euro, për mallra dhe shërbime mbi 635 mijë euro, për shpenzime komunale mbi 80 mijë euro, për subvencione mbi 27 mijë euro, ndërsa për shpenzime kapitale janë paguar mbi 822 mijë euro.

Haziri e hapi fushatën e korrje-shirjeve në Komunën e Gjilanit

9 qershor 2014



Është hapur sot zyrtarisht fushata e korrje-shirjeve në Komunën e Gjilanit. Hapjen zyrtare e bëri kryetari Lutfi Haziri, i cili tha se ky vit beson të jetë i bereqetshëm dhe përcaktues për sofrën e qytetarëve.

“Sot dëshiroj t’i uroj të gjithë bujqit e Gjilanit për fillimin e fushatës së korrje-shirjeve dhe besoj

shumë që bereqeti që e ka falë Zoti, ky vit i bereqetshëm do të jetë determinues për sofrën dhe bollëkun që e kemi në sofër.

Komuna do të ndërtoj politika të reja të subvencionimit. Fatkeqësisht, ne kemi trashëguar një buxhet jo të specifikuar drejt për këtë vit, por do të ndërtojmë një plan të ri mbi subvencionimin e prodhimit dhe punimit të tokës në vecanti dhe prodhimeve bujqësore, duke i favoriuar të gjithë ata që duan të punojnë”, tha kryetari Haziri.

“Vlerësimi ynë i parë është që toka në Gjilan po punohet në mënyrë masive, jemi nga Komunat e rralla që nuk kemi tokë të papunueshme, sidomos sektori privat është jashtëzakonisht i fuqishëm, por kanë nevojë të subvencionohen në farë, naftë, korrje-shirje dhe në këtë mënyrë do të stimulohet familja që merret me bujësi, për të mos pasur shpenzime”, shtoi Haziri.

Drejtori i Bujqësisë Ramiz Ramadani është shprehur se sivjet pritet të ketë rendimente rekorde të grurit.

“Komisioni komunal për korrje-shirje, pas konstatimit se gruri është në pjekje teknike, sot zyrtarisht e bëmë hapjen e fushatës. Unë e falënderoj kryetarin Haziri për përkushtimin e tij të madh për sektorin e bujqësisë. Në Komunën e Gjilanit janë 2500 hektarë të mbjellur me grurë. Për fat të mirë kemi 65 autokombanja. Shpresojmë që për 10 ditët e ardhshme ta përfundojmë. Me një mobilizim të plotë po bashkëpunojmë me të gjitha palët e involvuara në fushatë, sic janë shërbimi i zjarrfikësve, autokombanjat, bujqit”, ka thënë Ramadani.

Nehas Sopaj, fitues i çmimit letrar “Beqir Musliu” për vitin 2014

14 qershor 2014



Lutfi Haziri, kryetar i Komunës së Gjilanit, tha se Beqir Musliu është identiteti më i mirë për Gjilanin, duke nënvizuar se për së paku 24 vjet sa e ka njohur e takuar atë, ka mësuar shumë prej tij. “Madhështia e Beqir Musliut nuk është vetëm në libra, por madhështia e tij qëndron edhe në dashurinë dhe përkushtimin që pati gjithmonë për Gjilanin, për Kosovën dhe për kombin e tij”, ka thënë Haziri.

Juria e konkursit letrar ‘Beqir Musliu’, në përbërje Zejnepe Halili-Rexhepi, Hasan Bunjaku e Sarë Gjergji, ka shpallur të shtunën Nehas Sopajn nga Kumanova fitues të sivjetmë të çmimit letrar “Beqir Musliu”, që jepet nga Komuna e Gjilanit, për arritje të veçanta në letërsi.

Sopaj është fituesi i tetë me radhë i këtij çmimi, pas Ali Podrimjes, Sabri Hamitit, Musa Ramadani, Visar Zhitit, Ibrahim Kadriut, Rexhep Qosjes e Ramadan Mehmetit.

Përfaqësues institucionalë e politikë bëjnë homazhe në ditën e çlirimit të Gjilanit

15 qershor 2014



Për nder të Ditës së Çlirimit të Gjilanit, sot në varrezat e dëshmorëve në Gjilan kanë bërë homazhe kryetari i Komunës, Lutfi Haziri, i shoqëruar nga nënkryetari Rexhep Kadriu, drejtorët komunalë, përfaqësues të subjekteve politike, të FSK-së, PK-së, OVL të UÇK-së, familjet e dëshmorëve etj. Me këtë rast, kryetari

Haziri, ka thënë se kjo është ditë e bardhë për Gjilanin dhe Kosovën, sepse të gjithë kujtojmë ditën e çlirimit të Gjilanit.

“Sot shënojmë një ditë të veçantë të Gjilanit. Bëmë homazhe për dëshmorët, martirët dhe heronjtë luftën çlirimtare, por edhe të gjitha luftërat për liri të bëra ndër vite.

Nderim dhe përlje për të gjithë të rënë për liri, që emrat e tyre janë të skalitur këtu”, ka thënë kryetari Haziri, duke shtuar se menjëherë do të fillojmë ndërtimin dhe rregullimin e kësaj hapësire të varrezave në mënyrë që respekti të jetë merit për të gjithë ata. “Gjunjëzohemi sot para veprës së tyre dhe lus zotin që familjet e tyre të jenë të forta dhe krenare”, përfundoi kryetari Haziri.

Ndërsa, kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, ka urrear qytetarët e Komunës së Gjilanit, Anamoravës dhe të Kosovës për përvjetorin e lirisë. “Lavdi të rënëve për lirinë e vendit, dëshmorëve, martirëve, poashtu respekt për të gjallët, për familjet e dëshmorëve, invalidët dhe veteranët e luftës, ne sot jemi këtu së bashku me institucionet komunale për të nderuar dhe për t’u gjunjëzuar para veprës së dëshmorëve. Lavdi e përjetshme për veprën e tyre”, tha ndër të tjerash kryetari Haradinaj.

Haziri uron qytetarët për 15-vjetorin e çlirimit të Gjilanit

15 qershor 2014



Ramadani” për të nisur nata e pare e festivalit, i cili mbahet për herë të 11-të.

Nën patronatin e kryetarit të Komunës së Gjilanit Lutfi Haziri, kanë nisur aktivitetet në shënim të 15-vjetorit të çlirimit të Gjilanit nga pushtuesi agresor serb, ku sonte është mbajtur nata e parë e festivalit të këngëve dhe valleve “Gurra Popullore”. Fillimisht tetë ansamblet e të gjitha trojeve shqiptare kanë defiluar në sheshin “Agim

I pranishëm në këtë eveniment ka qenë kryetari i Komunës së Gjilanit Lutfi Haziri, nënkryetari Rexhep Kadriu, drejtorët komunal si dhe artdashës e mysafirë nga të gjitha trevat. Para qindra të pranishmëve, kryetari Lutfi Haziri ka uruar gjilanasit për ditët e bardha të lirisë së Gjilanit, ndërsa u shpreh i lumtur dhe krenar me organizimin fantastik të festivalit të këngëve dhe valleve “Gurra Popullore”.

“Më lejoni që në emër timin në emër të familjes time dhe Kuvendit Komunal të Gjilanit t’ju uroj ditët e bardha të lirisë, ditët e çlirimit të Gjilanit në këto ditë feste që sivjet e shënojmë e lirisë së Gjilanit. Më lejoni t’i falënderoj të gjithë këta njerëz që kanë punuar shumë që festivali i këngëve dhe valleve në këtë vit të bëhet realitet.

Falënderoj jurinë që është këtu, Drejtorinë e Kulturës dhe gjithë pjesëmarrësit që sot e nesër do ta ndajmë këtë festë, do ta ndajmë këtë gëzim dhe do t’i ndajmë këto vlera kulturore me të cilët ne krenohemi si Gjilan, Karadak e Gollak dhe si bashkëvendës, sepse ne jemi pjesë e rëndësishme e thesarit kulturor dhe vlerave tradicionale të trashëguara që do t’i ruajmë dhe avancojmë. Urime këto ditë të bardha Gjilan, Zoti ju ruajt të gjithëve”, është shprehur Haziri. Ndryshe, në ditën e nesërme kreu i Komunës me bashkëpunëtorë do të bëjë homazhe te varrezat e dëshmorëve dhe lapidarët në ora 11:00, ndërsa në ora 12:00 para teatrit të qytetit, do të bëhet ndarja e mirënjohjeve për persona të cilët kanë dhënë kontribut të veçantë në fusha të ndryshme.

Propozim-statuti i Komunës i nënshtrohet debatit publik

17 qershor 2014

Duke respektuar procedurën për ndryshimin e statutit, që Komuna e Gjilanit i ka hyrë me nismën e kryetarit Lutfi Haziri, është mbajtur debati publik, ku propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet i tyre në projektin-propozimin e komisionit statutar i kanë paraqitur qytetarë dhe zyrtarë të ndryshëm komunalë. Valentina Bunjaku-Rexhepi, kryesues e Kuvendit Komunal, kërkoi që në statut të përfshihet edhe themelimi i Zyrës për Barazi Gjinore, Komitetit për Barazi Gjinore si dhe ndarja e Drejtorisë për Kulturë, Rini e Sport në 3 sektorë.

Hevzi Matoshi nga Zyra Ligjore ka thënë se ndryshimi dhe plotësimi i statutit është nevojë për t'u harmonizuar me numrin e anëtarëve të Kuvendit, si pasojë e regjistrimit të popullsisë dhe me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe funksionalizimit të punës në administratën komunale. Ndryshimet dhe plotësimet në statutin e Komunës, janë propozuar nga komisioni statutar, në dispozitat të cilat prekin çështjen e numrit të përbërjes së anëtarëve të Kuvendit, numrin e drejtorive komunale dhe çështje tjera që lidhen me funksionalizimin e organeve komunale, duke e pasur parasysh Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale dhe Ligje tjera veçanta sektoriale.

Organet komunale obligohen që të informojnë qytetarët me shkrim lidhur me kërkesat e tyre, duke komunikuar drejtpërsëdrejti në gjuhën e tyre dhe duke ju lejuar qasje në dokumente zyrtare, në pajtim me ligjet përkatëse dhe aktet nënligjore. Një risi është se në mungesë të kryesuesit të Kuvendit të Komunës, mbledhjen e kryeson anëtari më i vjetër i Kuvendit. Po ashtu risi është Themelimi i Komiteti për bashkëpunim Ndërkufitar si dhe Zyrës për të drejtat e shqiptarëve të Luginës së Preshevës.

Valentina Bunjaku-Rexhepi, kryesues e Kuvendit Komunal, kërkoi që në statut të përfshihet edhe themelimi i Zyrës për Barazi Gjinore, Komitetit për Barazi Gjinore si dhe ndarja e Drejtorisë për Kulturë, Rini e Sport në 3 sektorë, siç është premtuar edhe nga kryetari i Komunës. Sokol Haziri, ka thënë se ndryshimet e propozuara nga komisioni, janë kozmetike dhe jo përmbajtësore, siç duhet të reflektojnë nga vullneti politik.

Haziri ka thënë se varianti i ofruar nuk i reflekton ndryshimet e nevojshme. Ai gjithashtu ka thënë se disa formulime në statut, duhet të jenë më të sakta dhe të mos lënë dilema për interpretime të ndryshme. Sejdulla Kadriu propozoi që Zyra për të Drejtat e Shqiptarëve në Kosovën Lindore, të quhet Zyrë Ndërlidhëse. Selver Xhelili tha se meritat për hapjen e kësaj Zyre u takojnë të gjitha subjekteve politike në Kuvend Komunal dhe nuk mund t'i përvetësojë vetëm përfaqësuesi i Lëvizjes "Vatra". Fazli Abdullahu, ka thënë se në kuadër të kësaj Njësie, sipas Udhëzimit Administrativ, funksionon edhe zyrtarja për Barazi gjinore dhe ajo për të Drejtat e fëmijëve. Barazia gjinore është segment i të drejtave të njeriut, ka thënë ai.

Avdyli Aliu tha se në projekt-statut duhet të parashihet edhe adresa e re e selisë së Komunës, meqë së shpejti kalon në objekt tjetër. Shaban Terziu kërkoi që në statut të parashihet edhe përfaqësimi i shoqërisë civile nëpër komisione komunale. Bujar Haziri ka propozuar që Kultura, Rinia dhe Sporti të mbeten një Drejtori, sikurse janë tani, duke krijuar kode të veçanta buxhetore për secilin sektor, nëse është e nevojshme, ose të bëhen dy Drejtori, duke themeluar edhe një Drejtori për Turizëm. Sipas Sadri Arifit, shef i Shërbimit të Kuvendit, themelimi i Drejtorive dhe

numri i tyre është e drejtë e pushtetit lokal. Koalicioni e ka të drejtën që të caktojë numrin e Drejtorive që i nevojiten për realizimin programit qeverisës, ka thënë Arifi.Hevzi Matoshi ka thënë se të gjitha kërkesat e arsyeshme dhe që nuk bien në kundërshtim me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, do të merren parasysh nga komisioni.

Qytetarët treguan interesim të mirë për të marrë pjesë në debatin për KAB 2015-2017

18 qershor 2014

Komuna e Gjilanit e ka ofruar të mërkurën në debat publik Kornizën Afatmesme Buxhetore 2015-2017, ku pjesëmarrja e qytetarëve ka qenë e kënaqshme. Ata kanë dhënë sugjerime dhe kanë paraqitur kërkesa për t'u përfshirë në planifikim buxhetor për tri vitet e ardhshme. Valentina Bunjaku-Rexhepi, kryesuese e Kuvendit Komunal i ka inkurajuar qytetarët që t'i japin kontributet e tyre në KAB, duke thënë se i mirëpresim të gjitha kërkesat.



Njëherësh, ajo i ka rikujtuar qytetarët se më 30 qershor mbahet edhe debati i kryetarit të Komunës, ku ata do të kenë mundësi t'i shprehin kërkesat e tyre, duke thënë se kontaktet dhe bashkëpunimi me qytetarët, do të jenë të përhershëm.

Përndryshe, Salih Kqiku, drejtor për Buxhet, ka thënë se KAB është bazë për caktimin e politikave zhvillimore si dhe prioriteteve për periudhën 2015-2017. Sipas tij, duke respektuar kufijtë buxhetor të Ministrisë së Financave, për vitin 2015 është planifikuar një buxhet prej mbi 21 milionë euro, ndërsa bazuar në kërkesat e drejtorive dhe nevojat e qytetarëve, në variantin e dytë, është planifikuar buxheti prej mbi 25 milionë e 712 mijë euro.

Për vitin 2016, buxheti i planifikuar është afër 26 milionë euro, ndërsa për vitin 2017 është 26 milionë e 285 mijë euro, ka thënë ai.

Shaban Terziu nga shoqëria civile, ka kërkuar që të planifikohen më shumë mjete për bujqësi, sikurse edhe Xhelil Zeqiri nga fshati Haxhaj, i cili ka thënë se fermerët duhet të përkrahen më shumë.

Përgjigja e Ramiz Ramadanit, drejtor i Bujqësisë, ka qenë se do të ketë investime dhe subvencione substanciale për të gjithë fermerët. Jakup Rrustemi e Shemsi Hasani kanë kërkuar të dinë nëse janë planifikuar për asfaltim rrugët në lagjen “Bregu i Djegur” dhe “Dheu i Bardhë”, kurse Shahadije Rexhepi ka kërkuar që në buxhetin komunal të parashihet edhe financimi i Qendrës për strehimin e grave dhe fëmijëve “Liria”.

Isa Shefkriu nga OJQ “Anamorava” tha se debatet me qytetarë duhet të organizohen edhe nëpër lokalitete, ku pos që duhet të bëhet identifikimi i kërkesave, duhet të planifikohet edhe afati për përmbushjen e tyre, duke u bazuar në mundësitë buxhetore, ndërkohë ka nënvizuar nevojën për ndërtimin e trotuarit nga Spitali Regional deri te pika e karburanteve “Kosova Petrol”, sikurse edhe ndriçimin publik në këtë rrugë.

Sa i përket infrastrukturës rrugore, Avdyli Aliu (LDK), tha se investimet janë planifikuar në projekt-buxhet dhe disa prej kërkesave tashmë kanë filluar të realizohen në terren.

Sokol Haziri, drejtor për Shërbime Publike, ka thënë se nuk pretendojmë se mund t'i zgjidhim të gjitha kërkesat e qytetarëve përnjëherë, por jemi duke punuar gjithandej.

Sa i përket ndriçimit publik, ky projekt do të kryhet sivjet në qytet dhe fshatrat e komunës së Gjilanit, ka thënë Haziri, duke nënvizuar se edhe sinjalizimi horizontal do të fillojë së shpejti.

Edhe Zijadin Maliqi, këshilltar komunal, Naser Sylejmani (Urbanizëm), Enver Biçkaj (Shërbime Publike) dhe përfaqësues të tjerë të pushtetit, kanë folur për projektet konkrete që janë duke u kryer, për ato që janë në procedurë të tenderimit, ose që do të kryhen në fazën tjetër, sipas radhës së punëve.

Haziri nderon me mirënjohje post mortum gazetarin

Bardhyl Ajeti

20 qershor 2014



Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, i ka ndarë sot mirënjohje post mortum gazetarit të njohur gjilanas, Bardhyl Ajeti, i cili u vra para nëntë vitesh. Mirënjohjen post mortum kryetari Haziri ia dorëzoi familjes së të ndjerit Bardhyl Ajeti, për të arriturat e tij në fushën publicistike, ndërsa shoqërohej nga nënkryetari Rexhep Kadriu.

Kryetari Haziri ka vlerësuar lart punën publicistike të veprimtarit Bardhyl Ajeti, ndërsa kërkoi nga organet e drejtësisë që sa më parë të gjenden autorët e vrasjes makabre. Gazetari dhe veprimtari Bardhyl Ajeti është qëlluar me një breshëri plumbash, më 3 qershor të vitit 2005 dhe vdiq më 25 qershor, pasi nuk mundi t'iu mbijetojë plagëve.

“Danke Schweiz”

20 qershor 2014

Është inauguruar në Gjilan rezervuari i ujit të pijshëm, i cili është financuar nga qeveria zvicerane.





Kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, ka falënderuar qeverinë zvicerane, e cila është lidere në investimet për ujë të pijshëm në rajonin e Anamoravës. Ai tha se për këto 15 vjet, kontributi i qeverisë zvicerane është njëherë më i madh se i qeverisë së Kosovës në investime. Kjo do të thotë se populli i Zvicrës është kujdesur në mënyrë të veçant për ne. “20 qershori shënon 15 vjetorin e prezencës dhe investimeve të Zvicrës në Komunën e Gjilanit, por edhe kujton që kontakti i parë yni me Zvicrën ka qenë në viti 1965 kur baballarët tanë kanë filluar jetën dhe punën në këtë vend. 15 vjet më parë, qeveria zvicerane ka ardhur dhe e ka ndihmuar një lagje të parë në rindërtim, ku tetë familjarëve u kanë ndërtuar shtëpitë, kanë ndihmuar shumë familje të integrohen dhe të fillojnë programet e bujqësisë, kanë vazhduar me investime jashtëzakonisht të mëdha në ujë të pijshëm, rrjeti të ujësjellësit rehabilitimit, zgjerimin e kapaciteteve, fabrika e ujit prej pendës së Përlepnicsë deri në fshatrat më të vogla”, tha Haziri. Kryetari Haziri e ka shpallur 20 qershorin, si “Ditë e Zvicrës në Gjilan”, e cila do të shënohet në shenjë falënderimi dhe për t’i njoftuar gjeneratat e ardhshme për kontributin e popullit zviceran për Gjilanin. Nuk mund të asnjë mënyrë ta imagjinojmë këtë progres pa ndihmën e madhe të qeverisë zvicerane e në veçanti këtë vepër e cila është ndërtuar sipas standardit zviceran, që sjellë ujë në shtëpitë tona. “Në emër të Gjilanit dhe qytetarëve tanë, ju themi “Danke Sëiss”, u shpreh Haziri. Ambasadorja e Zvicrës në Kosovë, Krystyna Marty-Lang, tha se qeveria zvicerane deri më tash ka investuar në rajonin e Anamoravës mbi 45 milionë franga zvicerane në sektorin e ujit të pijshëm, duke garantuar se do të vazhdojnë të jenë prezent me investime edhe në ardhmen në këtë sektor. “Ne mendojmë që më këto investime kemi përmirësuar kualitetin e jetës së qytetarëve të dy qyteteve dhe po ashtu do të

ndikojmë që të kemi një stabilitet socio-ekonomik”, ka thënë ambasadorja Krystyna Marty-Lang. Falënderime për shtetin zviceran kanë shprehur edhe ministri i Zhvillimit Ekonomik, Fadil Ismajli si dhe kryetari i Ferizajt, Muharrem Sfarqa.

Institucionet komunale nderojnë kolosin e letrave shqipe, Beqir Musliun

24 qershor 2014



Institucionet komunale të Gjilanit kanë bërë homazhe tek varri i shkrimtarit të madh Beqir Musliu, në 18-vjetorin e vdekjes së tij. I pranishëm në këtë nderim ishte nënkryetari i Komunës së Gjilanit, Rexhep Kadriu, i cili shoqërohej nga u.d. drejtori i Kulturës, Bujar Haziri, si dhe zyrtarë tjerë komunalë. Dorëshkrimet e Beqir Musliut së shpejti do ta shohin dritën, ka thënë Kadriu.

“Institucionet komunale sot janë në nderim të veprës së shkrimtarit të famshëm nga Gjilani Beqir Musliu, i cili ka dhënë shumë për Kosovën dhe për Gjilanin me veprat e tij. Do të përkujtojmë gjithherë, sepse veprat e tij kanë lënë gjurmë në mbarë shqiptarinë. Është veprimtar i cili ka punuar gjatë edhe me Presidentin Rugovë”, ka thënë Kadriu. Komuna e Gjilanit tradicionalisht ndan çmimin “Beqir Musliu” për veprën dhe shkrimtarin më të mirë dhe këtë traditë do ta vazhdojë edhe në të ardhmen. Po ashtu, edhe veprat të cilat i ka lënë Beqiri në dorëshkrim, do ta shihin dritën së shpejti. “Ky është premtim i kryetarit Haziri dhe do të realizohet”, ka thënë nënkryetari Kadriu. Ndërsa, Hasan Bunjaku, veteran i gazetarisë dhe mik i Beqir Musliut që nga fëmijëria, tha se ky i fundit ka qenë njëri nga shkrimtarët më të mëdhenj të letërsisë shqipe, dhe Gjilani identifikohet me të. “Beqir Musliu praktikisht i përket një brezi të shkrimtarëve, i cili ka pasur krijimtari poetike, prozatore, dramaturgjike, eseistike, kritikë letrare dhe teatrore, kolumnist, analist, ishte një njeri i cili shumë herët e mori vdekja duke na lënë pa një penë të mprehtë siç ishte Beqir Musliu”, tha veterani i gazetarisë Hasan Bunjaku.

Kuvendi Komunal miraton Kornizën Afatmesme Buxhetore 2015-2017

27 qershor 2014



Kuvendi Komunal i Gjiçanit, në seancën e radhës, ka miratuar Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2015-2017, vendimin për emërimin e anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve në kompanitë “Ecohigjiena” dhe “Kosovatrans”, vendimin për emërimin e Komisionit për plotësimin e emërtimeve të rrugëve dhe numërimit të adresave në territorin e

Komunës së Gjiçanit si dhe dy vendime për lejimin e transferim të mjeteve financiare.

Kryesuesja e Kuvendit Komunal, Valentina Bunjaku-Rexhepi, ka thënë se KAB është rekomanduar për miratim nga Komiteti për Politikë dhe Financa, pasi ka kaluar edhe debatin me publikun, ku janë dëgjuar dhe marrë parasysh edhe vërejtjet dhe sugjerimet e qytetarëve. Salih Kqiku, drejtor për Buxhet dhe Financa, ka thënë se në tri vitet e ardhshme, buxheti i Komunës së Gjiçanit, do të shënojë një rritje të ndjeshme, e cila do të shkojë deri në 5 milion euro. KAB është bazë për caktimin e politikave zhvillimore si dhe prioriteteve për periudhën 2015-2017. Si prioritete më të rëndësishme, në vizionin zhvillimor të Komunës së Gjiçanit, për tri vitet e ardhshme, Kqiku përmend forcimin e ekonomisë lokale, përmirësimin e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, kujdesin ndaj ambientit si dhe avancimin e shërbimeve për qytetarë. Kqiku tha se, duke respektuar kufijtë buxhetor të Ministrisë së Financave, për vitin 2015, në varantin e parë, është planifikuar një buxhet prej mbi 21 milionë euro, ndërsa bazuar në kërkesat e drejtorive dhe nevojat e qytetarëve, në variantin e dytë, është planifikuar buxheti prej mbi 25 milionë e 712 mijë euro. Rritja do të jetë më e theksuar në dy vitet pasuese, kur buxheti do të shkojë në afër 26 milionë (2016), përkatësisht në 26 milionë e 285 mijë euro (2017), thotë Kqiku. Në vitin 2015 parashihet një rritje reale prej 4.6 për qind, në vitin 2016 – 4.3 për qind dhe në vitin 2017 - 4.2 për qind. Të hyrat e planifikuara për vitet 2015-2017 do të rriten përafërsisht prej 2.12 – 7.41 për qind, në krahasim me vitin 2014. Rritja bazohet kryesisht tek të hyrat nga tatimi në pronë, që deri në vitin 2017 do të jetë 4.5 për qind.

Kqiku ka thënë se investimet kapitale do të shënojnë rritje në vitin 2015 për rreth 31 për qind, në krahasim me vitin 2014. Një pjesë e mirë e këtyre investimeve, bazohen në të hyrat vetanake, ka thënë Kqiku. Sipas tij, rritja e investimeve vetanake do të shënojë rritje nga viti në vit.

Opozita (PDK) e ka quajtur KAB-in, kopje të dokumentit të qeverisjes së kaluar. Sa i përket Komisionit 15 anëtarësh për emërtimin e rrugëve, që po ashtu u miratua nga Kuvendi Komunal, arsyetimin e kanë dhënë drejtori i Urbanizmit, Valon Shefkiu si dhe zyrtari Fehmi Agushi, duke thënë se kërkesa bazohet në projektin për sistemin e adresave në Kosovë. Subjektet politike do të përfaqësohen në komision në bazë të fuqisë që kanë në Kuvendin Komunal, duke respektuar kriterin e profileve profesionale që kërkohen, ka thënë Bunjaku-Rexhepi.

Sahit Abazi (PDK) e Fehmi Sylejmani (VV) kanë kërkuar që në Komisionet e Aksionarëve për kompanitë “Ecohigjiena”, që vepron në partneritet publiko-privat dhe “Kosovatrans” si kompani publike, njëri nga dy anëtarët, të jetë nga opozita, gjë që është pranuar nga kryesuesja e Kuvendit, duke hedhur në votim të dyja propozimet me emra konkretë, por nuk i ka marrë votat e shumicës. Kuvendi ka miratuar edhe vendimin për transferin e mjeteve financiare nga planifikimi i të hyrave vetanake, për nevoja të familjeve skamnore si dhe transferin e disa mjeteve të tjera në shëndetësi, me qëllim të furnizimeve mjekësore në QKMF, të cilat i ka arsyetuar Salih Kqiku, drejtor për Buxhet. Duke u përgjigjur në disa çështje që ngriti opozita, Lutfi Haziri, kryetar i Komunës, tha se debati kuvendar jashtë rendit të ditës nuk është normë statutare dhe i inkurajoi këshilltarët komunalë që ta iniciojnë këtë çështje për ta futur në statutin e Komunës, nëse duan që kjo pikë të jetë e përhershme.

Ndërkaq, duke dhënë përgjigje në pyetjet e ngritura nga opozita, ai ka thënë se borxhet e trashëguara edhe më tutje mbeten një barrë e madhe për qeverisjen e tashme, sepse borxhet duhet të servisohen nga të hyrat vetanake, për çka në këtë periudhë janë shpenzuar 1.8 milionë euro.

Sa u përket borxheve më të vjetra se tri vjet, Haziri ka thënë se ato do të dërgohen në gjykatë, sepse nuk mund të paguhen me kaq vonesë. Sa u përket disa shërbimeve të kontraktuara më herët, ai ka thënë se ato kontrata janë ndërprerë meqë komuna nuk ka kapacitet buxhetor për t'i paguar ato shërbime. Haziri mohoi në mënyrë kategorike që të jenë rritur shpenzimet. Kurse rreth tenderit për dezinfektim, ai sqaroi se e ka anuluar atë pasi ka kuptuar se para tri vitesh, e njëjta kompani ishte kontraktuar me çmim shumë më të ulët për këtë shërbim.

Sa i përket problemit të mësimdhënësve që rrezikojnë të mbeten pa vende pune, kryetari Haziri ka thënë se nuk do të hapet konkurs për mësimdhënës përderisa nuk sigurohemi se çdo punëtor arsimi me kontratë pune, është sistemuar.

Haziri mban premtimin: Objekti i Komunës i jepet Muzeut

28 qershor 2014

Deri më tani jemi marrë me servisimin e borxheve, kemi themeluar taskë-forcat e ndryshme për të siguruar mbarëvajtjen e punëve në Komunën e Gjilanit, grupin punues për bujqësinë, për grumbullimin e borxheve, ndërsa nga tash e tutje do të merremi me borxhet që subjektet dhe individët i kanë Komunës, duke besuar gjithmonë në formulën se nuk ka Komunë të pasur me qytetarë të varfër, ka thënë Lutfi Haziri, në konferencën për gazetarë.



Gjilani ka konfirmuar katër partneritete të mëdha me donatorët, siç është Komisioni European i cili ka miratuar projektin e parë në lagjen “Dardania” dhe kemi projektin tjetër të bashkëpunimit ndërkufitar me Shkupin. Do ta funksionalizojmë GJPKT-në si mikro-regjion evropian, në kuadër të bashkëpunimit me 17 kryetarë të Komunave. Po ashtu jemi duke punuar me GIZ – in gjerman në fushën e arsimit. Me

qeverinë zvicerane jemi duke punuar në projektet e ujit të pijshëm dhe në trajtimin e ujërave të zeza. Një partner tjetër i rëndësishëm është qeveria amerikane e cila ka konfirmuar partneritetin trevjeçar me Komunën tonë, në programin “Ta ndërtojmë Kosovën së bashku” që parasheh edhe investime, edhe ndërtim të kapaciteteve. Po punojmë shumë që deficitin buxhetor, që e ka shkaktuar qeverisja e PDK-së me partnerët e saj, ta mbulojmë me punë shtesë. Deri në këtë fazë kemi arritur jashtëzakonisht shumë me i realizuar këto qëllime dhe besojmë shumë që në gjashtë mujorin e dytë ne përfundimisht do ti arrijmë objektivat tonë, duke e normalizuar buxhetin dhe duke krijuar ambient më të qëndrueshëm për zhvillim ekonomik lokal, që është ambicia jonë kryesore”, ka thënë Haziri. Ai ka thënë se kjo është dita e fundit e tij në objektin e tashëm të Komunës, sepse nga e hëna do të zhvendoset në obatin tjetër, për ta liruar atë për Qendrën për trashëgimi kulturore dhe Muzeun e qytetit. are dhe gjithë ato që kanë probleme me strehim. Ne po ashtu do t’i ndajmë edhe 200 mijë euro për funksionalizimin e të gjitha ambulantave në Komunën e Gjilanit. Menaxhimi atje është i pranueshëm për punëtorët dhe gjendja atje është duke u prekur përmes hapave dhe rezultateve. Do të ketë një qeverisje të re në gjitha ambulatat. Politikat menaxheriale atje kanë dhënë rezultatet e para dhe ne jemi në mbështetje të funksionimit sa më të mirë, por edhe në mbështetje duke e vu prioritetin e parë shërbimin për qytetarët. Edhe në këtë sektor kemi bashkëpunëtor si Komisionin European, qeverinë Amerikane,

qeveria zviceriane, Caritasi i Kosovës në bashkëpunim me mbështetjen e Caritasit të Luksemburgut që po ndihmojnë këtë sektor por edhe bujqësinë në përgjithësi. Bashkë me Caritasin jemi në projektin e ofrimit të shërbimeve më të mëdha shëndetësore në Gjilan përmes shëndetësisë primare dhe këtë do ta bëjmë me kujdes dhe nën menaxhimin profesional. Po ashtu nënvizoj se kemi 11 lëndë – programe që ne pas raportit të auditivit që e kemi marrë do ti adresojmë në zyrat tona për ti dhënë rekomandimet tona finale. Rekomandime që ti zgjedhin më pas organet kompetente, sepse ne nuk mund të paguajmë fatura të vjetra më shumë se tri vjet, nuk mund të paguajmë borxhe të konsumit nëpër restorante, hotele, kafiteri dhe lokale që janë jashtëzakonisht të mëdha, nuk mund të paguajmë derivate, telefoni dhe bileta udhëtimi që nuk janë të arsyetuara. "Ne do të vazhdojmë me punë konform obligimit dhe kompetencave që na jep ligji", ka thënë Haziri. Jo më pak e rëndësishme është edhe puna e Kuvendit të Komunës, ku ne do të ndalojmë gjithë praktikën e këqija deri më tash. Të gjitha lëndët që duhet të shkojnë për shqyrtim para komiteteve ato do tu prezantohen dhe adresohen. Anëtarët e komiteteve kanë të drejtën që ti ftojnë drejtorët në takimet e tyre të rregullta dhe konsultuese përherë 24 orë dhe 7 ditë në javë, derisa të sqarohet gjithçka që është e nevojshme dhe në shërbim e interes të publikut. Dhe në fund Komiteti për Politikë dhe Financa është autoriteti që lejon apo kërkon kompletimin e një propozim vendimi para se ai ti dërgohet Kuvendit. Haziri tha se beson që muaji korrik do të jetë koha kur do të ndryshohet statuti përfundimisht. Administrata e Gjilanit do të duket ndryshe, numerikisht më e vogël por me shërbime më të mëdha për qytetarin. Të gjitha dokumentet e Komunës së Gjilanit do të punojmë që të jepen në një objekt të Komunës, në mënyrë që qytetari mos të humb kohë gjatë pajisjes me një dokument. Administrata do të jetë e gatshme që të përballlet me një milion sfida që ka Gjilani, ka thënë Haziri.

Kryetari Haziri mban takimin e parë publik - interesimi i qytetarëve tejet i madh

30 qershor 2014



Kryetari i Komunës së Gjilanit Lutfi Haziri së bashku me nënkryetarin Rexhep Kadriu, kryesuesen e Kuvendit Komunal Valentina Bunjaku-Rexhepi si dhe drejtorët komunal kanë mbajtur debatin e parë publik me qytetarët gjilanas, ku të pranishëm ishin qindra qytetarë. Fillimisht kryetari Haziri tregoi për punët që qeverisja të cilën e udhëheq ai i ka bërë për këto gjashtë muaj, duke filluar nga disiplina e ashpër buxhetore, për të cilën tha se nënkupton ndaljen e cfarëdo lloj shpenzimi të panevojshëm.

Kryetari Haziri tha brenda gjashtë muajve janë shlyer mbi 1.8 milionë euro borxhe të trashëguara nga qeverisja e kaluar. “Në vend se të bëjmë investime të mëdha, ne është dashur të shlyejmë borxhet që janë kryesisht ndaj operatorëve privat nga Gjilani”, tha Haziri.

Gjatë kësaj kohe, Haziri theksoi se i ka ndërprerë të gjitha kontratat në vepër, kanë nisur projektet e katërshes së madhe të prioriteteve në infrastrukturë, ndërsa Komuna e Gjilanit ka konkuruar në 8 programe dhe i ka fituar shumicën e tyre, ku donatorë janë: Bashkimi Europian, qeveria zvicerane, GIZ-i gjerman e USAID-i amerikan.

Kreu i Komunës së Gjilanit pohoi se janë marrë me trajtimin e rasteve sociale, ndërsa për kategorinë e qytetarëve që kanë probleme të strehimit ku janë zotuar mjete shtesë. Më pas kanë pasur pyetjet e shumta të qytetarëve lidhur me lumin “Mirusha”, ndërtimin e parkut në lagjen “Dardania”, projekte infrastrukturore, sociale, të arsimit, të bujqësisë, të kulturës e sportit, ndërsa me kënaqësi u janë përgjigjur kryetari Haziri, nënkryetari Kadriu, kryesuesja Bunjaku-Rexhepi dhe drejtorët komunal.

Nënkryetari Rexhep Kadriu, duke folur për ecurinë e punimeve të lumit “Mirusha”, ka thënë se deri tash janë punuar 1100 metra kanalizim, ndërsa kanë mbetur edhe 550 metra deri në përfundim, ndërsa për shtratin e lumit tha se janë në rishim të projektit, duke thënë se nuk do të bëhen shpronësime milionëshe, por do të gjendjen zgjidhje alternative. Ndërsa kryesuesja Valentina Bunjaku Rexhepi është përgjigjur në pyetjet për shoqërinë civile, duke thënë se është prezente në të gjitha trupat e Kuvendit. Ajo tha se po mundohet ta bëjë punën mirë në Kuvend, duke i trajtuar asambleistët e pozitës dhe opozitës njësoj.

Ndërsa, duke folur për buxhetin për Bujqësinë, kryetari Haziri tha se është paraparë që 52 për qind e të hyrave komunale të shkoj për këtë sektor, por në këtë vit nuk ka qenë e mundur një gjë e tillë pasi që buxhetin e miratuar nga ish-qeverisja nuk ka mundur ta ndryshojë.

Kryetari i Komunës së Gjilanit është shprehur gjithashtu se do të rregullohet edhe çështja e transportit të nxënësve që udhëtojnë më larg se katër kilometra. Ai tha se Qendra Kryesore Mjekësisë Familjare do të funksionalizohet, përderisa shtoi se do të zgjidhet edhe çështja e “Sahat kullës”.

Kryetari i Gjilanit Lutfi Haziri tha në fund se në të ardhmen do të ketë debate lagje për lagje dhe fshat për fshat, për t’i dëgjuar hallet dhe kërkesat e qytetarëve dhe për t’i realizuar projektet e duhura për ta.

Kuvendi Komunal rekomandon zgjidhje brenda ligjit për problemin e mësimdhënësve që mbeten pa vende pune

1 korrik 2014

Kuvendi Komunal i Gjilanit e ka diskutuar në një seancë të jashtëzakonshme problemin e mësimdhënësve që rrezikojnë të mbeten pa vende pune, shkaku i reformave në arsim dhe i ka rekomanduar kryetarit të Komunës si dhe Drejtorisë Komunale të Arsimit që të bëjnë zgjidhje brenda mundësive ligjore. Valenatina Bunjaku-Rexhepi, kryesuese e Kuvendit Komunal, ka thënë se mbajtja e kësaj seance të jashtëzakonshme është kërkuar nga Sahit Abazi dhe grupi i këshilltarëve të PDK-së, ndërsa është përkrahur nga të gjitha subjektet tjera politike.

Sahit Abazi, shef i grupit të këshilltarëve të PDK-së, i ka paraqitur rekomandimet e subjektit të tij, ku kërkohet që asnjë mësimdhënës të mos mbetet pa vend pune, ndërsa zgjidhja të bëhet duke shtuar numrin e paraleleve nëpër shkolla dhe duke ulur numrin e nxënësve nëpër paralele. Arben Mehmeti, në emër të grupit të këshilltarëve të LDK-së, ka thënë se problemi është krijuar nga MASHT-i dhe jo nga Komunitatet.

“Ne si komunë duhet të kemi kujdes që të mos bëjmë veprime jashtë ligjit, por të kërkojmë zgjidhje për rastin e këtyre mësimdhënësve brenda kompetencave tona”, ka thënë Mehmeti, derisa ka lavdëruar Kuvendin Komunal për gatishmërinë që ka treguar për t’u marrë me këtë problem në një seancë të veçantë dhe në kohë pushimesh. Fehmi Sylejmani, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje, ka thënë se shqetësimi i mësimdhënësve është i arsyeshëm, ndërkaq si alternativa për zgjidhjen e këtij problemi, ka propozuar që sive të mos ketë konkurs për punëtorë të rinj, por të sistemohen mësimdhënësit që humbin vendet e punës, themelimin e paraleleve me më pak nxënës, themelimin e drejtimeve të reja si dhe mundësi të tjera.

Mevlyde Zejnullahu, në emër të grupit të këshilltarëve të AAK-së, tha se vetëm në shkollën e mesme “Marin Barleti” mbeten pa vende pune 23 mësimdhënës. Edhe ajo zgjidhjen e sheh te ulja e numrit të nxënësve nëpër paralele. Këtij debati i kanë kontribuar po thuaj se të gjithë këshilltarët komunalë, duke shprehur shqetësimet e tyre dhe duke propozuar zgjidhje të këtij problemi. Nazmi Musa, drejtor i Arsimit, i ka mirëpritur të gjitha propozimet, por ka thënë se zgjidhja nuk mund të bëhet jashtë ligjit. “Zgjidhja mund të bëhet vetëm duke u bazuar në ligj”, ka thënë Musa, duke sqaruar se MASHT-i nuk ka dhënë asnjë udhëzim se si duhet zgjidhur çështjen e mësimdhënësve që mbeten pa vende pune, shkaku i shuarjes së klasave të 13-ta. Musa ka garantuar se sive nuk do të ketë konkurs sikur viteve tjera, për shkak të nevojës për t’i sistemuar mësimdhënësit që mbeten pa vende pune. Kuvendi ka diskutuar edhe për kërkesën e një grupi të mësimdhënësve të gjimnazit “Zenel Hajdini” që ka të bëjë me sistemin e brendshëm të kuadrit, meqë dihet se gjimnazi është ndarë në dy shkolla.

Haziri: 2 Korriku është gurthemel i pavarësisë së Kosovës

2 korrik 2014

Në 24-vjetorin e shpalljes së Deklaratës së Pavarësisë, kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka thënë se 2 Korriku 1990, është gurthemel, mbi të cilin u ndërtua pavarësia e Kosovës.



“2 korriku i vitit 1990 shënon ditëlindjen e Pavarësisë së Kosovës dhe ditën kur vullneti popullor u deklarua nga të zgjedhurit. Heronjtë e 2 korrikut, delegatët e Kuvendit të Kosovës, duhet t’i nderojmë e falënderojmë për aktin më madhor që bënë në kushte okupimi. 2 Korriku i vitit 1990 është gurthemel, mbi bazat e së cilës u ndërtua pavarësia e Kosovës”, ka thënë kryetari Haziri. Deklarata Kushtetuese e 2 Korrikut 1990 u

shpall në gjendje të jashtëzakonshme të shtettrëthimit ushtarako-policor, që kishte vendosur Beogradi, dhe si kundërpërgjigje e rrënimit kundërkushtetues e me forcë. Ky akt konsiderohet si bazë për shtetin e Kosovës në kuptimin historik, juridik dhe demokratik, ka thënë Haziri.

Banorët e fshatrave të Malësisë falënderojnë Komunën e Gjilanit për rregullimin e rrugëve



Gjilan, 5 korrik - Kryetari i Komunës së Gjilanit Lutfi Haziri ka vizituar sot punimet në shtrimin e fazës së parë të disa rrugëve e rrugicave me zhavor në fshatrat e Malsisë: Gadish, lagjja e “Dubovëve”, lagjja “Srpka”, e Sllakovc, si dhe punimet e shkollës fillorenë Kishnapole.

Banorët e kësaj ane e kanë falënderuar kryetarin Haziri për kujdesin, duke thënë se tashmë do ta kenë shumë më lehtë jetën.

“Ju falënderoj shumë z. kryetar që na keni shtruar rrugët. Deri tash kemi qenë në gjendje shumë të rëndë, e kemi pasur shumë të rëndë jetësen, ndërsa tash e tutje do ta kemi më të lehtë në të gjitha

aspektet”, tha Rasim Ajvazi, i cili foli në emër të banorëve të Gadishit.

Nga ana e tij, kryetari Haziri tha se kjo është më e pakta që mund të bëjë për banorët e kësaj ane, të cilët kanë vuajtur shumë nga lënia pasdore.

Ai tha se e ka për obligim t’i kryej detyrat e tij, në rregullimin e infrastrukturës me të gjitha elementet e saj, duke shtuar se kujdesi i Komunës nën udhëheqjen e tij nuk do të mungojë asnjëherë për banorët e Malësisë.

Komuna e Gjilanit ndërton rrugë të modelit europian – me shteg të biçikletave

7 korrik 2014

Po vazhdojnë punët e mira në qeverisjen e kryetarit të Komunës së Gjilanit Lutfi Haziri. Në rrugën “Halim Orana” dhe në atë “Fehmi Agani” në lagjen “Dardania II” është ndërtuar rruga e stilit europian, me të gjitha elementet përcjellëse, madje me shteg edhe për biçikleta.



Për të parë nga afër realizimin e punimeve ka dalë në vendin e ngjarjes drejtori i Shërbimeve Publike, Sokol Haziri, i cili potencoi se ky është trend i ri i kohës moderne, ndërsa ka dy përfitime për qytetarët: iu mundëson biçiklistëve të lëvizin në mënyrë të barabartë me automjetet në trafik dhe ndikohet në mbrojtjen e ambientit.

“Në kuadër të projektit të shënjzimit horizontal të rrugëve, sektori përkatës i ka kryer këto punë që janë vërtet jo vetëm të bukura për t’i parë, por janë edhe shumë praktike për t’ju mundësuar

qasje të barabartë në komunikacion edhe biciklistëve. Në aspektin teknik po e shohim për herë të parë dhe ky proces do të vazhdojë të implementohet në ato aty ku ka mundësi teknike. Ky është një trend i ri, në përkrahje me kërkesat e kohës moderne për t'iu mundësuar qytetarëve që më tepër të lëvizin me bicikleta se sa me automojete, për shkak të faktorëve që ndikojnë në mbrojtjen e ambientit”, tha Haziri.

Me këtë trend të modelit evropian, Komuna e Gjilanit do të vazhdojë ndërtimin e rrugëve tjera të qytetit dhe në fshatra, duke iu mundësuar qytetarëve jetesë të dinjitetshme.

Haziri u bënë apel qytetarëve që të paguajnë tatimin në pronë

10 korrik 2014



Kreu i Komunës së Gjilanit Lutfi Haziri i shoqëruar nga drejtorët komunalë ka inspektuar punimet e rrugëve në disa lagje të qytetit. Së pari, Haziri është ndalur te rruga “Mulla Idrizi”, e cila ka përfunduar në mënyrën më të mirë. “Kjo është një ndihmesë e madhe për ne që jetojmë e veprojmë këtu”, ka thënë Masar Morina, avokat.

Ndërkaq, kryetari Haziri pohoi se po i kryen detyrat e tij dhe obligimet që i takojnë ndaj qytetarëve. Ai u ka bërë apel qytetarëve që të paguajnë tatimin në pronë dhe taksat komunale, sepse në këtë mënyrë shumëfishohen investimet. “Taksat komunale do t'i investojmë në rrugë, ujësjellës, kanalizime e ndriçim publik në lagje e fshatra të Komunës së Gjilanit”, tha kryetari Haziri. Më pas, kryetari Haziri ka vizituar punimet në rrugicën për këmbësorë përballë Xhamisë së Vogël si dhe rrugën “Ali Hadri”. Ai ka folur edhe për borxhet e trashëguara, duke thënë se janë pengesë e madhe për investime. “Brenda gjashtë muajve i kemi shlyer mbi 1.8 milionë euro borxhe”, ka thënë Haziri.

Haziri nënshkruan memorandumin për rregullimin e parkut në “Dardania”

11 korrik 2014



Kryetari i Komunës së Gjilanit Lutfi Haziri ka nënshkruar në Prishtinë Memorandumin e Mirëkuptimit për zbatimin e projektit “Krijimi i parkut dhe zonave të gjelbra në lagjen Dardania në Gjilan, i cili realizohet në kuadër të programit të BE-së “Kosova e bukur 2”. Ky projekt kap vlerën mbi 240 mijë euro, ku Komuna e Gjilanit participon me 10 për qind.

Qytetarët e lagjes “Dardania” kanë arsye të gëzohen, ngase në pjesën ku aktualisht shiten dru për ngrohje, do të ndërtohet ky park modern. Ndryshe, në kuadër të këtij projekti do të marrin pjesë në punë edhe personat me nevoja të veçanta, që përfshin shoqatat Handikos, të verbrit dhe shurdhmemecët, cilët do të kompensohen nga Komisioni Europian.

Katërshja e prioritetëve të Hazirit po vazhdon të realizohet me dinamikë të madhe

13 korrik 2014



Katërshja e prioritetëve të qeverisjes së kryetarit Lutfi Haziri po vazhdon të realizohet me një dinamikë të madhe. Pas fillimit të punimeve në rrugët Lladovë-Nasalë, Pogradjë-Bilinicë, të disa rrugëve në Përlepnice, pastaj në lagjet “Dheu i Bardhë”, “Zabeli i Sahit Agës”, në Gadish, Sllakovc, Kishnapole etj, Komuna e Gjilanit po vazhdon me sukses të realizojë edhe rrjetin e ujësjellësit në disa fshatra.

Banorët e fshatrave Bresalc, Ponesh, Zhegoc dhe Verbicë e Kmetocit brenda pak kohësh do t'i lënë pas problemet me mungesën e ujit, ngase Komuna është në përfundim të punimeve të rrjetit të ujësjellësit. Kryetari Lutfi Haziri së bashku me drejtorët komunalë ka parë nga afër punimet në fshatin Bresalc, ndërsa është ndarë i kënaqur me dinamikën e punës së deritashme në realizimin e punëve të katërshes e madhe.

“Ashtu siç ju kemi premtuar, punët jemi duke i kryer një nga një. Po punojmë për të mirën e qytetarëve në qytet e në fshatra dhe shumë shpejt ju do të keni ujësjellëin që ju ka munguar aq shumë deri tash”, tha kryetari Haziri. Kurse banorët e Bresalcit e falënderuan kryetarin Haziri për investimet, duke thënë se ua ka kthyer vullnetin për të jetuar në fshat.

Ndryshe, faza tjetër e investimeve do të jetë në fshatrat e tjera, në ndërtimin rrjeteve të reja, si dhe rehabilitimin e ujësjellësve ekzistues. Realizimi i projekti të ujësjellësit po bëhet nga Komuna e Gjilanit në partneritet me CDI zvicerane.

Kryetari Haziri dhe stafi i tij vendosen tek objekti i ish-gjykatës

15 korrik 2014



Komuna e Gjilanit njofton qytetarët se kryetari Lutfi Haziri me stafin e tij është vendosur në objektin e ish-gjykatës. Tash e tutje, qytetarët e interesuar për ta takuar kryetarin Haziri, duhet të drejtohen te ky objekt. Kryetari Haziri pati premtuar në fushatën elektorale që objektin e deritanishëm të Komunës, në të cilin ka qëndruar për gjashtë muaj, do ta lëshoj për Muzeun e qytetit dhe kështu edhe ka vepruar. Që nga marrja e mandatit, kryetari Haziri po i realizon premtimet e bëra në fushatë një nga një. Adresa e tanishme e zyrës së kryetarit është "Bulevardi i Pavarësisë".

Peticioni: Pa vendosjen e drejtësisë në vendin e saj s'mund të ketë rehati

15 korrik 2014

Në Gjilan, ku ka vazhduar nënshkrimi i peticioni nga qytetarët, sot nënshkrimin e tyre e kanë vënë edhe kreu i Komunës Lutfi Haziri, kryesuesja e Kuvendit Valentina Bunjaku - Rexhepi, nënkryetari i Komunës, Rexhep Kadriu, drejtorët komunalë dhe përfaqësues të partive politike, policisë, OJQ etj. Me këtë rast, Edita Tahiri, zëvendëskryeministre dhe kryesuese e Grupit të Grave për nënshkrimin e Peticionit, ka thënë se në Gjilan ka ardhur për të parë nga afër procesin e nënshkrimit të peticionit në kërkim të drejtësisë ndërkombëtare për gratë e dhunuara gjatë luftës në Kosovë.

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka falënderuar në emër të qytetarëve të Gjilanit, zëvendës kryeministren për prezencën në Gjilan dhe aksionin e saj të ndërmarr për vendosjen e drejtësisë, karshi një dhunë dhe një gjenocidi që ka ndodhur në Kosovë, në veçanti ndaj grave dhe dhunimit sistematik që Kosova e ka përjetuar. “Pajtohem se pa vendosjen e drejtësisë në vendin e saj, nuk mund të ketë rehati, qetësi dhe nuk mund të ketë drejtësi përfundimisht. Nga dje trendi i nënshkrimit të peticionit ka nisur të rritet nga momenti në moment dhe përgjigja e qytetarëve për këtë aksion është masive. Mundësia do të krijohet çdo qytetari që të vij këtu dhe të nënshkruaj. Solidariteti në Gjilan është jashtëzakonisht i madh dhe kërkesa për vendosje të drejtësisë është kërkesa kryesore”, ka thënë ndër të tjerash kryetari Haziri.

Haziri u bënë apel qytetarëve që t'i paguajnë borxhet ndaj Komunës

16 korrik 2014

Task Forca për grumbullimin e borxheve që qytetarët i kanë obligime Komunës së Gjilanit të cilës i prinë shefi i Kabinetit të kryetarit Haziri, Arbër Ismajli, ka raportuar sot në mbledhjen e bordit të drejtorëve lidhur me punën e tyre. Në këtë mbledhje u konstatua se shuma e borxhit që qytetarët dhe bizneset kanë ndaj Komunës nga e kaluara është mbi 11 milionë euro.

Për tatimin në pronë, obligimi i qytetarëve dhe bineseve është mbi 9.2 milionë euro, për taksa komunale obligimi është mbi 1.7 milionë euro, për të hyrat nga partneriteti publiko-privat borxhi është mbi 45 mijë euro, për qiratë nga pronat e Kuvendit Komunal borxhi është mbi 266 mijë euro, ndërsa për qiratë nga Inkubatori i Biznesit është borxhi është afro 7 mijë euro. Kryetari Haziri është njoftuar po ashtu nga anëtarët e Task Forcës për grumbullimin e borxheve lidhur me

formimin edhe të një komisioni në terren, të cilët u kanë dërguar vërejtje bizneseve dhe qytetarëve që nuk e kanë shlyer këtë obligim. Nga ana e tij, kryetari i Komunës së Gjilanit Lutfi



Haziri ka apeluar qytetarët që të paguajnë borxhet ndaj Komunës, pasi tha se në këtë mënyrë do të ketë investime në fushat më të rëndësishme të jetës. “Intensiteti do të rritet dhe kërkojmë shlyerjen e obligimeve në mënyrë që të vazhdohet me dinamikën më të madhe investimi në infrastrukturën

komunale. Borxhet do të kthehen tek qytetarët përmes investimeve në rrugë, kanalizime, trotuare, aktivitete kulturore, sportive, bursat për student, programe bujqësore etj. Apeloj te të gjithë ata që kanë obligime të realizojnë këtë obligim qytetar në mënyrë që të punojmë bashkë më shumë”, ka thënë Haziri.

Asfaltohet rruga Pogragjë-Bilinicë, Haziri inspekton punimet

19 korrik 2014

Kryetari i Komunës së Gjilanit Lutfi Haziri i shoqëruar nga drejtorët komunal, ka vazhduar me inspektimin e punëve që Komuna po bënë në infrastrukturë.

Pasi ka parë nga afër punimet në disa lagje të qytetit dhe në disa fshatra, kryetari Haziri ka parë sot përfundimin e punimeve në rrugën Pogragjë-Bilinicë.

Kryetari Haziri është ndarë i kënaqur me punën që është bërë në këtë rrugë, duke thënë se tashmë banorët e kësaj ane nuk do të mendojnë më për shpërngulje në qytet, pasi u është mundësuar të jetojnë në kushte normale.

“Kur kam ardhur këtu dhe e kam parë këtë rrugë gjatë fushatës elektorale jam tmerruar dhe ju pata premtuar se ndër punët e para që do të bëjë si kryetar i Gjilanit do ta asfaltoj këtë rrugë si është më së miri. Dhe ja sot, e keni rrugën e asfaltuar me standarde të larta. E di që pas kësaj, më nuk do të mendoni për shpërngulje. Ne vazhdimisht do të kujdesemi që t’ua bëjmë jetesën më të lehtë”, ka thënë kryetari Haziri.

Nga ana e tyre, banorët e kësaj ane kanë falënderuar kryetarin e Komunës së Gjilanit për investimin më të madh që e mbajnë mend ata për atë pjesë, duke thënë se tash do ta kenë shumë të lehtë qarkullimin.

Komuna e Gjilanit ka investuar në këtë rrugë në vlerë prej 158 mijë eurosh, e cila është me gjatësi prej 3.5 kilometra dhe gjerësi katër metra.

Në ndërkohë, i pari i Komunës së Gjilanit me bashkëpunëtorë ka parë nga afër edhe përfundimin e rrugës Pogragjë-Llovçë, e cila është asfaltuar sipas standardeve europiane.

Pas ecjes epike deri në Bruksel, Shtegtarët e lirë kthehen në Gjilan

20 korrik 2014



“Shtegtarët e Lirë” të përbërë nga Nazim Ajdini, Jahi Mustafa, Xhevdet Shabani dhe Liridon Basha janë kthyer sot në Gjilan nga Brukseli, pas ecjes në këmbë që nga 30 prilli e deri më 17 korrik 2014, me simbolikën për liberalizimin e vizave për Kosovën. Shtegtarët i ka pritur sot kryetari i Komunës së Gjilanit Lutfi Haziri, nënkryetari Rexhep Kadriu dhe qytetarë të shumtë të mbledhur para teatrit të qytetit.

Me këtë rast, kryetari Haziri ecjen prej 5 milionë hapash Gjilan-Bruksel të Shtegtarëve të lirë” e ka quajtur ecje epike, duke vlerësuar këtë si hap të madh drejt liberalizimit të vizave. “Kjo ecje epike që e kanë quajtur mediat kosovare dhe ato ndërkombëtare, është e pashembullt sepse kjo ecje e “Shtegtarëve të lirë” bëhet për një liri, një të drejt dhe një barazi që qytetarët e Kosovës sot nuk e kanë, atë që edhe vetë prindërit tanë e kanë pasur dikur. Ky hap i madh, kjo ecje epike, sigurisht që e ka bërë efektin dhe ka lënë gjurmë të mëdha edhe në Komisionin Europian edhe në Asamblenë e NATO-s. Me këtë rast, dëshiroj t’i falënderoj këta shtegtarë për këtë akt që e bënë. I falënderoj të gjithë bashkatdhetarët tanë në shtetet e ndryshme, të cilët u kanë ofruar ndihmë, sado të vogël, sepse rrugat e tyre ka qenë plot sfida”, tha Haziri.

I pari i gjilanasve theksoi se ky grup i shtegtarëve së bashku me Xherdan Shaqirin kanë qenë emblemë e Gjilanit për këta muaj, duke na bërë krenarë. Haziri ka thënë se migrimi ilegal është armiku kryesor i Kosovës dhe se me këtë shtegtarët treguan se nuk e shohin Europën vetëm si punëtori, por e shohin si mundësi dhe si barazi për të gjithë.

Në emër të grupit “Shtegtarët e lirë” foli Jahi Mustafa, i cili tha se kanë marrë mbështetje nga Brukseli që shumë shpejt do të bëhet liberalizimi i vizave për kosovarët. “Ne morëm mbështetje të fortë nga Brukseli që liberalizimi do të ndodhë shumë shpejt. Pikërisht nga atje kemi sjellë një mesazh që t’i themi “Jo” migrimit ilegal, por ta presim liberalizimin e vizave dhe të udhëtojmë lirshëm si të gjithë qytetarët e Europës”, tha Jahi Mustafa.

Rrugët e rendit të tretë në Kokaj, Sllubicë e Kacabaç janë në përfundim e sipër

30 korrik 2014



Po vazhdojnë punimet në realizimin e katërshes së madhe të prioritetëve infrastrukturore të qeverisjes së kryetarit të Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri.

Pas përfundimit të punimeve në qytet e fshatra, tashmë janë në përfundim e sipër punimet e rrugëve të rendit të tretë në lagjen “Kacabash” të muhagjerëve të Pogradjës me gjatësi

prej 2.6 kilometra, si dhe rruga që i lidhë fshatrat: Llovçë, Kokajt Epërm, Kokajt e Poshtëm, Sllubicën dhe Pogradjën me gjatësi prej 8 kilometrash që përfshinë të gjitha lagjet tyre.

Për të parë nga afër punimet, ka dalë sot në terren kryetari i Komunës së Gjilanit Lutfi Haziri, i shoqëruar nga nënkryetari Rexhep Kadriu si dhe drejtori i Shërbimeve Publike Sokol Haziri.

Kryetari Haziri tha se banorët e kësaj ane as që e kanë imagjinuar që të udhëtojnë me vetura për të shkuar në fshatrat e tyre, ndërsa sot kjo u është mundësuar.

“Kjo është një vazhdimësi e punimeve të shumta që jemi duke i realizuar në shumë fshatra dhe lagje të qytetit në infrastrukturë që përfshijnë ndërtimin e rrugëve, rrjetin e kanalizimit, të ujësjellësit dhe ndriçimin publik. Punët e mira do të vazhdojnë edhe në të ardhmen për t’i zgjidhur të gjitha problemet infrastrukturore dhe problemet tjera”, ka thënë kryetari Haziri.

Nga ana e tyre, banorët e asaj ane falënderuan kryetarin Haziri për kujdesin duke thënë se do ta kenë shumë më të lehtë jetesën në fshatrat e tyre.

“Jemi shumë të kënaqur dhe mirënjohës ndaj kryetarit Lutfi Haziri që na ka shtrur rrugën. Kurrë në këtë vend s’kemi mujt me kalu me vetura, por gjithmonë kemi ardhë n’kambë. Tash kemi arsye me ardhë ma shpesh me familjen e me u kënaq në vendin tonë, qysh po e shihni jemi mbledhë disa familje bashkë dhe jemi dale sot këtu”, tha Mevlide Krasniqi nga lagjja Kacabaç e Pogragjës, e cila jeton në Zvicër.

Këto punime përfshijnë hapjen, zgjerimin dhe rrafshimin e rrugëve dhe pritjet të përfundojnë së shpejti.

Kuvendi miraton raportin financiar janar-qershor 2014

30 korrik 2014

Kuvendi Komunal i Gjilanit, të mërkurën, në seancën e radhës, të cilën e ka udhëhequr kryesuesja Valentina Bunjaku-Rexhepi e ku ka marrë pjesë edhe kryetari i Komunës, Lutfi Haziri, nënkryetari Rexhep Kadriu si dhe drejtorët komunalë, ka miratuar raportin



financiar janar-qershor 2014, propozim-vendimin për revidimin e zgjidhjes urbanistike të kompleksit të shkollave të mesme si dhe tri propozim-vendime mbi qasjen e hartimit të planeve rregulluese të hollësishme “Lagja e Spitalit”, “Qendra 3” dhe “Zabeli 1”, dhe të gjitha këto i ka rekomanduar për Kuvend Komunal.

Raportin financiar e ka prezantuar drejtori për Buxhet, Salih Kqiku, i cili ka thënë se buxheti i përgjithshëm për vitin fiskal 2014, është 20.125.842 euro. Nga grandi janë planifikuar të sigurohen 16.345.842 euro, kurse nga të hyrat vetanake, 3,780.000 euro të tjera.

Plani i të hyrave vetanake, në këtë periudhë është për rreth 7 për qind më i lartë se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, përkatësisht është realizuar për afër 45 për qind në krahasim me planin vjetor, tha Kqiku. Ai ka prezantuar edhe raportin e shpenzimeve komunale, duke thënë se në këtë periudhë janë shpenzuar 9.8 milionë euro të buxhetit vjetor.

Në përgjithësi ka ulje të shpenzimeve, me përjashtim të pagave, ku shpenzimet janë më të mëdha shkaku i rritjes së pagave nga qeveria, ka thënë Kqiku, duke nënvizuar se te disa kode buxhetore shpenzimet janë zero. Valentina Bunjaku Rexhepi, kryesuese e Kuvendit Komunal, duke i ftuar këshilltarët që të miratojnë raportin, tha se ai është rekomanduar nga Komiteti për Politikë dhe Financa. Vëmendje të konsiderueshme të këshilltarëve komunalë tërhoqi edhe propozim-vendimin për riorganizimin e hapësirës së shkollave të mesme, të cilin e ka arsyetuar Mumin Kqiku nga Drejtoria e Urbanizimit.

Ai tha se ishte e domosdoshme të bëhet revidimi i zgjidhjes së miratuar në vitin 2012, për shkak të kërkesave të qytetarëve për të pasur qasje nëpër këtë zonë, por edhe kërkesës për ndërtimin e një shkolle të muzikës brenda kësaj hapësire.

Kqiku tha se baza ligjore për këtë revidim ekziston te ligji për planifikimin hapësinor dhe plani rregullues për zonën e qendrës. Opozita (PDK e VV) nuk i vlerësoi të mjaftueshme këto arsye për revidim të planit ekzistues. Sgarime shitesë dhe Rexhep Kadriu, nënkryetar i Komunës, duke thënë se revidimi po bëhet për dy arsye. E para është se duhet të merren parasysh interesat e 14 mijë banorëve të lagjes “Dardania 1 e 2”, që kërkojnë të mos u mbyllet rruga përmes kësaj hapësire dhe arsyeja e dytë është se brenda kësaj hapësire duhet të planifikohet edhe ndërtimi i shkollës së muzikës, që nuk ishte planifikuar në planin e vitit 2012.

Ndërkaq, propozim-vendimi për qasje në planet rregulluese “Lagja e Spitalit”, “Qendra 3” dhe “Zabeli 1”, për t’i harmonizuar ato me planifikimin hapësinor, duke thënë se në këto tri zona, diku kishte plane të vjetra, e diku nuk kishte fare, zgjoi më pak interesim te anëtarët e Kuvendit.

Përurohet shkolla në fshatin Kishnapole

31 korrik 2014



Anne Marx si dhe përfaqësues nga "Caritas" i Luksemburgut dhe MASHT-i.

Është përuar sot objekti i ri i shkollës fillore "Afërdita" në fshatin Kishnapole, e cila është bashkëfinancim i Komunës së Gjilanit, "Caritas"-it të Luksemburgut dhe qeverisë së Kosovës. Prerjen e shiritit e bëri kryetari i Komunës së Gjilanit Lutfi Haziri së bashku me kryesuesen e Kuvendit Komunal, Valentina Bunjaku Rexhepi, drejtorin e Arsimit, Nazmi Musa, sekretaren e parë të ambasadës së Luksemburgut në Kosovë, Marie-

Në fjalën e rastit, kryetari i Komunës së Gjilanit Lutfi Haziri ka falënderuar qeverinë e Luksemburgut për ndërtimin e kësaj shkolle si dhe për ndihmat tjera të rëndësishme. "Jam i nderuar që sot po e përurojmë njërin nga investimet më të mira. Populli mik i Luksemburgut dhe europianët e vjetër, kanë vendosur t'i ndihmojnë europianët e rinj", ka thënë Haziri, duke nënvizuar se banorët e Kishnapoles mund t'i gëzohen këtij investimi të madh. Kreu i Gjilanit tha se ky është një hap i madh për ta barazuar Kishnapolen me vendet tjera në Kosovë. "Natyrisht, ky është vetëm hapi i madh për ta barazuar Kishnapolen dhe popullatën e saj me vendet tjera në Kosovë, sepse kemi ngelur 20 vite prapa, si pasojë e moskujdesit dhe e problemeve të tjera. Me ndihmën e miqve, do ta arrijmë ta zhvillojmë këtë vend, këtë bukuri natyrore që vetëm Zoti e ka falë", tha Haziri. Sekretarja e parë e Ambasadës së Luksemburgut në Kosovë, Marie-Anne Marx, tha se investimi në ndërtimin e shkollës tregon për një bashkëpunim të mirë në mes të qeverisë së Luksemburgut dhe qeverisë së Kosovës dhe këtë bashkëpunim do ta vazhdojmë edhe në të ardhmen. "Edukimi nuk është vetëm një e drejt themelore, por është një bazë e fortë për një perspektivë më të madhe, prandaj projektet tona në Kosovë nuk janë orientuar rastësisht në këtë sektor", tha zonja Marie-Anne Marx. Këshilli i fshatit ndau mirënjohje kryetarit Haziri, "Caritasit", qeverisë së Luksemburgut si dhe Ministrisë së Arsimit.



Gjilani rikthen traditën e panaireve

2 gusht 2014

Në Gjilan është hapur Panairi regjional i produkteve vendore "Gjilani 2014", ku bizneset e regjionit po promovojnë produktet e tyre. Panairi organizohet nga drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe zgjat dy ditë.



Në fjalën e rastit, kryetari i Komunës së Gjilanit Lutfi Haziri ka falënderuar të gjithë ata që mbështeten këtë panair, duke shtuar se Gjilani po e rikthen Panagjyrin që e kishte shumë vite më parë, por tash me prodhime vendore, të cilat Gjilanin e bëjnë krenar. Komuna e Gjilanit është lidere në prodhim, sidomos në prodhime bujqësore, në industrinë e bujqësisë dhe meritore për këtë janë bizneset private, njerëzit që kanë arritur të plasojnë prodhimet e tyre në Bashkimin Europian, e deri në Afrikë. Më pas kryetari Haziri ka vizituar kompanitë e regjionit një nga një, duke parë nga afër produktet e tyre. Kreu i Gjilanit nuk ka harruar t'i



falënderoj edhe bashkatdhetarët që jetojnë në Europë e Amerikë që ishin prezent sot, me të cilët pohoi se ndihemi krenarë dhe për këta dy muaj sa qëndrojnë në Gjilan, janë vlera më e madhe që ne e kemi në komunën tonë. Ndërsa, drejtori për Zhvillim Ekonomik Ismail Januzi, ka falënderuar kryetarin Haziri për mbështetjen e madhe që i ka dhënë panairi regjional të produkteve vendore "Gjilani 2014" si dhe Bashkimin Europian, që përmes Qendrën Regjionale

të Marketingut - Lindje, ka qenë donatori kryesor i këtij evenimenti. “Panairi është organizuar për herë të parë me qëllim të promovimit të produkteve vendore. Produktet vendore kanë një rëndësi të madhe në zhvillimin ekonomik të regjionit, duke pasur parasysh edhe pjesën e madhe të bashkatdhetarëve tanë që punojnë në diasporë dhe qëllimi i këtij evenimenti është që të krijohet një urë lidhëse e bashkëpunimit mes të bizneseve dhe bashkatdhetarëve tanë që punojnë në diasporë”, ka thënë Januzi. Ai theksoi se ky panair pretendon të bëhet tradicional dhe në vitin që vjen të zgjerohet edhe me biznese nga Presheva, Bujanoci e Medvegja. Përndryshe, në panairin “Gjilani 2014” kanë marrë pjesë mbi 100 biznese.

Haziri: Mërgimtarët tanë janë vlerë kombëtare

3 gusht 2014

Kreu i Komunës së Gjilanit Lutfi Haziri gjatë muajit korrik ka pritur qindra mërgimtarë shqiptarë që jetojnë në Europë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës e gjetiu.



Në mesin e mërgimtarëve, kryetari Haziri ka takuar edhe zviceran, të cilët kanë ardhur për ta vizituar Gjilanin së bashku me shqiptarët. Kryetari Haziri gjatë këtyre takimeve i ka falënderuar qytetarët tanë që jetojnë në diasporë për kontributin e jashtëzakonshëm që kanë dhënë në zhvillimin e Gjilanit, Anamoravës dhe mbarë Kosovës. “Komuna e Gjilanit ndihet krenare me gurbetçarët tanë që jetojnë në Europë e Amerikë e kudo në botë. Për këta dy muaj sa qëndrojnë

në Gjilan, janë vlera më e madhe që ne e kemi në Komunën tonë. Falënderim përjetë për punën e madhe që e kanë bërë për zhvillimin e Komunës sonë”, ka thënë kryetari Haziri. I pari i Komunës së Gjilanit edhe në ditët në vijim do të pres në takim në zyrën e tij bashkatdhetarë të shumtë, të cilët i kanë sjellë veç të mira Komunës së sonë gjatë disa dekadave.

Komuna e Gjilanit shpërndan shtande moderne për t’i ndihmuar bujqit në promovimin dhe shitjen e produkteve vendore

7 gusht 2014



Drejtorja e Bujqësisë u ka shpërndarë sot bujqve të Gjilanit 12 shtande moderne në shfrytëzim, në disa pjesë të qytetit, për t’ju mundësuar që produktet e tyre t’i ekspozojnë në mënyrën më të mirë.

Drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë Ramiz Ramadani i ka vizituar shitësit e produkteve vendore dhe vlerësoi se në këtë mënyrë do të

ndikojë edhe më shumë në shitjen dhe ekspozimin e produkteve bujqësore dhe do të jetë edhe më higjienike.

“Ky hap është ndërmarrë me qëllim të ndihmesës në promovimin e produkteve bujqësore vendore për bujqit gjilanas dhe kjo besojmë shumë që do të ndikoj edhe në shitjen më të mirë dhe gjithashtu është edhe me higjienike se më parë. Ne gjithmonë do të jemi përkrah bujqve, duke i përkrahur dhe stimuluar me mundësitë dhe kapacitetet tona komunale”, ka thënë Ramadani.

Gjatë ditëve të tjera do të shpërndahen edhe të tjera shtange, varësisht nga kërkesat e qytetarëve.

Këto shtande janë përdorë në panairin regional të produkteve vendore “Gjilani 2014”, kanë karakter sezonal dhe në momentin që përfundon shitja, kthehen në drejtorinë përkatëse.

Haziri pret një grup fëmijësh shqiptarë që jetojnë në diasporë

9 gusht 2014

Në vazhden e takimeve të shumta me mërgimtarë, kryetari i Komunës së Gjilanit Lutfi Haziri ka pritur sot në zyrën e tij një grup fëmijësh shqiptarë nga të gjitha trojet shqiptare, të cilët jetojnë në Gjermani, Zvicër, Angli, Turqi dhe Greqi, të cilët i ka shoqëruar drejtoresha e qendrës kulturore për Zvicër, Shukrije Ramadani, në kuadër të Ministrisë së Diasporës.



Kryetari Haziri i ka uruar mirëseardhje fëmijëve, ndërsa i ka njoftuar ata me punën e tij si kryetar i Komunës së Gjilanit, me pozitën e mirë gjeografike të Anamoravës, në të cilën bëjnë edhe shtatë komuna të regjionit lindje. Haziri tha po ashtu theksoi se mbi 32 për qind e gjilanasve jetojnë në shtete të Europës, ku këta të fundit janë shumë të lidhur me familjet e tyre në Gjilan dhe se ndihmojnë jashtëzakonisht shumë në të gjitha aspektet. Fëmijët e pranishëm i bënë disa pyetje nga më të ndryshme kryetarit Haziri, të cilëve u është përgjigjur me kënaqësi. Nga ana e saj, zonja Shukrije Ramadani ka falënderuar kryetarin e Komunës së Gjilanit Lutfi Hazirin që edhe në këtë ditë pushimi ka gjetur kohë t'i pres e t'i nderoj fëmijët shqiptarë që jetojnë në shtete të ndryshme të Europës.

Sukseset e Xherdan Shaqirit shkojnë përtej futbollistëve tjerë

9 gusht 2014

Të shtunën në Gjilan është bërë publike nisma për shpalljen qytetar nderi të futbollistit kosovar me shtetësi zvicerane, Xherdan Shaqiri, i cili aktualisht luan në Bajern të Mynihut. Avdyl Aliu, shef i grupit të këshilltarëve komunalë (LDK), i cili e ka publikuar këtë nismë, të shtunën, në një konferencë me gazetarë, ka thënë se ylli i futbollit botëror, Xherdan Shaqiri, para disa ditësh u

zgjedh anëtar nderi i Këshillit lokal në Zhegër, ku e ka vendlindjen.

Kryetari i Komunës, Lutfi Haziri, e ka mirëpritur këtë vendim të Këshillit lokal, duke dhënë idenë që ky nder t'i bëhet edhe Gjilanit, duke e shpall Shaqirin qytetar nderi. Aliu ka thënë se nisma, në emër të grupit të këshilltarëve të LDK-së, është prezantuar edhe para anëtarëve të Kuvendit Komunal, më 30 korrik dhe ka marrë 27 nënshkrime, nga 35 sish gjithsej. Të tjerët kanë kërkuar kohë, për të marrë mendim e subjektit të cilit i përkasin. Motivacion kryesor për shpalljen e Shaqirit qytetar nderi janë sukseset e tij në futboll, që shkojnë përtej çdo futbollisti tjetër shqiptar. Xherdani shkëlqeu në botërorin 2014, ku u rendit në mesin e futbollistëve më të mirë në botë, krahas Messit dhe të tjerëve. Aliu tha se pret që Xherdan Shaqiri do të jetë vetë i pranishëm në Gjilan, kur t'i akordohet titulli 'qytetar nderi', titull ky që deri tani e kanë marrë studiuesi Mehemt Halimi dhe ish-senatori amerikan Bob Dol.

Pozitë e opozitë në terren, impresionohen me punimet në infrastrukturë në brezin kufitar

Gjilan, 12 gusht 2014 - "Ishim t'paketuem, si në gjendje lufte kur pret naj dëbim prej fshatit, për me u shpërngulë".

Kështu e nisë rrëfimin e jetës së rëndë Pajazit Zahiri nga lagjja e Zahirajve të fshatit Sllubicë të Komunës së Gjilanit.

Arsyeja që i ka shtyrë banorët ta braktisin fshatin, ka qenë mungesa e një rruge të kalueshme.

Sot, kjo rrugë po ndërtohet nga Komuna e Gjilanit, nën udhëheqjen e Lutfi Hazirit. E, Pajaziti menjëherë ka ndërruar mendje.

"Rruga që ka fillu prej lagjes së Bishtajve dhe po vazhdon në lagjen e Zahirajve asht një punë shumë e madhe sepse na banorët e asaj lagje ishim shumë afër shpërnguljes. Ishim të pregaditun për cdo cast ta lëshojmë atë pjesë shkaku i mungesës së rrugës. Me fillimin e kësaj rruge, ne jemi të vendosur që të rrimë këtu dhe besoj që edhe banorët tjerët do të kthehen për të jetu. E falënderoj kryetarin Lutfi Haziri, drejtorin Sokol Haziri dhe të tjerët që po na e rregullojnë rrugën", thotë Pajaziti.

Kur u pyet se a ka pasur vizita më herët, ai e dha këtë përgjigje: "Në këtë fshat ma herët s'kemi pasë kurrë asnjë vizitë".

Në fushatën e fundit elektorale, kryetari i Komunës së Gjilanit Lutfi Haziri u pat premtuar banorëve të brezit kufitar me Serbinë që do t'ua rregulloj infrastrukturën rrugore në vitin e parë të qeverisjes. Tashmë, kjo u bë realitet.

Për t'i parë nga afër punimet e rrugëve të rendit tretë në: Kokajt e Erpërm, Kokajt e Poshtëm, Sllubicë e Epërme, Sllubicë e Poshtme, lagja e Zahirajve, lagjja e Bishtajve, Kacabaç, Pogragjë e Bilinicë, në vendin e ngjarjes ka dalë drejtori i Shërbimeve Publike Sokol Haziri së bashku me Komitetin për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Emergjencë: Isa Agushi – kryesues, Ramadan Ajvazi (LDK), Ilir Tahiri (PDK) dhe Krenare Latifi – Kqiku (VV).

Pozitë e opozitë jashtë shprehur të impresionuar me punët e mira që janë bërë në ndërtimin e rrugëve të këtyre fshatrave të brezit kufitar.

Drejtori Sokol Haziri tha se ka qenë iniciativë e tij që të dalin së bashku në terren dhe ka falënderuar Komitetin për Shërbime Publike për mbështetjen e madhe.

Planifikim dhe strategji e kryetarit Haziri është që zonave kufitare t'i japim përparësi

“Sot kam prezantuar programin e punës gjashtëmujore të Drejtorisë për Shërbime Publike në Komitetin përkatës. Për të bërë një praktikë të re, kam kërkuar që të gjithë së bashku të dalim dhe t'i shohim një pjesë të punimeve në terren, në rrugët e rendit të tretë. Planifikim dhe strategji e kryetarit Haziri është që zonave kufitare t'i japim përparësi në kuptim të infrastrukturës dhe ky është hapi i parë. I falënderoj të gjithë anëtarët e Komitetit që më mbështetën dhe erdhën bashkë për këtë vizitë”, tha drejtori Sokol Haziri.

“Është ngjallur jeta për këta banorë të cilët kanë vuajtur me shekuj”

Nga ana e tij, kryesuesi i Komitetit të Shërbimeve Publike Isa Agushi tha se në këtë zonë janë thyer kodra e gurë dhe u është mundësuar banorëve të jetojnë dinjitetshëm.

“Së bashku me anëtarët e Komitetit për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, kemi dalë në vendin e ngjarjes për të parë punimet që është duke i kryer Komuna në këto rrugë, që me të vërtetë janë thyer kodra e gurë dhe kanë qenë me një fjalë rrugë që banorët kalonin me kafshë e me qerre, ndërsa sot po kalojnë me vetura. Po shihet që është ngjallur jeta për këta banorë të cilët kanë vuajtur me shekuj”, tha Isa Agushi.



“PDK do të mbështes gjithmonë punët e mira të Komunës”

Ilir Tahiri nga Partia Demokratike e Kosovës theksoi se në këtë pjesë janë bërë punë të mira nga ana e Komunës dhe gjithmonë do të mbështeten punët e mira edhe në të ardhmen.

“Partia Demokratike e Kosovës gjithmonë do t’i mbështes punët e mira dhe e falënderojmë iniciativën e drejtorit Sokol Haziri. Vazhdimisht, edhe si Komitet edhe si PDK do t’i qëndrojmë prapa aty ku e ka mirë”, ka thënë Tahiri.

VV: Shihet një punë e mirë në ndërtimin e rrugëve në këtë zonë

E impresionuar me atë që ka parë në terren është shprehur të jetë edhe Krenare Latifi – Kqiku nga Lëvizja Vetëvendosje.

“Ne si Lëvizje Vetëvendosje e mbështesim iniciativën e drejtorit të Shërbimeve Publike që së bashku të dalim në terren. Shihet se është bërë një punë e mirë në rregullimin e rrugëve në këtë zonë. Jam e kënaqur me fillimin e punëve dhe gjithçka që është në të mirë të qytetarëve dhe në interes të qytetarëve ne do ta mbështesim”, është shprehur Latifi – Kqiku.

“80 për qind e banorëve të Kokajve ka me u kthye prej qytetit me jetu këtu”

Se është ngjallur jeta në këto fshatra, e konfirmuan edhe banorët tjerë të cilët folën në superlativ për punët dhe falënderuar kryetarin Haziri dhe drejtorin Sokol Haziri.

“Qysh asht tu shku puna tash që na e ndërtuen rrugën, jam i bindun që 80 e e banorëve të Kokajve ka me u kthye prej qytetit me jetu këtu. Prioriteti i parë ka qenë rruga se pa rrugë s’ki kurgja. Tash prej se asht ndërtue rruga 7-8 shtëpi janë tu u ndërtue dhe ndër të parën që jam kthi këtu jam unë, i kemi edhe disa kusheri të tjerë...N’katund i ke kafshët, ushqimin e siguron vetë, jetojmë shumë ma mirë se n’qytet”, tha Bashkim Dauti nga fshati Kokaj e Epërm.

“E kam pas vendos që nëse s’bahet rruga deri n’shtator me u shpërngulë prej këtu. Tash që u ba, jam shumë i kënaqun, e falënderoj kryetarin Haziri dhe të tjerët që na e mundësuen. Tash po marrë frymë lirshëm ka fillu një gjallni dhe nuk mendoj fare të shpërngulem”, ka deklaruar Shabi Halili nga fshati Kokajt e Poshtëm, i cili ka një miniferme prej 10 krerë lopësh, me synime për ta zhvilluar edhe më shumë këtë veprimtari.

Tash e tutje, Pajazit Zahiri nga lagja e Zahirajve të Sllubicës do të vazhdoj me qetësi të funksionoj në sektorin e bujqësisë dhe blegtorisë, duke kultivuar mbi 200 krerë dele sa i ka, sikurse edhe banorët e fshatrave të tjerë nga ajo zonë.

Largohen gropat, pluhuri dhe degradimi edhe në rrugën “Agim Rashiti”

Gjilan, 28 gusht / Qytetarët e lagjes “Dheu i Bardhë” kishin festë këtyre ditëve. Atyre u është larguar bezdia nga gropat, pluhuri dhe degradimi total në rrugën “Agim Rashiti”, sepse ajo tashmë është asfaltuar dhe ka ndryshuar pamjen e kësaj lagjeje, por edhe vlerën dhe jetën në këtë pjesë.

Poashtu krahas kësaj rruge janë duke u punuar edhe 11 rrugica të tjera në këtë lagje të cilat do të përmbyllen në afatet e parapara me kontratë sikur që ka përfunduar konform parashikimeve edhe rruga në fjalë.

Nevzad Rushiti këshilltarë komunal dhe banor nga kjo lagje ka thënë se atje ka qenë një festë e vërtet dhe emocion për banorët kur ky projekt është përfunduar.

“Një rrugë që kishte cilindo emër përpos rrugës, sot është rregulluar me standardet më të mira si në aspektin e kualitetit të punimeve ashtu edhe në funksionin për kalimtarët që ka. Është rrugë me një gjatësi 300 metra dhe me një gjerësi 5.5 metra, kjo rrugë tani posedon edhe trotuarin dhe gjithë infrastrukturën tjetër përcjellëse. Trashësia e kësaj rrugë është standarde dhe ka dy shtresa të asfaltit”, ka thënë ai duke shtuar se falë mbështetjes dhe angazhimit të kryetarit Haziri, kjo po bëhet atje dhe ata qytetarë po e prekin dorën e qeverisjes, e cila është proklamuar që nga fillimi se do të jetë vetëm në shërbim të qytetarëve.

“Me këtë intensitet të punimeve që jemi duke punuar, mundem lirisht të them se edhe rrugicat e tjera së shpejti do të përfundohen dhe ajo lagje do të bëhet vërtet lagje me infrastrukturën të cilën



e ka merituar kaheerë, ka shtuar ai, duke spikatur edhe nevoja të tjera për të cilat ka thënë se së bashku kryetarin e Komunës z. Haziri dhe me drejtorin e Drejtorisë për Shërbime Publike i kanë vënë në prioritet të realizimit pas këtyre projekteve.

Rushiti ka thënë se jemi të bashkuar të gjithë në qeverisje për të bërë punë të cilat do ta lehtësojnë jetën e qytetarit tonë.

Premtimi për katërshen e madhe të kryetarit Haziri, tashmë qytetarët po e prekin si në asfaltime, ujësjellës, kanalizime dhe trotuar e ndriçim publik.

Nis ndërrimi i gypit kryesor të ujësjellësit

4 shtator 2014



Ka nisur ndërrimi i gypit kryesor të ujësjellësit nga Fabrika e baterive e deri në qendër të qytetit, që është financim i Ministrisë së Zhvillimit Ekono-mik në bashkëpunim me Komunën e Gji-lanit dhe kompaninë “Hidromorava” që kap vlerën e afro 200 mijë eurove.

Kryetari i Komunës së Gjilanit Lutfi Haziri tha se ndërrimi i gypit është njëra nga projektet në interes të zhvillimit të infrastrukturës bazike e që i paraprinë zgjerimit të rrugës së hyrjes Gjilan-Bujanoc. “Jam jashtëzakonisht i gëzuar që sot po fillojmë këtë projekt, i cili financohet nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Komuna e Gjilanit dhe kompania rajonale “Hidromorava”. Programi i vendosjes së gypit kryesor të ujit i paraprinë ndërtimit dhe zgjerimit të rrugës hyrje Gjilan-Bujanoc”, ka thënë Haziri. Drejtori i Zhvillimit Ekonomik Ismail Januzi tha se ndërrimi i këtij gypi parandalon humbjet e mëdha të ujit. “Komuna e Gjilanit në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik janë identifikuar problemet që ka ujësjellësi në Komunën e Gjilanit sidomos për të parandaluar humbjet e mëdha që janë shkaktuar nga gypat e vjetruar të asbestit”, ka deklaruar Januzi.

Haziri: Nuk do t'i tolerojmë vonesat

6 shtator 2014

Në disa sektorë po vazhdojnë punimet në përmbushjen e nevojave të qytetarëve. Për t'i parë se si po zhvillohen punimet në sektorin e shëndetësisë, arsimit dhe infrastrukturës rrugore, në terren ka dalë edhe kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, së bashku me drejtorët komunalë, ndonëse ishte ditë vikendi. Haziri me bashkëpunëtorë, së pari ka vizituar Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, e cila është në prag të përfundimit të renovimit të objektit. Drejtori QKMF-së, Fejzullah Berisha, tha se pos këtij objekti, do të renovohet edhe ai në lagjen “Arbëria”, për të

vazhduar me objektet tjera ku ka nevojë urgjente për interevenim. Më pas kryetari i Gjilanit ka vizituar punimet në rrjetin e ujërave atmosferik në lagjen e “Zabelit”, projekt ky që është në përfundim dhe që më nuk do të paraqitet problem për qytetarët e kësaj lagjeje kur ka reshje të shiut. Haziri ka vizituar, po ashtu, edhe punimet në sinjalizimin vertikal dhe horizontal në lagjen “Dardania”, ku po ndërtohen edhe shtegjet për biçiklistë dhe për herë të parë do të krijohen hapësira edhe për personat me nevoja të veçanta, duke i bërë të barabartë ata në lëvizje me qytetarët tjerë. Kryetari Haziri është ndarë i kënaqur me cilësinë e punëve që ka parë në vizitat e sotme, ndërsa tha se do të vazhdohet me këtë dinamikë në lagjet e qytetit dhe në fshatra. Haziri tha se nuk do të tolerohen në asnjë mënyrë vonesat nga operatorët, për të cilët tha se nëse nuk i kryejnë punët në afatin e paraparë me kontratë, do të sanksionohen. Kryetari Haziri ka përfunduar vizitat në shkollën fillore “Mulla Idriz Gjilani”, ku komuna e Gjilanit është dukendërtuar terrenin sportiv.

Vihet themeli i objektit të Qendrës Rinore në Gjilan

8 shtator 2014

Kryetari i Komunës së Gjilanit Lutfi Haziri, së bashku me ministrin në detyrë të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Memli Krasniqi, drejtorin e DKRS-së, Bujar Haziri, deputetët Lirije Kajtazi e Zenun Pajaziti dhe zyrtar të tjerë, kanë vënë themelin e shtëpisë për rininë e Gjilanit, objekt i cili do t'i plotësoj të gjitha kushtet për aktivitetet e rinisë. Parashihet të kushtoj rreth 250 mijë euro, ndërsa punimet parashihet të përfundojnë vitin e ardhshëm.



Me këtë rast kryetari i Komunës, Lutfi Haziri, ka falënderuar ministrin Krasniqi për angazhimin, përpjekjet dhe fillimin e punimeve për ndërtimin e objektit për rininë që është një investim kapital që po ndodhë në sektorin e rinisë në Gjilan. “Rinisë gjilanase sot po i vjen një investim kapital. Është fjala për këtë projekt të ndërtimit të objektit ku do të kyçen rinia, Shoqatat, Këshilli i Veprimit Rinor Lokal, organizata të tjera të

rinisë që përfshinë studentë dhe nxënës, do të kenë mundësi jashtëzakonisht të mira që në objektin e vet me zhvillu aktivitetin e rinisë dhe me zbatu pjesën edhe të ligjit që lidhet me të drejtat dhe me avancimin e rinisë në përgjithësi”, ka thënë kryetari Haziri, duke informuar ministrin edhe për Qendrën e Trashëgimisë Kulturore respektivisht projektet që kanë filluar të

ndërtohen, Teatrit dhe angazhimeve që duhet t'i bëjmë në të ardhmen lidhur me Teatrin e qytetit dhe jetën kulturore në përgjithësi në Gjiilan. Ndërsa nga ana e tij Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Memli Krasniqi, ka thënë se kjo është ditë e veçantë për një projekt që sot po nisë e i cili do të jetë një shtëpi e të rinjve të Gjiilanit për të avancuar idetë dhe përgatitjet e tyre për të mirën e Gjiilanit.

Bunjaku – Rexhepi, buxhetin për vitin 2015 do ta bëjmë bashkë me qytetarët

13 shtator 2014



Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Gjiilanit së bashku me Komitetin për Politikë dhe Financa, Drejtorinë për Buxhet dhe Financa dhe këshilltarët komunal nga kjo anë, kanë mbajtur sot debat me qytetar për planifikimin e buxhetit të vitit 2015.

Në këtë takim është prezantuar draft buxheti për vitin 2015, të cilin e ka planifikuar Komuna e Gjiilanit, duke informuar banorët nga kjo anë me planifikimin e investimeve pikë për të cilën ishin më të interesuar të pranishmit në këtë dëgjim publik. Me këtë rast kryesuesja e Kuvendit Valentina Bunjaku – Rexhepi, ka thënë se pas konsultave me drejtorët, pas propozimeve të dhëna nga ta, pastaj pas draftit të parë dhe pas dëgjimit publik në sallën e Kuvendit të Komunës, kanë vendosur që debate me qytetarë të mbahen edhe në fshatra të ndryshme të Gjiilanit, në mënyrë që planifikimi të jetë më i drejtë dhe në raport me kërkesat emergjente të qytetarëve për infrastrukturë publike. “Ne kemi vendosur që pas draftit të parë, të hartuar nga Komuna e Gjiilanit, dhe pas dëgjimit publik, të mbajmë edhe debate të tjera me qytetarë në fshatra të ndryshme në mënyrë që buxheti i miratuar më pas në Kuvendin e Komunës të jetë sa më afër kërkesave të qytetarëve. Për herë të parë po mbajmë debate me qytetarë nëpër fshatra. Këtë po e bëjmë për arsye se ju jeni ata të cilët e akumuloni buxhetin e Komunës përmes pagesës së taksave komunale. Prioritet në buxhetin e vitit 2015 ne i kemi dhënë katërshejës së madhe të premtuar nga kryetari Haziri, e që janë: rrugët, kanalizimi, ujësjellësi dhe trotuar e ndriçim publik”, tha ajo ndër të tjerash. Ndërsa Ilmi Limoni, zyrtar kryesor financiar dhe U.D. i drejtorit të Financave, ka dhënë detajet e buxhetit për vitin 2015. Ai ka spikatur kodin për investime kapitale, planifikimin për buxhetin në arsim, shëndetësi, mallra dhe shërbime, komunalit etj. E në anën tjetër disa nga qytetarët si: Nezir Neziri, Sokol Godeni, Ruhan Kurteshi etj, kanë



parashtruar kërkesat që sipas tyre janë emergjente të investohen si, trotuari, asfaltimi i disa rrugëve brenda fshatit, asfaltimin e rrugës magjistrale, trafostacion për fshatin Goden, pastaj kërkesë për një shkollë në fshatin Haxhaj, sallën e sporteve për shkollën “Agim Ramadani”, por edhe largimin e deponive të egra brenda dhe jashtë zhegrës. Këto kërkesa kryesuesja e Kuvendit ka thënë se do të shqyrtohen me kujdes dhe do të inkorporohen në buxhetin e vitit 2015. Ajo tha se

një pjesë prej tyre tashmë nga ekzekutivi i Komunës janë planifikuar siç është trotuari, kanalizimi, disa investime në fshatrat tjera afër Zhegrës por edhe disa rrugica të kësaj ane. Kontributin e tyre e kanë dhënë edhe Abdyl Aliu, shef i këshilltarëve të LDK-së, Isa Agushi e Jehona Hyseni, këshilltarë komunal nga kjo anë të cilët kanë mbështetur qytetarët në kërkesat e tyre.

Po e realizojmë me shumë sukses programin bujqësor

20 shtator 2014

Komuna e Gjilanit është duke i hapur rrugët e arave në fshatin Llashticë, Zhegër, e Lladovë, duke i shtruar me zhavor për t’ju krijuar kushte shumë të më të favorshme bujqve.

Lutfi Haziri, kryetar i Komunës së Gjilanit, i cilin shoqërohej nga drejtorët komunal, është ndarë shumë i kënaqur me cilësinë e punimeve atje, duke thënë se ky projekt po realizohet me sukses në kuadër të programit bujqësor, që është prioritet i Komunës.

“Po i hapim rrugët e arave në fshatra, në kuadër të programit të bujqësisë. Të gjitha rrugët e arave do t’i hapim. Kemi filluar programin në Llashticë, Lladovë dhe Zhegër, në mënyrë që edhe programi ynë bujqësor të lidhet me infrastrukturën, dhe njerëzit të fillojnë ta punojnë tokën dhe subvencionet e Komunës të shkojnë në vendin e duhur. Ky është damari kryesorë i jetës dhe është obligim qytetar t’i kryejmë këto punë”, ka thënë kryetari Haziri.

Nga ana e tij, drejtori i Bujqësisë, Ramiz Ramadani, tha se me anë të shtrimit të rrugëve të arave me zhavor, përpos kulturave lavértare, po pretendojmë t’ju krijojmë mundësi kultivimi edhe për kulturat intensive perimore.

“Me anë të shtrimit të rrugëve të arave me zhavor, përpos kulturave lavërtare, po pretendojmë t’ju krijojmë mundësi edhe kulturave intensive perimore. Dua ta falënderoj shumë kryetarin Lutfi Haziri për mbështetjen e madhe që po ia jep sektorit të bujqësisë, e në veçanti këtij projekti. Ky projekt do të vazhdoj edhe në të ardhmen që do t’i përfshijë të gjitha fshatrat e Komunës së Gjilanit”, tha drejtori Ramiz Ramadani.

Më të gëzuarit nga ky projekt i Komunës ishin banorët e Llashticës, të cilët falënderuan kryetarin Haziri që po ua rregullon këto rrugë, për të cilat thanë se do ta kenë shumë të lehtë ta punojnë tokën e tyre. Ky është projekti i parë i kësaj natyre në nivel Kosove. Ky projekt e përfshin Llashticën, Lladovën dhe Zhegrën, me gjatësi rreth 15 kilometra dhe përfshinë mbi 481 hektarë tokë, ndërsa vlera e investimeve është mbi 47 mijë euro.

Haziri e hap konferencën e parë shkencore regjionale

20 shtator 2014

Kryetari i Komunës së Gjilanit Lutfi Haziri ka hapur sot konferencën e parë Shkencore Regjionale (Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, Serbi, Mali i Zi) me temën: “E drejta dhe kultura politike si faktor ndikues në ndërtimin e shtetit modern”, e cila organizohet nga Instituti për studime ligjore dhe demokratike.

Në fjalën e hapjes, kryetari Haziri u shpreh se kjo është një mundësi e madhe e bashkëpunimit, përmes gjetjes së rrugëve dhe formave t’i largojmë të gjitha pengesat në qarkullimin e lirë të qytetarëve tanë e të mallrave. “Ju lus që gjatë kësaj konference të angazhoheni, të punoni, t’i ndani të gjitha mendimet e kërkesat sepse Gjilani është në një pikë interesante nëse e shohim hartën e Kosovës të Vjenës, në trekëndëshin kufitar që njihet si ‘këmba e pulës’. Kjo është një mundësi e madhe që përveç bashkëpunimit dhe përmes veprimit të aktiviteteve të përbashkëta, përmes gjetjes së rrugëve dhe formave, të adaptojmë një mundësi krejt tjetër që të bashkëpunojmë dhe t’i largojmë të gjitha pengesat që edhe sot njihen dhe i prekin qytetarët tanë në qarkullimin e lirë të njerëzve, në qarkullimin e lirë të mallrave etj”, tha kryetari Haziri. Haziri ka theksuar se “Ka më shumë se një dekadë që punojmë 17 kryetar të komunave të regjionit në mënyrë që të realizojnë aktivitete agjenda, forma, jo vetëm arsimi e kultura si dy sektorët domosdoshmërisht duhet të bashkëpunojnë, por edhe rrugë e sektore të tjera në mënyrë që të gjenden rrugë të largohen këto pengesa që kjo pjesë i njeh dhe i ka paguar shumë shtrenjtë”. Kreu i Gjilanit ka thënë se sivjet është 70 vjetori i masakrës së madhe të Gjilanit, ku pësuan më shumë se 60 për qind e popullatës. “Po e përmendi vetëm sa për dëshmi që sivjet është 70-vjetori i masakrës së madhe të Gjilanit, ku me 21 dhe 22 dhjetor ka përgjysmuar mbi 60 për qind të popullatës dhe mbi 60 për qind të njerëzve të moshës madhore janë vrarë. Sot e asaj dite shumica prej të vrarve nuk dihen ku janë. Kjejt kjo është bërë për territore, që sot e kemi si pjesë të

angazhimeve tona të përbashkëta. Pres me padurim t'i shoh konkluzionet e kësaj konference", ka thënë kryetari Haziri. Në këtë konferencë do të paraqiten me punime e fjalë përshëndetëse edhe Nazmi Maliqi, Arben Dërmaku, Nagip Arifi, Sokol Haliti, Elez Osmani, Arsim Sinani dhe Flamur Hyseni. Konferenca, e cila ka nisur sot në ora 10:00 përfundon në ora 18:00.

Kuvendi Komunal i Gjilanit kërkon barazi buxhetore me komunat tjera

29 shtator 2014

Kuvendi Komunal i Gjilanit, ka mbajtur seancën e radhës, ku fillimisht ka votuar për shtyrjen e ndryshimeve të statutit të Komunës për një seancë të veçantë. Valentina Bunjaku-Rexhepi, kryesuese e Kuvendit Komunal, ka thënë se është e nevojshme të bëhen edhe disa harmonizime në variantin final të projekt-statutit. Sipas opozitës (PDK), e cila paraprakisht ka kundërshtuar shuarjen e dy drejtorive, siç është propozuar nga komisioni statutar, shtyrja u bë për shkak se pozita nuk i kishte të sigurt votat e mjaftueshme për të miratuar ndryshimet në statut.



KK miratoi edhe buxhetin për vitin 2015 dhe vlerësimet e hershme për vitet 2016-2017, rregulloren për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2015, planin komunal për efikasitet të energjisë, vendimin për qasje në revidimin e planit rregullues "Qendra 4", lejimin e këmbimit të një prone komunale me një prone private në lagjen "Zabeli" për nevoja të rrugës publike, disa pika tjera të tjera, si dhe u njoftua me Raportin e Auditimit për

vitin e kaluar. Lutfi Haziri, kryetar i Komunës, ka thënë se Komuna e Gjilanit, po mundohet ta bëjë punën e saj në përputhje me ligjin. "Unë jam i interesuar që Kuvendi Komunal të jetë organi më i lartë vendimmarrës e jo Zyra e Kryetarit", ka thënë Haziri. Sa i përket mos pjesëmarrjes së tij në takimet e komiteteve, Haziri ka thënë se ai nuk është i interesuar që të ndikojë në asnjë mënyrë në vendimmarrje, prandaj i kanë lënë trupat komunale që të punojnë në mënyrë të pavarur. Kuvendi ka miratuar edhe rregulloren për tatimin në pronë, të cilin e ka arsyetuar Ilmi Limoni, drejtor financiar. Ai ka thënë se për vitin 2015 është paraparë një zbritje e bazës tatimore, megjë norma tatimore nuk mund të ndryshohet sepse është e përcaktuar nga niveli qendror.

Kufijtë buxhetorë të përcaktuar nga qeveria janë ‘këpucë të ngushta’ për qytetarët e Gjilanit

29 shtator 2014

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, i është përgjigjur të gjitha pyetjeve dhe kërkesave të këshilltarëve Komunal, kryesisht nga ana e opozitës (PDK-së), në mbledhjen e dhjetë të radhës për vitin 2014.



Në fjalën e tij para këshilltarëve komunal, kreu i Gjilanit Lutfi Haziri tha se Administrata e Komunës së Gjilanit është duke i kryer punët sipas ligjeve në fuqi dhe vendimeve të Kuvendit Komunal. Haziri ritheksoi se ky mandat dhe kjo administratë është e interesuar që Kuvendi Komunal të jetë organi vendimmarrës në Komunën e Gjilanit, e jo Zyra e kryetarit dhe zyret tjera cfarë ka ndodhur më herët.

Duke arsyetuar idenë e tij që të dekoncentrohet Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport nga varshmëria e kryetarit të Komunës, kryetari Haziri tha se këta sektorë kështu sic kanë funksionuar deri tash, janë të varur totalisht nga subvencionet që i ndanë Komuna dhe se duhet të gjendet mënyra të pavarësohen financiarisht, t’u ndahet buxhet me kohë dhe të jenë funksionale. Haziri theksoi se po i përmbushë të gjitha premtimet e tij dhënë qytetarëve të Gjilanit dhe në vitin e parë tashmë po ulet baza e tatimit në pronë. “Në asnjë vend nuk ka Komunë të pasur, duke i varfëruar qytetarët. Në asnjë vend nuk ka logjikë të mendohet mbushja e arkës së Kuvendit Komunal, duke i tatimuar qytetarët, të cilët nuk kanë mundësi të paguajnë. Grumbullimi i borxheve për vitet e kaluara për tatim në pronë është aq i lartë që tregon pamundësinë e njerëzve për të paguar për shkak të ngarkesës. Ne kemi punuar në formulën tonë, e cila ka nxjerrë uljen e bazës tatimore. Do të punojmë me qeverinë, cila do që është në të ardhmen që të ulet edhe vlera e tatimit në pronë”, tha Haziri. “Duhet të gjendet gjithmonë interesi i përbashkët, duke mos e dëmtuar në asnjë rast palën, qoftë ajo ekonomi familjare, apo veprimtari biznesore. Edhe vendimi i ish-kryetarit do të shqyrtohet për të gjitha kategoritë, ku thotë që “nëse e paguan 50 për qind të vlerës së tatimit, do të lejohet shfrytëzimi i drejtave që janë”. Ne jemi të interesuar ta ulim, në mënyrë që qytetari vetë me pagu dhe mos me pasë nevojë për kushtëzime. Në çdo vit fiskal do të ketë ulje, jo vetëm viti 2015. Do të punojmë menjëherë

për vitin 2016 dhe do të punojmë edhe me organet shtetërore që edhe normën ta ulim sepse është e pamundshme të përballohet për disa kategori. Ngritja e tatimit është bërë 100 për qind për një vit dhe kjo është e papërballueshme. Nuk e kam ndërmend të ndërmarrë asnjë masë tjetër për qytetarët e Gjilanit, pos t'i lus ta paguajnë borxhin për tatimin në pronë sepse e kanë obligim qytetar. Sa i përket familjeve të dëshmorëve dhe kategorive të tjera, ne e kemi konsideruar edhe mundësinë që t'i lirojmë dhe të krijojmë barazi", ka shtuar Haziri. I pari i Komunës së Gjilanit ka theksuar se kufijtë buxhetorë që Ministria e Financave i ka përcaktuar për Komunën e Gjilanit janë të përballueshme, duke i cilësuar si "këpucë të ngushta për qytetarët e Gjilanit". "Këta kufij buxhetor të përcaktuar nga Ministria e Financave nuk janë të përballueshme dhe të nevojshme dhe janë 'këpucë të ngushta për qytetarët e Gjilanit'. Fjalën tonë për sa i përket buxhetit e ka prerë kjo qeveri. I ka hequr më shumë se 4 milionë prej buxhetit. Ne nuk kemi lypë mjete shtesë nga qeveria, e as dëmshpërblim, por kemi thënë që Gjilanit i duhen minimalisht edhe mbi 4 milionë, në mënyrë që vitin 2015 ta përballojmë shkaku i borxheve, ndërsa në vitin 2016 një rritje graduale. Në këtë mënyrë, do të normalizohej buxheti me kërkesat e Gjilanit. Por, kush është kjo qeveri që edhe në dorëheqje tash, që prenë fjalët e Kuvendeve Komunale?", ka vlerësuar kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri.

20 milionë franga do të investohen në regjionin e Gjilanit në rrjetin e ujësjellësit

30 shtator 2014

20 milion franga do të investohen në rrjetin e ujësjellësit në regjionin e Gjilanit, për ndërtimin e rrjeteve të reja, rehabilitimin e rrjeteve ekzistuese dhe në fusha të tjera për të siguruar ujë të pijes për qytetarët e kësaj ane, përmes investimeve të përbashkëta nga qeveria e Zvicrës dhe qeveria e Kosovës duke bashkëpunuar ngushtë me Komunat që preken me këtë program në këtë regjion.

Në takimin e përbashkët të kryetarëve të Komunave ku kanë marrë pjesë kryetari i Gjilanit, Kamenicës dhe Parteshit dhe udhëheqësi i këtij programi në CDI, z. Alan Broën, i cili ka konfirmuar dhe elaboruar programin në përgjithësi duke spikatur bashkëpunimin e domosdoshëm dhe mbështetjen e Komunave dhe të Institutit të Shëndetit Publik me qëllimin që të punojmë nëpërmjet Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Hidromorava". "Ky projekt financohet nga qeveria e Kosovës dhe qeveria Zvicerane dhe kap shumën rreth 20 milion franga zvicerane. Qëllim i këtij takimi është të nisen procedurat për fillimin e projektit për rehabilitimin e ujësjellësve rural që ekzistojnë në regjionin e Gjilanit e që nuk menaxhohen nga kompania regjionale e ujësjellësit. Ky program implementohet nga DOSH që është kompani gjermane dhe CDI organizatë joqeveritare vendore. Programi përmban disa aspekte të mbështetjes së sektorit të

ujit në Kosovë, ku çështja e parë është ndërtimi i rrjeteve të reja të ujësjellësit në zonat rurale, komponenta e dytë është rehabilitimi i sistemeve ekzistuese dhe e treta është ndërtimi i dy – tri sistemeve për trajtimin e ujërave të zeza. Aspekt kyç i programit është themelimi i një njësie implementuese të projektit brenda Kompanisë

Rajonale të Ujësjellësit e cila do ta implementoj komponentin e programit atë të rehabilitimit



rrjeteve të ujësjellësve ekzistuese në zonat rurale, duke përfshirë edhe komunat të cilat momentalisht nuk menaxhohen nga Kompania Rajonale e Ujësjellësit si dhe vlerësimin e të gjitha sistemeve ekzistuese në rajonin e Gjilanit”, ka thënë ai. Me këtë rast kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, ka thënë se ky investim është shumë i mirëpritur nga të gjitha komunat e përfshira në këtë projekt në regjionin e Gjilanit për

shkak të rëndësisë së madhe dhe jetike që është për qytetarët.

Ai ka spikatur edhe disa projekte të realizuara më parë e të cilat janë jashtë funksionit për shkaqe teknike e të cilat me një intervenim të paraparë, përmes këtij projekti do të bëhen aktive dhe në shërbim të qytetarëve.

Kryetari Haziri ka ofruar bashkëpunimin maksimal të Komunës së Gjilanit në mënyrë që ujësjellësit ekzistuese të aktivizohen por edhe në disa lagje apo fshatra të shikohet mundësia e investimit të rrjeteve të reja.

Nga ana e tij kryetari i Kamenicës, Begzad Sinani, ka ofruar po ashtu bashkëpunimin e Komunës duke kërkuar që sa më parë ky projekt të nisë dhe qytetarët të furnizohen me ujë të pijes si një element kryesor për jetën e njeriut.

Ndryshe, ky projekt qëllim ka ndërtimin e rrjeteve të reja të ujësjellësit në zonat rurale, komponenta e dytë është rehabilitimi i sistemeve ekzistuese dhe e treta është ndërtimi i dy – tri sistemeve për trajtimin e ujërave të zeza por edhe mbështetja e kompanive të ujit në nivel vendi në disa fusha si në aspektin e operimit dhe mirëmbajtjes së sistemeve të ujësjellësit, në aspektin e zvogëlimit të humbjeve të ujit, në aspektin e mbrojtjes së resurseve të ujit si në zhvillimin dhe koordinimit me kompanitë tjera në rajon.

“Heronjtë e vegjël dëshmojnë se si duhet të kujdesemi për njerëzit në nevojë”

2 tetor 2014



Nxënësit e shkollës fillore “Abaz Ajeti” në Gjilan kanë ndërmarrë një iniciativë të emërtuar “Duart e Vogla Ndhmojnë” për të mbledhur të holla për ndihmë për familjet në nevojë.

Këta fëmijë i ka takuar sot kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, i cili ka thënë se ky është shembulli më i mirë se si duhet të kujdesemi për njerëzit që kanë nevojë. “Kjo iniciativë e “Duart të vogla Ndhmojnë”, e ndihmës së vogël por me zemër të madhe, bënë që këta fëmijë të tregojnë zemërgjerësinë dhe zemërbardhësinë e gjilanasve. Duke qenë qytetarë të dinjitetshëm dhe qytetarë solidar, këta fëmijë janë shembulli më i mirë se si ndihmohet në prag të festave dhe të gjithë ata që sot kanë nevojë ta kenë dhomën e ngrohtë, sofrën plot dhe të kenë mundësi të barabarta. Ky është mesazh për të gjithë neve përgjegjësit, për të gjithë qytetarët dhe në kuadër të këtij solidariteti është shembulli më i mirë që heronjtë e vegjël të Gjilanit, në mënyrën me të mirë, e dëshmojnë se si duhet të kujdesemi për njerëzit tanë”, tha kryetari Haziri. Kryetari i Gjilanit ka konfirmuar Komuna nesër do të shpërndajë 200 pako ushqimore për familje, për t’ua lehtësuar nevojat dhe kërkesat e tyre. “Ne e kemi programin e festave, ku nesër do të shpërndahen 200 pako ushqimore për familjet në nevojë, por këto janë zgjidhje të përkohshme. Përkundër që ne programin e dimërimit e kemi program të rregullt buxhetor, ne gjatë gjithë vitit jemi munduar që familjeve me nevojë t’iu qëndrojmë afër dhe tash do të fillojmë edhe ndërtimin e programit për rehabilitimin e shtëpive dhe banimit social dhe zgjidhjen e këtyre probleme për banim që ne iu kemi dhënë qasje në këtë fazë”, shtoi Haiziri. Nga ana e saj, Lumnije Ibrahim - Beqiri, mësime ndihmëse dhe shoqëruese e këtyre nxënësve, ka theksuar se iniciativa është ndërmarrë që të ndihmojnë skamnorët, duke shtuar se synojnë që këtë ta përcjellim gjeneratë pas gjenerate dhe të mbjellim dashuri që këta fëmijë në të ardhmen t’i ndihmojnë njerëzit që kanë nevojë.

Ndihmohen mbi 550 familje skamnore

3 tetor 2014

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Gjilan me aktivitete të shumta në të gjithë sektorët, por edhe efektive karshi qytetarëve gjilanas kur merret parasysh puna e madhe që është bërë në mbështetje të rasteve sociale - mbi 200 familje u shpërndahen pako ushqimore, mbështetjes shëndetësore për më shumë se 350 raste dhe punë të tjera dhe të rëndësishme në shëndetësinë primare.

Me këtë rast, U.D. Mursel Zymberi, ka thënë se aktivitetet e drejtorisë janë të shumta duke përfshirë të gjithë sektorët e saj. “Jemi duke punuar në zbutjen e vështirësive të familjeve me gjendje të rëndë ekonomiko – sociale. Në kuadër të kësaj ne kemi ndihmuar rreth 200 familje me pako ushqimore të cilat i kemi siguruar përmes një donatori – bashkatdhetari nga Zvicra, në mënyrë që edhe këto familje të kenë më të lehtë në festën e Kurban Bajramit. Po ashtu drejtoria e shëndetësisë ka ndihmuar mbi 350 raste me barëra dhe trajtim shëndetësor – rehabilitim, brenda dhe jashtë vendit, këto i kemi arritur në bashkëpunim me zyrën e kryetarit të Komunës”, ka thënë ndër të tjerash Zymberi. Ndryshe, kjo drejtori është duke vazhduar me mbështetjen e rasteve sociale, rasteve shëndetësore, është duke punuar edhe në shëndetësinë primare, ndërsa po vazhdon përgatitjen për projektin e dimërimit por edhe në evidentimin e rasteve të rënda dhe pa kulm mbi kokë në mënyrë që të nis rregullimi i shtëpive të tyre dhe zgjedhja e problemit të banimit.

Bunjaku Rexhepi: Studentët ishin dhe janë lokomotiva e ecjes së Kosovës

7 tetor 2014



Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Gjilanit Valentina Bunjaku – Rexhepi është takuar me udhëheqjen e organizatës studentore USPE e cila fushë-veprimtarinë e saj e ushtron në Universitetin Publik “Kadri Zeka” në Gjilan, Prishtinë dhe Prizren.

Me këtë rast Bunjaku – Rexhepi, ka thënë se Gjilani përditë e më shumë po përtërihet me figura të reja të cilët po lëvizin drejtë zgjerimit të profesionalizmit dhe zhvillimit të këtij regjioni për

shkak të numrit të studentëve që po rriten dhe do të rriten edhe më shumë gjatë të ardhmes. “Qyteti i Gjilanit ka bukurin e vërtet me praninë dhe me zhvillimin e rinisë. Numri i madh i studentëve është ai që këtë qytet i cili është qendër e regjionit edhe përtej kufijve po e zbukuron. Profesionalizmi është një element që kjo anë tashmë e ka traditë dhe po e zgjeron edhe më shumë. Ne nga këndi i institucioneve lokale, jemi të përkushtuar që vendin meritohet ta kenë studentët e kësaj ane. Zhvillimi i shtetit të Kosovës dhe ecja e sigurt është mundësuar pikërisht nga studentët para dhe gjatë luftës e posaçërisht tani në këtë fazë të zhvillimit dhe integritetit të vendit”, ka thënë kryesuesja ndër të tjerash. Selim Daku, kryetar i USPE-së në nivel vendi, ka informuar nga ana e tij kryesuesen e Kuvendit të Komunës me sukseset e arritura të organizatës, me ecjen e saj nëpër sfida por edhe për sfidat dhe problemet në përgjithësi të studentëve kosovar nëpër universitetet publike. Ai poashtu ka përmendur edhe aspektin e efikasitetit të kolegëve të tij student, gjatë studimeve dhe në angazhimet e tyre pos diplomime. Sikur që ka spikatur edhe nevojën e madhe për mbështetje nga institucionet lokale.

Ismajli: Zabelit po i kthehet dinjiteti

8 tetor 2014

Qytetarëve të lagjes “Zabel i SahitAgës” dita-ditës po u hiqet lloçi e vadat, ngase Komuna e Gjilanit në mënyrë permanente po ua përmbushë nevojat infrastrukturore.



Pas asfaltimit të gjashtë rrugicave gjatë këtyre ditëve dhe rregullimit të kanalizimit dhe ujësjellësit, sot në Zabel ka nisur asfaltimi i rrugës në gjatësi prej 900 metrash.

Punimet i ka vizituar sot shefi i Kabinetit të kryetarit Lutfi Haziri, Arbër Ismajli si dhe shefi i këshilltarëve të LDK-së në Kuvendin Komunal, Avdyl Aliu.

Ata janë ndarë tejet të kënaqur me cilësinë e këtyre punimeve, duke u zotuar se me këtë dinamikë do të vazhdohet edhe në të ardhmen.

“Kjo që po shohim sot përket me kujdes të madh të Komunës ndaj banorëve të anashkaluar të Zabelit. Që nga fillimi i mandatit e kemi pasur prioritet këtë lagje dhe në bazë të asaj që kemi punuar këtu po shihet se Zabelit po i kthehet dinjiteti, duke ua rregulluar rrugët sipas standardeve europiane. Kjo nuk është e tëra. Me këto projekte të katërshes së madhe të prioritetëve të premtuara nga kryetari Haziri do të vazhdojmë edhe në të ardhmen në këtë lagje si dhe lagjet e fshatrat tjera të Komunës së Gjilanit”, ka thënë me këtë rast shefi i Kabinetit, Arbër Ismajli.

Nga ana e tyre, banorët që jetojnë afër kësaj rruge kanë falënderuar kryetarin Lutfi Haziri për kujdesin, duke u ndarë shumë të kënaqur me kujdesin e treguar për t’ua përmbushur nevojat e tyre.

Brenda kësaj jave në lagjen “Zabel i SahitAgës” janë asfaltuar rrugë në gjatësi prej 2.5 kilometra me të gjitha elementet përcjellëse.

Haziri: Do të shkoj në punë me biçikletë

10 tetor 2014

Kryetari i Komunës së Gjilanit Lutfi Haziri, ka vizituar kompanitë “Integj” dhe “Albimi”, për të manifestuar kujdesin e Komunës ndaj bizneseve gjilanasë.



Haziri, i cili shoqërohej nga drejtori për Zhvillim Ekonomik, Ismail Januzi dhe shefi i Kabinetit Arbër Ismajli, ka përgëzuar këto biznese për suksesin e arritur, duke eksportuar jashtë vendit 60 për qind të prodhimeve – veçanërisht biçikletave. “Duhet ta dijë Kosova që në Gjilan prodhohen biçikleta që mund t’i shfrytëzojnë ata që duan. Ne do t’i rrimë afër bizneseve do të t’ju ndihmojmë me të gjitha kapacitetet tona komunale. Heronjtë e sotëm janë këta që krijojnë vende të reja pune”, tha me këtë rast kryetari Haziri. Kreu i Gjilanit ka thënë se tashmë ka nisur rregullimi i stazave për biçikleta, ndërsa pohoi ka në plan që të qes në ankand veturat e Komunës, për blerë biçikleta dhe për të shfrytëzuar për nevojat e Komunës. “Kemi hyrë në program të

përbashkët për të ndërtuar parkingje për biçikleta për të inkurajuar njerëzit që t'i përdorin për qarkullim. Tash e tutje do t'i qesim në ankand veturat dhe të marrim biçikleta për shërbime tona brenda Komunës. Janë ekologjike, pa shpenzime dhe personalisht do të shfrytëzoj biçikletën që të shkojë në punë dhe të kryej punët e ditës. I kemi bërë shtegjet, por policia ka ende punë për të bërë në mënyrë që t'i liroj shtegjet nga parkingjet ilegale dhe përfundimisht do të hyjmë në bashkëfinancim për parkingje të biçikletave dhe rregullimin e trotuareve në Gjiilan", ka thënë Haziri.

Haziri: Regjioni i Lindjes është përfituesi më i madh në programin “Kosova e Bukur”

15 tetor 2014

Në programin e BE-së "Kosova e Bukur" kanë përfituar më së shumti inestvime komunat e regjionit të lindjes. Kryesues i Bordit të AZHR-Lindje u zgjodh Muharrem Sfarça.



Kryetari i Komunës së Gjiilanit, Lutfi Haziri ka falënderuar Bashkimin Europian për ndihmën e vazhdueshme për Kosovën, sikurse edhe për bashkëpunimin e mirë të përfaqësuesve të AZHR-Lindje. Ai ka pohuar se ky regjion i anashkaluar nga qeveria qendrore, sivjet ka përfituar më së shumti në projektin “Kosova e Bukur”.Shefi i Zyrës së BE-

së në Kosovë, Christof Stock, ka rikonfirmuar se Bashkimi Europian do të vazhdojë ta ndihmojë Kosovën dhe këtë regjion, duke financuar projekte të ndryshme. Në këtë takim të Bordit AZHR-Lindje, kryesues u zgjedh kryetari i Ferizajt, Muharrem Sfarça. Deri tash, pozitën e kryesuesit të këtij Bordi e ka mbajtur kryetari i Kamenicës, Begzad Sinani.

Hapet panairi i bletarisë në Gjilan

16 tetor 2015



Në Komunën e Gjilanit është hapur panairi i bletarisë me prodhuesit vetëm nga Gjilani, që është organizuar nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik në mbështetje nga Riinvesti e që ka ngjallur interesim edhe të qytetarëve, të cilët mund të shohin produktet bujqësore dhe prodhimet e bletës për tri ditë rresht nga dita e sotme.

Me këtë rast kryetari i Komunës Lutfi Haziri, ka uruar bletarët duke inkurajuar prodhimet e bletarisë e në përgjithësi të bujqësisë Gjilanase dhe është zotuar se Komuna e Gjilanit është përherë afër fermerëve.

“Urime ky panair i bletarisë, ju inkurajoj juve prodhuesve të bletarisë, por edhe prodhuesve të tjerë që të vazhdoni me investime në bujqësi dhe nga këtu sikur edhe më herët ju garantojmë që



Komunën e keni mbështetëse në të gjithë programet e bujqësisë. Bujqësia dhe regjioni ynë janë të lidhura historikisht në zhvillim, ndërsa agro-industria është baza kryesore e zhvillimit

në Komunën e Gjilanit dhe do të jetë baza kryesore e zhvillimit edhe në të ardhmen. Kështu që kushtet e prodhuesve vendor në bujqësi, duke marrë parasysh subvencionet e Komunës, të Qeverisë, Donatorëve dhe partnerëve

si Riinvesti është më e lehtë të krijohen lehtësira dhe prodhim, e që domosdo ndikon edhe në punësimin e qytetarëve”, ka thënë kryetari Haziri duke shtuar se shkolla e bujqësisë e cila pa dashjen time është dal në periferi, në kushte të mira, por edhe më tutje nuk është atraktive të

absorboj kërkesat edhe pse drejtoria e arsimit po promovon këtë shkollë që të shkojnë atje nxënësit, por derisa shkolla nuk bëhet atraktive – tërheqëse për fëmijët tanë problemet janë të kësaj natyre.

Ndërsa, Ismail Januzi, drejtor i Zhvillimit Ekonomik, ka thënë se ky është panairi i bletarisë i cili po organizohet në bashkëpunim me Insitutin e Riinvestit me pjesëmarrës të prodhuesve të bletarisë Gjilanase, për të promovuar produktet e bletarisë.

“Është ky panair që është organizuar nga Komuna e Gjilanit dhe Insituti Riinvest, e që ka për qëllim të bëjë promovimin dhe shitjen e mjaltit të Komunës së Gjilanit. Këtë vit si projekt me Rinvestin kemi vetëm promovimin e bletarëve nga Komuna e Gjilanit edhe pse ndoshta jemi pak borxhlinj të komunave përreth por gjatë të ardhmes do të bëjmë edhe një të tillë regional”, ka thënë drejtori Januzi.

Ndryshe në këtë panair kanë marrë pjesë 15 prodhues, e nga ta kishte edhe nga komuniteti serb, ndërsa interesimi ishte edhe nga shumë qytetarë, por edhe nga nxënësit e shkollës së bujqësisë dhe përfaqësues të ndryshëm të shoqërisë Gjilanase.

752 fermerë aplikantë kanë përfituar nga projekti për mbjelljet vjeshtore duke mos u refuzuar asnjë

20 tetor 2014



Komuna e Gjilanit, respektivisht Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë, sot ka shpërndarë farë gruri për 752 fermerë me mbi 200 mijë kg farë, që do të mbillen 861 hektar me grurë, duke mos e refuzuar asnjë fermer të vetëm, sepse kështu parasheh programi qeverisës për familjet Gjilanase.

Me këtë rast kryetari i Komunës së Gjilanit ka thënë se do të punohet në atë mënyrë që asnjë pëllëmbë toke të mos mbetet pa punuar.

“Ashtu siç kemi thënë në pakon familjare të programit të bujqësisë subvencioni për bujqit ka me qenë për të gjithë ata që duan dhe kanë mundësi të punojnë. Ne po bëhemi gati për të fituar

bukën vitin e ardhshëm dhe ky është subvencion për prodhimin e grurit dhe mbjelljen e kulturës vjeshtore, duke shpresuar në bereqet me rendimente shumë të sigurta, kur kemi parasysh kualitetin e farës e cila po shpërndahet dhe kushteve klimatike që këtyre ditëve po mbretërojnë”, ka thënë kryetari Haziri, i cili ka përmendur edhe programe të tjera deri në fund të këtij viti ku do të përfitojnë bujqit Gjilanas, në sektor të ndryshëm.

Kryetari Haziri ka dhënë edhe një lajm të mirë për bujqit Gjilanas, ai i ka informuar ata se është duke u punuar me përkushtim të thellë që edhe buxheti për vitin e ardhshëm në sektorin e bujqësisë të dyfishohet në krahasim me këtë vit. Haziri ka spikatur edhe atë që bujqit janë numri më i madh i njerëzve të cilët punojnë dhe krijojnë të hyra në familje dhe ky është qëllim edhe i Komunës së Gjilanit.

Ndërsa drejtori i Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari, Ramiz Ramadani ka thënë se shpërndarja e farës së grurit ka nisur dy ditë më parë dhe do të përfitojnë 752 fermer me rreth 203 ton farë gruri.

“Kemi nisur që të bëjmë shpërndarjen e farës së grurit për mbjelljet vjeshtore dhe për herë të parë po përfitojnë të gjithë ata që kanë aplikuar dhe numri i tyre është 752 fermer me mbi 200 mijë kilogram, ku parashihet të mbillen 861 hektarë me grurë me një farë shumë cilësore. Kërkoj nga bujqit që të marrin masat tjera teknike në afatin optimal në mënyrë që rendimentet të jenë në pragun e maksimumit të paraparë. Fara e cila shpërndahet është e licencuar dhe i plotëson të gjitha parametrat e asaj që ne i kemi kërkuar. Janë të ndara në dy lloje të varieteteve, të gjata dhe të shkurtra, në varietetet e shkurtra hyjnë varieteti gjerman “sintaki”, pastaj varietetet e gjata si: “fitorja”, “renesanca” dhe “evropa”. Ne kemi marrë përgjegjësi sa i përket varieteteve, sepse që të gjitha kanë certifikimet e kërkuara për kualitetin dhe rendimentet e parapara”, ka thënë drejtori Ramadani, i cili ka falënderuar mbështetjen e madhe të kryetarit të Komunës sepse është shembulli më i mirë i mbështetjes për këtë sektor në gjithë Kosovën.

Ndryshe, drejtori Ramadani ka thënë se edhe kushtet klimatike janë shumë të favorshme që gruri të mbillet në këtë kohë ngase janë të gjithë parametrat në favorin e fermerit që një gjë e tillë të ndodh.

Edhe disa projekte të tjera për këtë periudhë të mbetur në bujqësinë gjilanase

Drejtori Ramadani, po ashtu ka informuar fermerët se bujqësia gjilanase do të përfitoj edhe projekte të tjera në këtë periudhë të mbetur të vitit 2014.

“Gjatë ditëve në vijim do të nisim me shpërndarëset e plehut artificial dhe spërkatëseve, ndërsa gjatë pjesës së fundit të këtij muaji do të nisim me implementimin e projektit për serat komerciale.

Gjatë muajit nëntor dhe dhjetor planifikohet të punojmë me dy projekte të tjera siç është projekti i “atomizerëve” (të cilët shërbejnë për spërkatjen e pemëve) ku mendohet të shpërndahen diku

rreth 15 “atomizer”, ndërsa në fund do ta përmbyllim vitin me projektin e Llaktofrizave i cili realizohet në partneritet me qumështoren KABI, që është një projekt i cili nuk na imponon kohën e realizimit të tyre dhe këto janë katër projekte të tjera që do të realizohen në këtë periudhë të mbetur të këtij viti”, ka përfunduar drejtori i Bujqësisë Ramiz Ramadani.

Gjilani ka fituar 3 projekte nga KE

22 tetor 2014

Në thirrjen për Grante të Komisionit Evropian (IPA), të Programit për Bashkëpunim Ndërkufitar Maqedoni-Kosovë, Komuna e Gjilanit në bashkëpunim me Komunën e Çairit ka fituar një projekt në vlerë prej mbi 500 mijë euro.



Kontratën për implementimin e projektit e ka nënshkruar kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, i cili tha se së bashku me dy projektet tjera të fituara gjatë vitit 2014 në kuadër të programit “Kosova e Bukur” të Komisionit Evropian, kapin vlerën e afro 1 milion euro. “Objektivi i përgjithshëm i projektit

është zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik në zonën ndërkufitare, përmes mbështetjes të degëve tradicionale dhe sipërmarrjes sociale”, ka thënë Haziri. Projekti në tërësi arrin vlerën rreth 500 mijë euro për të dy komunat, derisa granti për komunën e Gjilanit arrin vlerën 241,631 euro, duke përfshirë këtu edhe participimin e Komunës në vlerë 36,244 euro. Realizimi i projektit do të zgjas 18 muaj dhe në kuadër të tij ka të përfshirë: bashkëpunim, koordinim dhe këmbim të përvojave mes dy komunave (Gjilan dhe Çair), menaxhimin e projektit konform kushteve dhe standardeve të Komisionit Evropian, trajnime, konferenca, panairë, vizita, material promovues, rehabilitimin e hapësirave ku është e vendosur qendra informuese, nën-grante të vogla për ndërmarrësit.

Gjilani identifikohet me librin, kulturën, letërsinë dhe artin

23 tetor 2014

Në Gjilan është hapur panairi i librit, ku po marrin pjesë 21 shtëpi botuese nga treva të ndryshme. Panairi organizohet nga Komuna e Gjilanit dhe Ars Klubi “Beqir Musliu”, me mbështetje të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.



Gjilani qytet i librit dhe dashamirë i artit ishte kryefjala e folësve në këtë takim me shumë rëndësi për përhapjen e librit. Me këtë rast kryetari i Komunës, Lutfi Haziri, ka thënë se të gjitha përgatitjet janë bërë që kjo ngjarje të jetë një takim i poetëve me lexuesit. “Gjilani identifikohet me librin, kulturën, letërsinë dhe artin. Është qyteti i Beqir Musliut dhe shumë njerëzve të letrave që gjilanasit dhe Gjilani tradicionalisht ka kultivuar”, ka thënë Haziri, i bindur se panairi tjetër do të organizohet në bibliotekën e re.

“Çdo e re apo i ri, ka nevojë për hapësirën e vet dhe poashtu edhe libri dhe ky panair kanë nevojë për shtëpinë e vet dhe vendin e vet”, ka thënë kryetari Haziri. Ndërsa botuesi Haqif Hysa tha se Gjilani qëndron në mesin e qyteteve me traditë në organizim të këtyre takimeve të mëdha kulturore. “Të krijosh vend për librin, është një pasuri, andaj falënderoj Komunën e Gjilanit për këtë nismë të mbarë.

Organizimi në Gjilan përherë është me energji dhe frymë pozitive”, ka thënë ai. Ndërsa, në nderim të panairit të 42 të librit, në nderim të Gjilanit si vend i artit, kulturës dhe letërsisë, janë paraqitur me nga një poezi poetët e Penë Qendrës së Shkrimtarëve të Kosovës dhe Ars Klubi “Beqir Musliu”.

Komuna e Gjilanit dhe UNDP nënshkruajnë marrëveshje për të luftuar korrupsionin

28 tetor 2014



Marrëveshjen e nënshkroi kryetari i Komunës së Gjilanit Lutfi Haziri dhe përfaqësuesi i përhershëm i UNDP-së, Andreë Russell, në kuadër të projektit SAEK e financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC). “Jam jashtëzakonisht krenar që e nënshkruam marrëveshjen me UNDP-në, që është një program në luftën kundër çdo llojkorrupsioninë institucionet tona”, ka thënë Haziri. Ky program është në interes të qytetarit sepse në kohën kur problemi kryesor del të jetë sundimi i ligjit dhe lufta kundër çdo forme të

korupsionit na ndihmon shumë kjo marrëveshje e mirëkuptimit ta mbështes Gjilanin me kapacitete, politika dhe angazhime konkrete në mënyrë që të parandalon çdo korrupsioni i cili është bërë problemi kryesor dhe sëmundja kryesore e shoqërisë sonë, ka thënë kryetari Haziri. Përfaqësuesi i UNDP-së, Rusell u zotua se do të punojë ngushtë me Komunën e Gjilanit për zbatimin e aktiviteteve të ndryshme që pritet të kenë ndikim pozitiv në fuqizimin e kapaciteteve të Komunës për të identifikuar dhe parandaluar korrupsionin zyrtar. Rusell ka thënë se UNDP do të vazhdojë të mbështes komunën në ngritjen dhe ruajtjen e mjeteve ekzistuese të komunikimit modern përfshirë platformat e bazuara në internet dhe media sociale si dhe aplikacionet e telefonatave celular për rritjen e transparencës komunale dhe fuqizimin e angazhimit qytetar në vendimmarrje.

Solidariteti qytetar do të ndikojë direkt në përmirësimin e jetës së familjeve në nevojë

31 tetor 2014

Kryetari i Komunës së Gjilanit ka paraqitur sot të dhëna shtesë lidhur me deklaratimet e mjeteve financiare të qytetarëve në Mbrëmjen Humanitare të organizuar nga Komuna e Gjilanit javën e kaluar me moton “Pak nga ne, shumë për ata”

Haziri, në konferencën e sotme për media ka thënë se solidariteti i qytetarëve të Gjilanit dhe shqiptarëve kudo në botë e ka bërë krenar. “Sot po paraqes rezultatet e aktivitetit dhe solidaritetit qytetar kryesisht nga banorët Gjilanit, por edhe banorët e tërë territorit të Republikës dhe shqiptarët kudo në botë, në iniciativën e Komunës së Gjilanit për të ndihmuar rastet e rënda, për t’u solidarizuar me familjet me gjendje të rëndë ekonomike dhe angazhimi i ynë që prej qershorit deri tash ka kulmuar me këto përmasa që neve na bënë të ndihemi krenar. Solidariteti qytetar do të ndikojë drejtpërdrejt në përmirësimin e jetës së këtyre familjeve”, ka thënë kryetari Haziri. Kreu i Gjilanit tha se janë nga qytetarët e vullnetit të mirë 278 mijë e 854 euro, 92 e 770 franga zvicerane dhe 9 shtëpi me çelësa në dorë. “Janë deklaruar dhe konfirmuar nga Kabineti im 278 mijë e 854 euro dhe 92 e 770 franga zvicerane, përveç buxhetit të Komunës që është 100 mijë euro. Poashtu, janë premtuar 9 shtëpi me çelësa në dorë, mobilim, ndërtim të kulmeve dhe një sërë aktivitete të tjera ekonomike që e lehtësojnë shumë gjendjen e banimit. Praktikisht është një aksion i suksesshëm, një solidaritet jashtëzakonisht i madh, për të cilin jemi krenarë”, ka shtuar kryetari Haziri. Haziri ka premtuar se të gjitha deklaratimet e qytetarëve do të bëhen publike në faqen zyrtarë të komunës së Gjilanit. Kryetari Lutfi Haziri ka falënderuar qytetarët për gatishmërinë e tyre për të ndihmuar, mediat për promovimin, e veçanërisht RTK-në që e mundësoi transmetimin e drejtpërdrejt të Mbrëmjes Humanitare.



Komuna premtan mbështetje për bizneset prodhuese

31 tetor 2014



Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri i shoqëruar edhe nga drejtori i Zhvillimit Ekonomik, Ismail Januzi, kanë vazhduar vizitat në bizneset private, për t'u informuar për punën dhe nevojat që kanë bizneset në ambiciet e tyre zhvillimore.

Me këtë rast kryetari Lutfi Haziri, gjatë vizitës në AL-TECO, kompani e cila merret me prodhimin e tonerëve të ndryshëm për printer, ka ofruar mbështetjen e Komunës për të ndikuar në krijimin e lehtësiraveshtesë. “Të gjithë ne në Gjilan dhe më gjerë kemi mundësinë të përdorim prodhimet e kompanisë e cila është vendore e aq më mirë që është nga Gjilani”, ka thënë ai. Sa i përket Komunës së Gjilanit, ne do të jemi përkrahë bizneseve duke krijuar lehtësira në të bërit biznes e që ndikon drejtpërdrejtë edhe në zhvillimin dhe zgjerimin e tyre nëpër veprimtaritë e tyre me të cilat merren, ka thënë kryetari Haziri, duke shtuar se shteti ka ende punë në këtë drejtim, për të ndryshuar politikat të cilat pikëprekin biznesin, sepse numër i madh i qytetarëve janë të angazhuar në sektorin privat, ndërsa me mbështetjen shtetërore ky numër mund të rritet edhe më shumë. Numri i bizneseve është më i madh dhe mundësia për punësim është më e madhe.

Buxheti i bujqësisë për vitin 2015 do të jetë

mbi një milion euro

4 nëntor 2014

Ramiz Ramadani, drejtor për Bujqësi, thotë se premtimi i kryetarit të Komunës, Lutfi Haziri për rritjen e investimeve në bujqësi për vitin 2015, në një milion euro, do të realizohet, pavarësisht se Ministria e Financave e ka ulur buxhetin komunal për bujqësi në 429 mijë euro.

Ndryshe, Ramadani ka thënë se sivjet janë planifikuar të mbillen me grurë 2.850 hektarë si dhe 100 të tjerë, me elb. Ai ka thënë me farë gruri janë subvencionuar 752 fermerë, aq sa ka qenë edhe numri i aplikuesve. Është hera e parë që Komuna e Gjilanit i ka subvencionuar të gjithë fermerët me farë gruri dhe mbase është komuna e vetme në Kosovë që e ka bërë këtë, ka thënë

Ramadani. Ai ka thënë se me këtë farë, e cila është e testuar dhe e dëshmuar për prodhimtari, priten rendimente më të larta të grurit verën që vjen. Sasia e tërësishme e farës që është shpërndarë është rreth 203 mijë kilogramë.

Përmbillet pilot-projekti për themelimin e 10 këshillave të fshatrave

4 nëntor 2014

Është përmbyllur me sukses pilot-projekti i Komunës së Gjilanit për themelimin e dhjetë këshillave lokale, i cili është realizuar në bashkëpunim me organizatën “Agro-Eko” dhe Ambasadën Amerikane.

Kryetari i Komisionit komunal, Avdyli Aliu, ka thënë se konstituimi i Këshillave lokalë ka qenë premtim kryetarit Lutfi Haziri në fushatën elektorale. Këshilli i fshatit, vendbanimit apo lagjes



urbane kujdeset për planifikim urban dhe rural, për furnizim me ujë, rregullimin e kanalizimit, drenazhimet etj., për ofrimin e shërbimeve publike efikase, mbrojtjen shëndetësore primare, mbrojtjen lokale të ambientit, zhvillimin e turizmit, sigurimin e hapësirave të hapura dhe varrezave, pastaj për organizimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive, sikurse që bashkëpunon me organet komunale dhe organizatat tjera për çështjet me interes për

lokalitetin, evidenton dhe paraqet prioritetet e lokalitetit para organeve të Komunës, merr pjesë në emër të qytetarëve të lokalitetit në financimin e çështjeve që janë pjesë e marrëveshjes së bashkëpunimit në mes të Komunës, kujdeset për organizimin e aksioneve vullnetare në interes për lokalitetin dhe kryen edhe detyra të tjera të cilat mund të jenë të bartura nga Kuvendi i Komunës ose Kryetari i Komunës në pajtim me ligjin dhe Statutin e Komunës.

Ndryshimet në Statutin e Komunës janë në dobi të qytetarëve

6 nëntor 2014

Kryetari i Komunës së Gjilanit Lutfi Haziri ka thënë se ndryshimet në statutin e Komunës janë të nevojshme për funksionalizimin e administratës komunale dhe kjo përkthehet me shërbime më të mira për qytetarët.



“Sa i përket Drejtorisë së Inspeksionit janë disa arsyeje. Është bërë vlerësimi i punës në këtë nëntëmujor, është parë performanca nga afër e këtij resori. Kemi dashur ta largojmë nga koncentrimi në një autoritet, në një drejtor dhe ta bartim inspeksionin sipas

detyrave në tri drejtori. Inspektorët e urbanizmit do të shkojnë në Drejtorinë e Urbanizimit, inspektorët e shërbimeve në drejtorinë përkatëse, e një pjesë në Drejtorinë e Shëndetësisë. Te kultura, është arsye krejt tjetër. Nuk është në përputhje emërimi i Drejtorisë në funksionin që është paraparë. Kultura duhet të ndahet nga sporti dhe rinia dhe të ndahet nga varshmëria politike sepse subvencionet që janë dhënë sivjet vetëm për 9 muaj, janë më shumë se për tërë vitin e kaluar. Po shkojnë shumë mjete buxhetore në subvencione të drejtpërdrejta të kontrolluara nga ne si zyre. Ndarja e buxhetit të qartë për një kategori, p.sh. për rininë në janar do të dihet sa mjete

harxhon për një vit, jo në çdo muaj të varen nga subvencionet. Ata vetë do të merren me menaxhim të buxhetit. Në këtë mënyrë, unë dua të heq dorë nga vendimmarrja e drejtpërdrejt. Me ndryshimet statutare, nuk ka më shumë zyra, por ka bashkim zyrash, sepse tani ka zyrë që ka shef e nuk ka punëtor ose ka shef sektori e nuk ka asnjë punëtor. “Nuk duam të bëjmë shumë shefa e shumë zyra, e punët askund, por do të bëhet një zyrë dhe zyrtarët do t’i japin përgjegjësi një titullari. Duhet të ndërtojmë hierarki të organizimit në mënyrë që secili ta dijë detyrën e tij”, ka thënë kryetari Haziri në arsyetimin e tij në Kuvend lidhur me ndryshimet statutare.

Haziri: Në mandatin tim nuk do të ketë biznes me pronën komunale

6 nëntor 2014

Kuvendi Komunal i Gjilanit, në mbledhjen e radhës, që e kryesoi Valentina Bunjaku-Rexhepi, ka miratuar ndryshimet në statutin e Komunës, Raportin financiar janar-shtator 2014, dy kërkesa për kompensimin e borxhit, njëra ndaj një qiradhënësi të banimit social dhe tjetra ndaj Organizatës së Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës si dhe një vendim për transferin e mjeteve financiare. Përgjigje pozitive ka marrë edhe kërkesa e Këshillit të fshatit Zhegër, për vendosjen e memorialit "Katana" në një pronë komunale. Kuvendi ka debatuar edhe për Raportin e auditimit 2013 si dhe është njoftuar për punën 6-mujore të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

Interesim e anëtarëve të Kuvendit Komunal e ka tërhequr më së tepërmi ndryshimi i statudit të Komunës. Valentina Bunjaku-Rexhepi, kryesuese e Kuvendit Komunal, ka thënë se komisioni për akte normative e ka sjellë në Kuvend propozimin përfundimtar të statudit, ku janë harmonizuar dy versionet e mëparshme. Arsyetimin, në emër të komisionit statutar e ka dhënë Arben Mehmeti.

Riorganizimi i pushtetit vendimmarrës dhe ekzekutiv bëhet duke reduktuar numrin e drejtorëve në 10, nga 12 sa ishin deri tani dhe duke e rritur numrin e komiteteve, si trupa ndihmëse dhe profesionale të Kuvendit, nga 9 në 12. Te drejtoritë, si pjesë e pushtetit ekzekutiv, ka reduktime. Kultura shndërrohet në Njësi, ndërsa Inspekcioni bashkohet me drejtorinë e Urbanizimit. Të tjerat mbeten siç kanë qenë deri tanë. Numri i zyrave rritet në 12, meqë shtohet Kabineti i kryetarit, Njësia për Kulturë dhe Zyra për Preshevē, Medvegjë e Bujanoc. Zyra e deritashme e Avokatit të Komunës bashkohet me Zyrën Ligjore. Te komitetet, pos atyre ekzistuese, janë shtuar Komiteti për barazi gjinore, Komiteti për bashkëpunim ndërkufitar dhe Komiteti konsultativ i ekspertëve të planifikimit hapësinor. Opozita edhe paraprakisht kishte kundërshtuar reduktimin e ekzekutivit. Kryetari i Komunës, Lutfi Haziri ka thënë se ndryshimet janë të dobishme për funksionalizimin e resorëve përkatës dhe kjo përkthehet me shërbime më të mira për qytetarët. Ai ka sqaruar se sa i përket Drejtorisë së Inspeksionit, qëllimi është që të largojmë koncentrimin në një autoritet, në një drejtor dhe shërbimet t'i bartim në tri drejtori përkatëse. Te kultura, është arsye krejt tjetër.

Kultura duhet të ndahet nga sporti dhe rinia dhe të ndahet nga varësia politike sepse subvencionet që janë dhënë sivjet, vetëm për 9 muaj, janë më shumë se për tërë vitin e kaluar. Rinia do të ketë po ashtu buxhetin e saj dhe nuk do të varet nga subvencionet, ka thënë Haziri, duke shtuar se forma e deritashme e organizimit të këtyre sektorëve nuk është treguar efektive. “Me këto ndryshime statutare, nuk ka më shumë zyra, nuk ka zyra që kanë shef e nuk kanë punëtorë, nuk ka më shef sektori që nuk ka punëtor”, ka thënë Haziri. Kuvendi ka miratuar edhe Raportin financiar janar-shtator 2014, të cilin e ka paraqitur Ilmi Limoni, drejtor për Buxhet. Ai

ka thënë se buxheti i përgjithshëm i planifikuar i Komunës së Gjilanit për vitin fiskal 2014, është 20.125.842 euro. Brenda kësaj periudhe, plani i të hyrave komunale është realizuar 95 për qind, që është për 3 për qind më shumë se vjet në këtë periudhë.

Shpenzimet janë reduktuar ndjeshëm në krahasim me vitin e kaluar. Ndërkaq, sa u përket borxheve të trashëguara nga qeverisja e kaluar, Ilmi Limani, drejtor financiar, ka sqaruar se deri më tani janë shlyer rreth 2 milionë euro, ndërsa kanë mbetur edhe 2.2 milionë euro të tjera. Lutfi Haziri ka thënë se Komuna e Gjilanit nuk do të bëjë me biznes me pronën komunale, siç ka bërë administrata e kaluar. "Unë zotohem para juve se Komuna e Gjilanit, në mandatim tim nuk do të bëjë biznes me pronën komunale, siç ka bërë qeverisja e kaluar përmes partneritetit publiko-privat", ka thënë Haziri. Përndryshe, ai ka thënë se si pasojë e fillimit të projekteve pa zotim të mjeteve, 19 programe kanë mbetur të papërfunduara nga vitet e mëhershme. Në funksion të uljes së mëtutjeshme të shpenzimeve, Haziri ka thënë se do t'i shes veturat e Komunës, përfshirë edhe veturën e kryetarit. "Edhe tani, drejtorët shkojnë në Prishtinë me autobus", ka thënë Haziri, duke nënvizuar se nuk ka më as dreka zyrtare. Kuvendi ka qenë unanim te miratimi i dy kërkesave për kompensim të borxheve, të cilat i ka arsyetuar Sadri Arifi, shef i Shërbimit të Kuvendit. Te rasti i parë bëhet fjalë për një borxh prej 5.531 euro, për rrymë dhe ujë ndaj pronarit Feim Zylfiu, objekti i të cilit ishte kontraktuar nga Komuna me qira, për nevoja banimi të 9 familjeve sociale

Nis ndërtimi i shtëpisë për familjen Marovca

8 nëntor 2014

Në ditëlindjen e 45-të të tij, kryetari i Komunës së Gjilanit Lutfi Haziri, ka vizituar sot familjen e Zijadin Marovcës, e cila vuan nga mungesa e banimit, duke i konfirmuar lajmin për ndërtimin e shtëpisë, nga bashkatdhetari ynë në Zvicër, Ruzhdi Bunjaku.

Kreu i Komunës së Gjilanit, i cili shoqërohej nga kryesuesja Valentina Bunjaku-Rexhepi, ka thënë se me këtë shtëpi, po nis edhe zyrtarisht implementimi i projektit të Komunës së Gjilanit për të zgjidhur problemet qytetarëve që vuajnë nga mungesa e banimit.



Numri i shtëpive që janë premtuar nga qytetarët e vullnetit të mirë në mbremjen humanitare të organizuar nga Komuna e Gjilanit, me moton “Pak nga ne, shumë për ata”, ka qenë nëntë, ndërsa ky është donacioni i dhjetë. “Që nga marrja e detyrës së kryetarit të Komunës, e kam vënë si prioritet zgjidhjen urgjente të problemeve të banimit në Gjilan dhe tashmë kemi filluar ta implemenojmë këtë projekt të madh. Më gëzon shumë fakti që në ditëlindjen time, sot është

gëzuar edhe familja Marovca, e cila shumë shpejt do të bëhet me shtëpi të re, falë bashkatdhetarit në Zvicër, Ruzhdi Bunjaku, i cili ka marrë përsipër ta kryej këtë projekt me kursimet e familjes së tij. Me këtë logjikë të qeverisjes do të vazhdojmë dhe brenda mandatit katër vjeçar, që t’i zgjidhimin të gjitha problemet e banimit në Komunën e Gjilanit”, ka thënë kryetari Lutfi Haziri. Kurse Zijadin Marovca, i gëzuar tej mase, ka falënderuar kryetarin Haziri për kujdesin që po tregon ndaj familjeve në nevojë. “Kemi jetue në kushte shumë të rënda deri tash. Nuk kam fjalë qysh me e përshkrue gëzimin tim dhe të familjes”, ka thënë Marovca.

Haziri: Gradualisht po e nxjerrim Gjilanin nga lloçi dhe vadat

17 nëntor 2014

Ashtu siç kishte premtuar në fushatën elektorale, kryetari i Komunës së Gjilanit Lutfi Haziri po e nxjerr gradualisht Gjilanin nga lloçi dhe vadat.

Dëshmi për këtë janë punët e mëdha infrastrukturore që po realizohen gjithandej Komunës së Gjilanit, në qytet e fshatra, e veçanërisht në rregullimin e shtratit të lumit “Baja”, në lagjen “Dheu i Bardhë”.

Kryetari Lutfi Haziri, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët komunal, ka vizituar sot punimet në rregullimin e shtratit të lumit “Baja”, ndërsa është shprehur se pas përfundimit të këtij projekti banorët e kësaj lagjeje nuk do të vuajnë më nga vërshimet pas të reshurave atmosferike.

“Premtimi im publik për realizimin e katërshe së madhe të prioritetëve infrastrukturore është duke u zbatuar në



praktikë. Ashtu sic kam thënë, gradualisht po e nxjerrim Gjilanin nga lloçi dhe vadat. Jam shumë i kënaqur me dinamikën dhe cilësinë e punimeve në projektin e lumit “Baja”, ku pas përfundimit qytetarët e kësaj ane do jetojnë dinjitetshëm dhe nuk do të rrezikohen nga vërshimet. Me këtë logjikë të përmirësimit të cilësisë së jetës së qytetarëve tanë do të vazhdojmë gjatë mandatit



qeverisës”, ka thënë kryetari Haziri.

Të gëzuar për realizimin e këtij projekti janë shprehur banorët që jetojnë afër lumit “Baja”, të cilët e falënderuan kryetarin Lutfi Haziri që njëherë e përgjithmonë e ka eliminuar problemin e madh të vërshimeve në këtë pjesë të qytetit.

Ky projekt ka një gjatësi prej 480 metrash, që nis prej rrugës “Abdullah Presheva” për të vazhduar deri tek burimi i lumit “Baja”.

Pasi të përfundohet kanalizimi atmosferik dhe mbulimi i tij, do të shtrohen kubëza të betonit, ku do të mund të shfrytëzohet si shëtitore nga qytetarët

Mbi 300 mijë euro gjatë këtij viti investime në asfaltim të rrugëve në “Dheun e Bardhë”

Gjilan, 18 nëntor 2014

Kryetari i Komunës së Gjilanit me bashkëpunëtor kanë vizituar sot lagjen e “Dheut të Bardhë”, ku janë investuar mbi 300 mijë euro në asfaltim e 11 rrugëve në këtë lagje, e cila padrejtësisht kishte mbet nën hijen e investimeve me një infrastrukturë të degraduar totalisht.

Me këtë rast kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka thënë se investimet në këtë lagje janë bërë konform programit për të larguar lloçin dhe degradimin në infrastrukturën ekzistuese.

“Kemi investuar më shumë se 300 mijë euro për një periudhë të shkurtër në lagjen e “Dheut të Bardhë” në Gjilan, ku kemi përfshirë 11 rrugë të ndryshme. Në programin e Komunës së Gjilanit kemi emëruar të përbashkët investimet në gjithë hapësirën e Komunës, duke i trajtuar të gjithë qytetarët barabarsisht me investime. Jemi të vendosur që të largojmë degradimin dhe lloçin nga

rrugët e këtij qyteti, duke investuar në asfaltim dhe krijim të kushteve më të mira për qytetarët tanë. Kështu me investime dhe me dinamikë të shtuar kemi vazhduar edhe në të gjitha lagjet dhe fshatrat tjera, duke garantuar përmbushjen e premtimit të katërshe të madhe në programin qeverisës e që ishte rrugë, ujësjellës, kanalizime dhe ndriçim e trotuare”, ka thënë kryetari i Komunës së Gjilanit Lutfi Haziri.

Ndryshe projekte të kësaj natyre janë realizuar dhe janë në proces të realizimit edhe në lagje të tjera në fusha të ndryshme të infrastrukturës duke përfshirë këtu edhe investime të shumta nëpër fshatra ku në asnjë mënyrë nuk bëhet ndonjë dallim.

Komuna e Gjilanit ka investuar në “Zabel” mbi 500 mijë euro për vitin 2014

18 nëntor 2014

Është mbajtur në lagjen “Zabel i Sahit Agës” tubimi publik i radhës i kryetarit të Komunës së Gjilanit Lutfi Haziri dhe drejtorëve komunal me qytetarët.



Tubimin e ka hapur shefi i këshilltarëve të LDK-së në Kuvend, Avdyll Aliu, i cili vie nga kjo lagje.

Ai ka thënë se nga ky tubim Zabeli ka përfituar sepse për herë të parë Komuna po shkon në këtë lagje për të diskutuar për problemet, projekte, e kërkesa të ndryshme dhe në anën tjetër përfiton edhe Komuna e Gjilanit sepse “qytetarët kanë shprehur besim dhe besimi paraqet vlerë”.

Kryetari Lutfi Haziri tha se kjo lagje ka vuajtur shumë për kujdes, por kthimi i shpresës na bënë të punojmë shumë, për ta arsyetuar besimin tuaj.

“Kam ardhur të diskutoj me ju sonte, sikurse kemi thënë në fushatë se kur të vijmë në qeverisjes do të bisedojmë me ju për hallet, kërkesat, ankesat...E fillojmë me Zabelin dhe do ta vazhdojmë me lokalitete e fshatra të tjerë. Në këtë lagje kemi realizuar disa projekte dhe jemi në revidim të projektit të trotuarit dhe më pas do të nisim punimet në terren’, ka thënë me këtë rast kryetari Haziri.

“Borxhi nuk pret ditë t’mira”

I pari i Komunës së Gjilanit theksoi se “për 10 muaj të qeverisjes i kemi shlyer 2 milionë e 100 mijë euro borxhe që na ka lënë ish-qeverisja dhe kjo ka qenë një ngarkesë shumë e madhe. Por, ne kemi vlerësuar se siç thuhet në popull “borxhi nuk pret ditë t’mira”

Ai tha se do të punojmë edhe më shumë në vitin e ardhshëm që të përmbushim të gjitha kërkesat e qytetarëve.

Qytetarët e kësaj lagjeje kanë bërë shumë pyetje e kërkesa, të cilave u është përgjigjur kryetari Haziri dhe drejtorët komunal.

Haxhi Fazliu ka pyetur për rregullimin e një pjese të rrugës në Zabel dhe rregullimin e parkingut në xhaminë që është ndërtuar nga haxhi Halili.

“E falënderoj shumë haxhi Halilin që e ka ndërtuar me mjete vetanake këtë xhami dhe çështja e parkingut është problemi më i vogël që mund ta bëjë Komuna”, është përgjigjur kryetari Lutfi Haziri.

Raif Robelli ka bërë kërkesë për ndriçim për një pjesë të lagje, ndërsa drejtori Sokol Haziri i ka thënë se brenda dy ditësh do të rregullohet.

“KEDS ka afat një javë për të hequr kutitë e njehsorëve”

Pati edhe pyetje për infrastrukturën e keqe të energjisë elektrike të KEK-ut, ndërsa kryetari Haziri i ka rekomanduar që të lajmërojnë rastet në polici sepse kjo çështje nuk është në kompetencë komunale.

Sa i përket vendosjes së kutive të njehsorëve nga ana e KEDS, Haziri ka thënë se kjo është e papranueshme sepse këtë e kanë bërë pa lejen e Komunës dhe se i kanë dhënë afat edhe një javë KEDS për t’i hequr ato, përndryshe këtë do ta bëjnë vetë zyrtarët komunal.

Fadil Agaj, arsimtar në shkollën fillore në këtë lagje, ka bërë kërkesë për ndërtimin e një salle për edukatë fizike, ndërsa Faton Kqiku ka pyetur nëse ka mundësi të ndërtohet një Qendër e Mjeksësisë Familjare.

Në konsultim me kryetarin, këshilltari Komunal Avdyl Aliu tha se do ta bëjnë të pamundurën që të bëhen këto investime gjatë këtij mandati.

Muhamet Halili ka folur për nevojën e rregullimit të trafikut urban për këtë lagje, derisa Lutfi Haziri tha se po punohet edhe në këtë drejtim, por nuk mund të jap premtim nëse mund të bëhet brenda mandatit.

“Komuna ka investuar në Zabel mbi 500 mijë vetëm në vitin 2014”

Drejtori e Departamentit të Prokurimit Salih Kqiku ka theksuar se gjatë këtij viti, qeveria komunale në krye me Lutfi Hazirin ka investuar në “Zabel” mbi 500 mijë euro vetëm këtë vit, ku përfshihen rrugët, kanalizimi, trotuari e ndriçimi publik.

Drejtori i Urbanizimit Valon Shefkiu tha se jemi duke i hartuar planet rregulluese dhe nga 23 hektarë në fillim, pas kërkesave të shumta të banorëve të kësaj legjeje, kemi nxjerr vendim edhe për 64 hektarë dhe janë bërë gjithsejtë 87 hektarë.

Drejtori Zhvillimit Ekonomik, Ismail Januzi, tha se Gjilani është ndër komunaet e para që e ka trajtuar eficiencën e energjisë elektrike, duke shtuar se është duke u punuar në partneritet me BE-në që ta bëjmë të mundur ndërtimin e një impianti për trajtimin e ujërave të zeza.

“Investimet në infrastrukturë për 2014: dhjetëra km rrugë të asfaltuara, 52 km rrugë të rendit të tretë, 2.5 km kanalizim, 28 km ndriçim...”

Drejtori i Administratës Nazim Gagica theksoi se ashtu sikur sonte që Komuna ka ardhur të ballafaqohet me ju, kjo drejtori ua ka mundësuar që shërbimet t’ua sjellë në shtëpi përmes postës.

Drejtori për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Sadudin Berisha, theksoi se është duke u punuar shumë në çështjen e pronës dhe se gjendja me vitin paraprak ka ndryshuar për 360 shkallë për të mirë dhe ajo që dua të them se ne nuk kemi shitur asnjë pronë komunale.

Ai ftoi të gjithë qytetarët që kanë marrëdhënie pronësore të parregullura, t’i procedojnë dhe do ta kenë mbështetjen e Komunës së Gjilanit.

“Buxheti për bujqësi për vitin 2015 - 1 milion euro”

Drejtori i Shërbimeve Publike Sokol Haziri tha se brenda 10 muajve të qeverisjes Haziri janë shtruar 52 kilometra rrugë të rendit të tretë në fshatra, 28 kilometra ndriçim publik, mbi 2.5 kilometra kanalizim dhe dhjetëra kilometra rrugë të asfaltuara.

Brenda mandatit katër vjeçar, tha ai, do të rregullohen të gjitha problemet infrastrukturore.

Ndërsa, drejtori për Bujqësi Ramiz Ramadani, ka thënë se qytetarët e Gjilanit dhe të Zabelit kanë përfituar për herë të parë nga programi bujqësor.

Ai pohoi se nga subvencioni i Drejtorisë së Bujqësisë për grurë kanë përfituar 752 fermerë, derisa janë shpërndarë mbi 203 mijë kilogram grurë.

Ramadani ka falënderuar kryetarin Haziri për mbështetjen e madhe edhe për vitin e ardhshëm, ku buxheti i kësaj drejtorie do të jetë hiç më pak se 1 milionë euro.

Komuna e Gjilanit nderon z. Ilir Meta me titullin “Qytetari nderi”

25 nëntor 2014

Me iniciativën e Lutfi Hazirit, kryetar i Gjilanit, Kuvendi Komunal ka nderuar me çmimin “Qytetar Nderi” kryetarin e Kuvendit të Shqipërisë, z. Ilir Meta. Ky çmim atij iu dha me motivacion “për kontributin e jashtëzakonshëm si Kryeministër i Shqipërisë për strehimin e shqiptarëve nga Kosova dhe Gjilani në veçanti, në Republikën e Shqipërisë në kohën kur Kosova po përjetonte spastrim etnik në vitin 1999, për ndihmën e dhënë në Pavarësinë e Kosovës dhe për vizitën e tij për herë të parë në Gjilan”.



Fillimisht, kryetari i Kuvendit të Shqipërisë Ilir Meta është pritur në zyrën e tij nga kryetari Lutfi Haziri, kryesuesja e Kuvendit Komunal, Valentina Bunjaku Rexhepi, dhe nënkryetari Rexhep Kadriu, derisa në takim kanë qenë të pranishëm edhe përfaqësues nga policia, gjykata, prokuroria, FSK, Bashkësia Islame, “Don Bosko” si dhe deputetë të Gjilanit në Parlamentin e Kosovës.

Haziri: Jam i nderuar që e kemi për vizitë mikun tim të hershëm Ilir Meta



Më pas kryetari kryetari Haziri dhe z. Meta kanë zhvilluar një takim me përfaqësuesit e lëvizjes “Vatra”, për t’iu drejtuar pastaj gazetarëve në konferencën për media. “Sot e kemi nderin që e kemi për vizitë z. Ilir Meta, apo më mirë të them mikun tim, me të cilin njihem nga rinia e hershme, në rrethana krejt tjera. Sot jam i nderuar që po e pres dhe po e njoftoj për zhvillimet në Gjilan,

një vizitë ditore pune, e cila na nderon në javën e festave në Gjilan. Sot është java Kuq e Zi e Gjilanit. Në kuadër të Javës së Flamurit, ne nderojmë edhe udhëheqësin tonë të luftës për pavarësi, Idriz Seferin, i cili në atë kohë me luftëtarët e tij, arriti të çlirojë kryeqytetin e Vilajetit të Kosovës, dhe bashkëluftëtarët e tij, martirët e Karadakut, dëshmorët e Gjilanit, kudo që janë ata, të cilët luftuan për pavarësi dhe për lirinë e të gjithë shqiptarëve. Natyrisht se ky nëntor është i madh, por për Gjilanin, është edhe i dhimbshëm, sepse liria e asaj kohe u pagua me jetën e shumë dëshmorëve dhe martirëve të kësaj ane”, është shprehur kryetari Haziri në konferencën për media.

Meta: Gjilani është një etalon i integritetit dhe kjo tregon vizion, emancipim, tolerancë dhe mençuri

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta e ka nisur konferencën me fjalët “për flamurin e Skënderit, luftojnë djemtë e Idriz Seferit”, duke vlerësuar sakrificën e dëshmorëve të Gjilanit për të mirën e përgjithshme. Meta ka falënderuar kryetarin Haziri dhe Kuvendin Komunal të Gjilanit për mikpritjen dhe për frymën e bashkëpunimit dhe tolerancën që mbretëron në Gjilan. “Për flamurin e Skënderit, luftojnë djemtë e Idriz Seferit.

Doja ta nisja kështu këtë konferencë shtypi, për të shprehur mirënjohjen time si kryetar i Kuvendit të Shqipërisë për atë kontribut të jashtëzakonshëm që populli i Gjilanit dhe i Anamoravës ka dhënë për çështjen kombëtare, jo vetëm për lëvizjen kombëtare të Idriz Seferit, por edhe për shpalljen e pavarësisë në Vlorë. Për shqiptarët kudo ku jetojnë, ditë më të mira po vijnë, falë atyre sakrificave që kanë bërë të parët tanë, por edhe falë atij vizionin që ne të gjithë së bashku po tregojmë për një të ardhme europiane. Dua të falënderoj kryetarin e Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, një mik shumë i mirë i imi prej kohësh, Kuvendin Komunal të Gjilanit dhe institucionet tjera, për mikpritjen e tyre për frymën e bashkëpunimit dhe tolerancës që tregojnë

këtu dhe është vërtet një shembull se si punojnë dhe bashkëpunojnë për të mirën e përbashkët. Gjilani është një shembull sa i takon tolerancës ndër etnike, është një etalon, do të thosha, i integritetit dhe kjo tregon vizion, tregon emancipim, tregon tolerancë dhe tregon mençuri”, ka deklaruar kryetari i Kuvendit të Shqipërisë. “Faleminderit z. Haziri për mikpritjen e jashtëzakonshme të treguar për vëllezërit tanë të shpërngulur Presheva, Bujanoci dhe Medvegja”. Ai ka falënderuar kryetarin Haziri për mikpritjen e jashtëzakonshme të treguar për vëllezërit tanë të shpërngulur Presheva, Bujanoci dhe Medvegja.

“Një falënderim të veçantë e kam për z. Haziri për mikpritjen e jashtëzakonshme të treguar për vëllezërit tanë të shpërngulur Presheva, Bujanoci dhe Medvegja. Dihet të peshën më të madhe të kësaj mikpritje në Kosovë dhe në mbarë trevat shqiptare, e ka përballuar populli i Gjilanit dhe Komuna e Gjilanit. Kjo meriton jo vetëm mirënjohje, por jam i bindur që meriton edhe më shumë mbështetje”, është shprehur Meta.

Numri një i Kuvendit të Shqipërisë theksoi se në takim me kryetarin Lutfi Haziri është diskutuar për të shtuar bashkëpunimin edhe në të ardhmen në disa fusha të rëndësishme..



“Ne kemi diskutuar edhe për të shtuar bashkëpunimin edhe në të ardhmen. Dihet që Gjilani ka tashmë një Universitet dhe është një mundësi shumë e mirë për të rritur shkëmbimet në këtë drejtim, midis pedagogëve të fushatë të ndryshme, midis studentëve për ta shndërruar Gjilanin në

një qendër të mendimit dhe debatit për tema që kanë të bëjnë me zhvillimin, perspektivën, ashtu sikurse kemi rënë dakord për të parë edhe shumë mundësi tjera, të cilat do të shtojnë bashkëpunim në fushën ekonomisë, tregëtisë, bujqësisë dhe të ushqimit dhe natyrisht të arsimit dhe të kulturës”, theksoi z. Meta. Ndërkohë, kryetari i Kuvendit të Shqipërisë ka vizituar gjimnazin “Zenel Hajdini”, ku ka bashkëbiseduar me nxënësit dhe mësidsmhdënësit e kësaj shkolle. Meta ka ftuar 40 nxënësit më të suksesshëm të Gjimnazit që ta vizitojnë Tiranën, për të shkëmbyer përvoja me shkollat atje

Arsyetimi për shpalljen “Qytetar Nderi” të z. Ilir Meta

“Për mbështetje të fuqishme të proceseve për shpalljen e Pavarësisë së Kosovës, për kontributin e jashtëzakonshëm për lobimin në qarqet diplomatike për njohjen e Pavarësisë së Kosovës, për avancimin e iniciativave për zhvillimin demokratik në rajon, për mbështetjen dhe integrimin e Kosovës në strukturat euroatlantike, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, në seancën solemne të mbajtur më 24.11.2014, shpall “Qytetar Nderi të Komunës së Gjilanit” kryetarin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë z. Ilir Meta”, ka thënë Bunjaku Rexhepi. Kryetari i Komunës së Gjilanit, pasi i ka dorëzuar çmimin z. Ilir Meta, tha se akordimi i këtij titulli përbën një vlerësim për z. Meta, ashtu si për të gjithë shqiptarët e Shqipërisë dhe për mbarë bashkatdhetarët tanë kudo në botë. Është në nderin tonë, është në nderin e qytetarëve të Gjilanit që sot t’ia akordojmë çmimin e lartë “Qytetar Nderi i Gjilanit” z. Ilir Meta, kryetar i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Gjilani sot nderon z. Ilir Meta për kontributin e tij të si zëvendëskryeministër i Shqipërisë për strehimin e shqiptarëve nga Kosova dhe Gjilani në veçanti, në Republikën e Shqipërisë, në kohën kur Kosova po përjetonte spastrim etnik në vitin 1999; për ndihmesën e dhënë për Pavarësinë e Kosovës dhe për vizitën e tij për herë të parë në Gjilan”.

Haziri: Nderimi me këtë titull është vlerësim për kombin shqiptar dhe për historinë tonë

Kryetari Haziri pohoi se nderimi me këtë titull, është vlerësim për kombin shqiptar, është vlerësim për historinë tonë, është vlerësim për të gjithë ata që kanë dhënë kontribut për çështjen kombëtare, është vlerësim për Kosovën dhe Shqipërinë. “Z. Ilir Meta është ai që shkëlqeu me mendjen dhe vizionin e vet, duke e gdhendur emrin në faqet më të ndritura të politikbërjes së Shqipërisë. Vlerësimi për burrështetasin e Shqipërisë po ndodhë në prag kremtimit të 102-vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë, e cila është një festë për të gjithë shqiptarët, në Shqipëri, në Kosovë, në Maqedoni, në Mal të Zi, në Çamëri, në diasporë. Kjo ditë na bën të ndihemi më mirë, na bën të ndihemi më besimplotë, na bën të ndihemi më optimistë për gjithçka kemi arritur dhe për atë që do të realizojmë në të ardhmen. Prandaj dhe unë pata kënaqësinë që në emër të të gjithë qytetarëve të komunës Gjilanit t’i dorëzoj këtë titull, duke i thënë: Faleminderit z. Ilir Meta për kontributin tënd. Gjilani dhe mbarë Kosova ndihen krenarë me ty!”, është shprehur i pari i Komunës së Gjilanit.



Meta: Titullin “Qytetar Nderi” e konsideroj detyrim për të bërë më shumë për Gjilanin dhe Anamoravën

Në akademinë e dhënies së çmimit, Ilir Meta mbajti një fjalim, ku tha se titullin “Qytetar Nderi” e konsideron një detyrim për të bërë më shumë që qyteti i Gjilanit dhe Anamorava të kthehen në një qendër shumë të rëndësishme jo vetëm për Kosovën, por për mbarë hapësirën tonë kombëtare.

Ai po ashtu shprehu bindjen se mund të bëjmë shumë më tepër në bashkëpunimin mes Shqipërisë e Kosovës dhe në shndërrimin e Gjilanit në një qendër të zhvillimit e bashkëpunimit rajonal duke pasur në konsideratë që Gjilani është në qendër të trekëndëshit që lidh Gjilanin me Preshevën dhe Kumanovën. Ai tha se populli shqiptar i Anamoravës gjithmonë ka lindur heronj, patriotë dhe luftëtarë të denjë për t’i prirë këtij populli drejt lirisë dhe çlirimit, për të luftuar kundër shovinizmit dhe diskriminimit. “Ne jemi sot këtu për të nderuar historinë, historinë e gjithë shqiptarëve, por në veçanti edhe historinë që lidhet me bijtë më të shquar të Gjilanit dhe të Anamoravës. Jemi këtu për të nderuar Idriz Seferin, këtë atdhetar ndër më të shquarit, udhëheqës

ushtarak popullor, i Rilindjes Kombëtare, i cili së bashku me Isa Boletinin, Bajram Currin dhe shumë patriotë të tjerë, u shndërruar në legjenda të mbarë popullit shqiptar, shtoi Meta. Ai tha se “rajoni i Gjilanit është shquar edhe në të gjithë luftërat e tjera, sidomos kur territoret shqiptare mbetën jashtë shtetit shqiptar pas copëtimit që u bëri Konferenca e Londrës. Ata janë shumë. Është një popull i tërë, por do të doja të përmendja disa prej tyre, Mulla Idriz Gjilanin e Ramiz Cërnica, që nuk i bëjnë nder vetëm Gjilanit dhe Anamoravës, por mbarë kombit, tha Meta. Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë tha se “ka shumë për të thënë për këto figura të shquara, por unë do të mjaftohem vetëm në dy thënie të tyre që kanë ardhur deri në ditët tona. Amaneti i Mullai Idriz Gjilanit ishte: “Kemi tre fe, por kemi një atdhe të përbashkët, një gjak vëllazëror, një gjuhë, një diell dhe një Zot. Detyrë mbi detyra kemi bashkimin dhe mbrojtjen e atdheut”. Dhe është kjo filozofi, është ky patriotizëm, është kjo mençuri që na bën të mundur që ne sot të festojmë jo vetëm 102 vjetorin e ngritjes së flamurit në Vlorë, por të festojmë edhe pavarësinë dhe lirinë e Kosovës. Ndërsa i madhi Ramiz Cërnica do të mbetet në kujtesën e kombit tonë për qëndrimin e tij të mbajtur në Kuvendin e Kosovës në korrik 1945, kur ai kërkoi bashkimin me Shqipërinë të cilën e pagoi me syrgjynosjen dhe jetën e tij”. “Ju e njihni më mirë, por unë do të doja të përmendja këtu emrat e bijve tuaj të shquar si Metush Krasniqi, Kadri Halimi, Rexhep Malaj, Nuhi Berisha, Kadri Zeka, Agim Ramadani etj. Të gjithë këta emra kanë bërë histori, një histori që i bën nder Gjilanit dhe Anamoravës, por që na bën nder të gjithë shqiptarëve kudo ku jemi dhe jetojmë. Do të doja të përmendja edhe një herë të paharruarin Kadri Zeka, i cili së bashku me Jusuf Gërvallën dhe patriotë të tjerë bënë gjithçka për të mbajtur të gjallë frymën e lirisë dhe të çlirimit në emigracion, gjë që e paguan me jetën e tyre të re”, ka thënë kryetari i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta, pasi mori çmimin “Qytetar Nderi i Gjilanit”

Valentina Bujaku-Rexhepi: Respektimi i barazisë gjinore fillon nga familja

26 nëntor 2014

Valentina Bunjaku-Rexhepi, kryesuese e Kuvendit Komunal, duke folur në një tubim të Shoqatës “Psikoterapeutët në Veprim” kundër dhunës në baza gjinore, ka thënë se i vjen mirë që gratë e Gjilanit nuk po ndalen duke punuar për përmirësimin e pozitës së tyre dhe ka premtuar përkrahjen e institucioneve komunale për aktivitetet që kanë për qëllim avancimin e barazisë gjinore në shoqëri.



Realisht në Gjilan dhe Anamoravë është krijuar një klimë dhe një ambient i mirë për nënat, për motrat tona dhe për fëmijët tanë, ka thënë Bunjaku-Rexhepi, duke shtuar se barazia gjinore, realisht fillon prej familjes. “Qytetarët janë vetëdijesuar tashmë se djali dhe vajza janë të barabartë në familje. Në familje krijohet baza e kulturës ndaj barazisë

gjinore dhe kjo vlerë pastaj bartet edhe në shkollë, rreth jetësor dhe kudo në shoqëri”, ka thënë ajo. Debatet e tilla janë të nevojshme për të ndikuar në ngritjen e vetëdijes shoqërore në kuptimin e respektimit të njëri-tjetrit dhe përjashtimit të dhunës ndaj secilës gjini. Përndryshe, Bunjaku-Rexhepi ka marrë pjesë edhe në promovimin e një doracakut për strehimoret e viktimave të dhunës në familje, të organizuar nga Shoqata “Liria”, ku ka thënë se dëshira jonë është që në Kosovë të mos ketë asnjë rast të dhunës në familje. Ndërkaq, Sevdie Haziri-Musliu, drejtoreshë e Shoqatës “Psikoterapeutët në Veprim” tha se qëllimi i kësaj fushate është sensibilizimi i popullatës që dhuna në baza gjinore nuk është e pranueshme. Gjithashtu përmes kësaj fushate, tentohet vetëdijesimi i personave që kanë përjetuar dhunë në familje, që t’i adresojnë problemet e tyre në organet përkatëse si në Polici, Qendër për Mirëqenie Sociale dhe Strehimore. Ajo ka thënë se ky projekt, që financohet nga Ambasada Holandeze në Prishtinë, do të përfshijë komunat Gjilan, Kamenicë, Viti, Ferizaj, Novobërdë, Ranillug si dhe fshatin Shillovë dhe do të zhvillohet në bashkëpunim me organizata tjera të shoqërisë civile.

Komuna e Gjilanit organizon koncert të madh me Ansamblin Kombëtar “Shota”

Gjilan, 27 nëntor / Nën organizimin e Komunës së Gjilanit, sonte në Teatrin e Qytetit të Gjilanit është mbajtur koncerti festiv me Ansamblin Kombëtar “Shota”, me moton “Valo Flamuri ynë Kombëtarë”, për të shënuar festën e flamurit kombëtar dhe 102 vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë.



Në këtë mbrëmje muzikore i pranishëm ishte edhe kryetari i Komunës së Gjilanit Lutfi Haziri, kryesuesja e Kuvendit Komunal Valentina Bunjaku – Rexhepi, drejtorët e drejtorive komunale dhe përfaqësues të institucioneve lokale e qendrore.

Me këtë rast kryetari Haziri në cilësinë e nikoqirit të kësaj mbrëmjeje, para të pranishmëve ka thënë se sonte në këtë mbrëmje kulturore kujtojmë 70 vjetorin e masakrës së Gjilanit.

“Gjilani 70 vjet më parë gjatë Luftës së Dytë Botërore ka pësuar shumë. Sonte dua ta ndaj me ju njërin nga njerëzit, i cili ka bërë shumë për luftën për liri, një luftëtar i cili ka qenë shkaktar i lëvizjes së madhe për të drejtat e shqiptarëve jo vetëm në Kosovë por kudo që jetojnë ata, pra është fjala për Mulla Idriz Gjilanin, që sonte këtu të pranishëm janë pasardhësit e tij”, ka thënë kryetari Haziri për të vazhduar me thënien epike të Mulla Idriz Gjilanit.

“Kemi tre fe, por kemi një atdhe të përbashkët, një gjak vëllazëror, një gjuhë, një diell dhe një zot. Detyrë mbi detyra kemi bashkimin dhe mbrojtjen e atdheut”.

Ndryshe në këtë mbrëmje kryetari i Komunës së Gjilanit nga Ansambli Kombëtar “Shota”, është shpërblyer me mirënjohje për kontributin e dhënë në fushën e kulturës sa ishte Ministër i Kulturës në Qeverinë e Kosovës.

Më pas Ansambli “Shota” ka vazhduar me programin e përgatitur me këngë folklorike dhe valle me karakter kombëtar.

Po ashtu sot gjatë ditës është mbajtur edhe festivali i këngës për fëmijë “Dëbora”.

Gjilani e Fieri bashkëpunim të frytshëm në fushën e artit

13 dhjetor 2014

Shkolla e Mesme e Artit Pamor të Gjilanit dhe Muzikës kanë shënuar bashkëpunimin e parë me Shkollën e Mesme Artistike “Jakov Xoxa” nga Fieri i Shqipërisë, përmes një koncerti muzikor dhe të hapjes së ekspozitës së përbashkët në Gjilan.

E pranishme në këtë ngjarje ka qenë kryesuesja e Kuvendit Komunal, Valentina Bunjaku Rexhepi, përgjegjësi për Kulturë, Rini dhe Sport, Bujar Haziri, drejtori i DKA-së, Nazmi Musa, drejtorët e shkollave të sipërpërmendura të artit e muzikës si dhe nxënës, profesorë e dashamirë të artit të Kosovës e Shqipërisë.



Në emër të kryetarit Haziri dhe Kuvendit Komunal foli kryesuesja Valentina Bunjaku Rexhepi, e cila i përgëzoi të dy shkollat për bashkëpunim të mirë, duke thënë se ky bashkëpunim na bënë krenarë.

Ajo kujtoi faktin mbajtjes së fjalës së kryetarit Lutfi Haziri sa i përket dhënies së ish-objektit të kryetarit për Muzeun e Gjilanit, në të cilin objekt tashmë po zhvillohen aktivitete të shumta kullore e artistike.

“Kur kemi artistë të pranishëm të këtij niveli është vështirë të gesh fjalë sepse puna e tyre flet vetë. Unë ju përgëzoj për këtë bashkëpunim për këtë ekspozitë e koncert që e dëgjuam. Uroj që bashkëpunime të tilla të ketë edhe në sfera të tjera, në arsim, sport e etj”, tha Bunjaku Rexhepi.

Përgjegjësi i njesisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Bujar Haziri, theksoi kjo ngjarje e sotme i paraprinë festivalit me karakter mbarëkombëtar “Flaka e Janarit 2015”, i cili do të jetë tejet i pasur në nivel artistik.

Drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit, Nazmi Musa, tha se shpreson që në të ardhmen kjo fushë e kulturës dhe e bashkëpunimit të ngritet në një shkallë shumë më të lartë.

Drejtorët e dy shkollave profesionale, Zejnulla Zejnullau i Gjilanit dhe Enrik Mareku i Fierit, u ndanë shumë të kënaqur me bashkëpunimin dhe premtuan se ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Interesim i madh i qytetarëve në Debatin Publik, i pesti dhe i fundit për vitin 2014

15 dhjetor 2014

Kryetari i Komunës së Gjilanit Lutfi Haziri, së bashku me nënkryetarin Rexhep Kadriu, kryesuesen Valentina Bunjaku Rexhepi dhe drejtorët komunal kanë mbajtur Takimin Publik, i pesti dhe i fundit me qytetarët për vitin 2014.

Para një numri rekord të të pranishmëve, kryetari Lutfi Haziri ka folur për peripecitë e para që është përballur në punën e tij me të marrë mandatin, sic janë borxhet e trashëguara, borxhet kontingjente që kryesisht janë për shpronësime të lumit “Mirusha” dhe borxhet e ‘këqija’ që nuk janë menaxhuar mirë.



“2 milionë euro borxhe më pak”

“Mbi 2 milionë euro janë shlyer borxhet në këtë vit, derisa në këtë mënyrë do të vazhdojmë t’i shlyejmë të gjitha borxhet e gjetura”, ka thënë Haziri.

Kreu i Komunës së Gjilanit tha se është punuar shumë në kthimin e besimit të donatorëve të huaj sepse në këtë mënyrë

zhvillohet ekonomia dhe përfitojnë qytetarët tanë.

“Kemi investime nga qeveria zvicerane kryesisht në ujëra, pastaj kemi partneritet me “Danidan” e Danimarkës, me qeverinë suedeze, pastaj Gjilani ka përfituar dy projekte të Komisionit European për rregullimin e parkut në lagjen “Dardania” dhe atë për bashkëpunim ndërkufitar me Komunën e Çairit nga Maqedonia. Domethënë, kemi punuar me ngulm për t’i bindur donatorët se paraja publike po menaxhohet si duhet”, tha kryetari Haziri.

Apelohen qytetarët që të paguajnë tatimin në pronë

I pari i Komunës së Gjilanit tha se aktualisht qytetarët e Gjilanit i kanë borxh në tatim në pronë Komunës së Gjilanit 9 milionë euro, duke bërë thirrje që të paguajnë obligimet qytetare, e që kjo

përkthehet me investime të mëdha në të gjitha lagjet e fshatrat e Komunës së Gjilanit.

Haziri tha është lajmi i mirë që Komuna e Gjilanit ka arritur t'i thej kufijtë buxhetor të përcaktuara më herët nga qeveria, duke e rritur buxhetin komunal për 4.2 milione euro.

1.2 milionë janë të destinuara për bujqësinë për vitin 2015

1.2 milion euro janë të destinuara vetëm për bujqësinë, derisa të tjerat shkojnë në arsim, shëndetësi, kulturë, sport, rini e në sektoret të tjera.

Ai tha se së bashku me deputetët e të gjitha subjekteve politike do të punohet që edhe më shumë të vijnë investimet nga qeveria, derisa nënvizoi se gjatë kësaj periudhe ka arritur ka kthej vëmendjen e Prishtinës në Gjilan, ku pritet që në vitin e ardhshëm të nis autostrada si dhe rregullimi i hyrje-daljeve të qytetit.

Mbi 7000 qytetarë janë pritur në Komunën e Gjilanit brenda vitit 2014

Kryetari i Komunës së Gjilanit pohoi se gjatë mandatit mbi 7000 qytetarë i ka pritur në Zyrën e tij dhe në drejtoritë e Komunës, ku kërkesat kryesore të tyre kanë qenë kryesisht për zgjidhjen e problemit të banimit dhe punësimin.

Vec tjerash, Haziri është shprehur se Komuna e Gjilanit ka ndarë 100 mijë euro për familjet në nevojë, ndërsa pas mbrëmjes humanitare janë deponuar afro 80 mijë euro dhe mbi 15 mijë franga zvicerane nga njerëzit e vullnetit të mirë.

Tri shtëpitë kanë nisur të ndërtohen për njerëzit në nevojë, për të vazhduar edhe më të tjera, ndërkohë që brenda pak ditësh do të nis meremetimi i shtëpive sipas kërkesave të qytetarëve.

500 deri në 2000 euro kush e lajmëron korrupsionin

Kryetari Lutfi Haziri ka inkurajuar qytetarët që të lajmërojnë korrupsionin apo keqpërdorimet eventuale, duke premtuar shpërblim nga 500 deri në 2000 euro.

Haziri përmendi punët e mëdha në katërshen e madhe infrastrukturore, ndërsa ka thënë se me dinamikë edhe më të madhe do të vazhdoj t'i përmbush zotimet e tij që ta heq lloçin dhe vadat.

Ndërsa qytetarët si Shaban Terziu, Daut Ademi, Bexhet Murtezi, Fadil Ramadani, Maksut Limani dhe qytetarë të tjerë, janë interesuar kryesisht për investimet dhe projektet për lagje dhe fshatra në përgjithësi, për rregullim të rrugëve, ujësjellësit, kanalizimeve, trotuareve, rastet sociale, shërbimeve shëndetësore, brengën e punësimit etj.

Kurse nga ana e tyre kryetari Haziri dhe drejtorët e drejtorive Komunale u kanë dhënë përgjigje duke i informuar ata me punët që janë bërë, projektet të cilat janë në proces të fillimit të realizimit, dhe projektet tjera që do të nisin gjatë të ardhmes.

Ndryshe, qeverisja e Komunës së Gjilanit me kryetarin Lutfi Hazirin në krye, është e hapur për të gjitha ata të cilët kërkesat e tyre nuk kanë mundur t'i prezantojnë në këtë tubim, qoftë për shkak të largësisë, por edhe për shkak të angazhimeve në punë, që këtë ta bëjnë në zyrat e drejtorive komunale apo edhe direkt në zyrën e kryetarit.

Asfaltohen rrugët edhe në lagjen dheu i bardhë

18 dhjetor 2014

Drejtori për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim, Sokol Haziri, me bashkëpunëtor kanë inspektuar punimet ku është duke u bërë asfaltimi i disa rrugëve në lagjen “Dheu i Bardhë”, të cilat prej kohësh ishin shndërruar në degradim të lagjes, duke krijuar vështirësi në jetën e banorëve të kësaj lagjeje.

Me këtë rast drejtori Haziri, ka thënë se përkrah shumë punëve që janë duke u bërë në gjithë hapësirën e Komunës së Gjilanit në investime në infrastrukturë bazike, edhe në lagjen Dheu i



Bardhë pas disa rrugëve tashmë të asfaltuara po asfaltohen edhe rrugë të tjera, që në të njëjtën kohë ngritin vlerën e pronës private por edhe lehtësojnë qarkullimin e qytetarëve.

“Shumë investime që janë duke u kryer në infrastrukturën e Komunës së Gjilanit në qytet dhe fshatra, po bëhen kryesisht në infrastrukturën bazike.

Sot jemi këtu në lagjen Dheu i Bardhë ku është duke u bërë asfaltimi i rrugëve në këtë lagje. Kur kemi vizituar gjatë këtij viti këtë rrugë sa ishte e pa – asfaltuar këtu më së paku i ngjasonte një rrugë, ndërsa sot shihet se kjo ka ndryshuar edhe pamjen e kësaj lagjeje. Vlera e pronës private tani e tutje ka tjetër nivel dhe ajo do të rritet edhe më shumë. Këtu është trajtuar edhe rrjeti i kanalizimit, ndriçimit, trotuareve, dhe tashmë po finalizohet me asfaltim të rrugëve. Kjo lagje pra po bëhet me infrastrukturë të kompletuar”, ka thënë drejtori Haziri.

Ndërsa, Nevzad Rushit, këshilltarë komunal dhe banorë i kësaj lagjeje ka thënë se punët që janë duke u kryer në këtë lagje po ndodhin meritueshëm për banorët të cilët kohë të gjatë nuk kanë pasur investime me kaq vëllim.

“Kjo është një punë shumë e madhe të cilën e vlerësojnë të gjithë qytetarët. Ne jemi falënderues ndaj Komunës së Gjilanit, për investimet që janë bërë në infrastrukturën bazike, si në kanalizime, ujësjellës, trotuare, ndriçim publik dhe tashmë edhe me asfaltim të rrugëve. Tani lagja “Dheu i Bardhë”, ka nisur të merr pamjen e një lagjeje të qytetit”, ka thënë ai ndër të tjerash.

Mbi 500 bujq të komunës së Gjilanit marrin pjesë në shpalosjen e platformës për bujqësinë për vitin 2015

Gjilan, 22 dhjetor 2014

Në prani të mbi 500 bujqve të Komunës së Gjilanit, Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë ka shpalosur sot platformën për Bujqësinë për vitin 2015, ku i pranishëm ka qenë shefi i Kabinetit të kryetarit Haziri, Arbër Ismajli, drejtori i Bujqësisë Ramiz Ramdani, si dhe zyrtarë komunal e përfaqësues të bizneseve prodhuese gjilanasë.



Haziri.

Në emër të kryetarit Haziri ka folur shefi i Kabinetit Arbër Ismajli, i cili tha për vitin 2015 Komuna e Gjilanit ka ndarë afro 1.3 milionë dhe kjo është dëshmia më e mirë se ky sektor vazhdon të jetë prioritet i qeverisjes

“Në emër të kryetarit Haziri ja falënderoj për pjesëmarrjen kaq të madhe këtu dhe kjo flet për angazhimin e drejtorisë së Bujqësisë dhe kryetarit Haziri për këtë sektor për vitet në vijim, i cili është sektori më i rëndësishëm të Komunës së Gjilanit. Këtë vit, Komuna ka investuar rreth 300 mijë euro në këtë sektor sepse pas marrjes së pushtetit e kemi pasur një vit të rëndë shkaku i borxheve të trashëguara, por pas shumë përmirësimeve dhe insistimit të drejtorit Ramadani që sektori i bujqësisë të jetë njëri ndër sektorët me prioritet të qeverisjes Haziri, mund t’ju them lirisht që planifikohet të ketë investime për vitin që vjen rreth 1 milion e 300 mijë euro”, ka thënë Ismajli.

Drejtori i Bujqësisë, Ramiz Ramdani, tha se gjatë këtij viti ka pasur sfida e suksese dhe me të gjitha kapacitetet komunale Komuna ia ka dalë që të subvencionoj të gjithë bujqit që kanë aplikuar.

Në shpалosjen e programit për të bujqësisë për vitin 2015, Ramadani tha se Drejtoria e Bujqësisë ka në program subvencionimin e sektorit e prodhimtarisë blegtorale, atë të bletarisë, do të shpërndahen makina elektrike për qethje të deleve, stabilimente për rregullimin e thundrave të lopët qumështore, pastaj është projekti i llaktofrizëve për ruajtjen e qumështit.

Poashtu, Ramadani paralajmëroi se për vitin 2015 ka në projekt furnizimin e blegtorëve me 100 krerë lopësh, rregullimin e tregut të kafshëve, impakti i projekteve në prodhimin shtazor, ndërkohë që do të ketë subvencione në sektorin e prodhimtarisë bimore, subvencionimi i fermerëve me foli plastike, pastaj subvencionimi me farë misri, farë gruri për të vazhduar me subvencione edhe në konstruksione metalike në serra, në mekanizëm bujqësor si: rotofrezë për traktor, atomizer për spërkatje, pa e harruar edhe sektorin e pemëtarisë.

Ramadani theksoi se edhe në vitin 2015 do të vazhdoj projekti i ndërtimit të rrugëve të arave, në mënyrë që bujqit ta kenë më të lehtë qarkullimin për t'i punuar tokat.

Para të pranishmëve ka folur edhe Lavdim Berisha, zëvendës menaxher i shërbimeve të “Procredit bank”, i cili vazhdimisht ka përkrahur aktivitetet komunale, duke thënë se edhe më tutje do të mundohemi që në plan të parë të vazhdojmë bashkëpunimin me të gjithë bujqit, duke e ditur se bujqësia është sektori që gjeneron më së shumti mirëqenie dhe me zhvillimin e bujqësisë.

Haziri: Gjaku i dëshmorëve, martirëve dhe heronjve të Gjilanit u bë dritë për të gjithë shqiptarët

22 dhjetor 2014

Nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës së Gjilanit Lutfi Haziri, është mbajtur Akademia përkujtimore në shënim të 70-vjetorit të masakrës së Gjilanit.

I pranishëm në këtë ngjarje ka qenë kryetari Lutfi Haziri, kryesuesja Valentina Bunjaku Rexhepi, familjarë të heronjve të kombit si dhe përfaqësues nga të gjitha nivelet nga jeta institucionale.

fjalën e tij, kreu i Komunës Lutfi Haziri tha se Gjilani sot nderon kolektivisht të gjitha viktimat, martirët, dëshmorët, heronjtë dhe njerëzit që kanë kontribuar dhe kanë qenë sinonim i lirisë, pavarësisë dhe bashkimit të shqiptarëve.

Esat Ymer Berisha dhe Halim Orana dekorohen nga presidentja Jahjaga me “Urdhrin e Lirisë”

Haziri bëri publik dekretin e Presidentës së Kosovës, e cila ia ka ndarë “Urdhrin e Lirisë” heronjve të kombit, Esat Ymer Berishës dhe Halim Oranës.

“Jam i nderuar, që sot presidentja në detyrë, përveç Mulla Idriz Gjilanit për të cilin është dhënë “Urdhri i Lirisë” për kontribut, ka vendosur që edhe Esat Ymër Berishës dhe Halim Oranës dhe qytetit të Gjilanit t’ia ndajë “Urdhrin e Lirisë”. Është hera e parë që një institucion komunal e merr në emër të 8000 viktimave “Urdhrin e Lirisë” si kontribut kolektiv të qytetarëve të saj. Ky kontribut kolektiv, përmes sakrificës së madhe, na bënë sot, që përveç që jemi të nderuar, t’i kujtojmë dhe t’i respektojmë të gjithë ata shpirta që po bëjnë dritë jo vetëm për ne, por bëjnë dritë për kauzën tonë që e kemi realizuar”, ka thënë kryetari Haziri.

Ai tha se sot 70 vjet, kur Europa lirohej e çlirohej nga okupimet e sundimet e fashizmit, shqiptarët e panë që liria nuk po vije, por okupimi po zëvendësohet me okupim tjetër.



“Sot në një ditë të veçantë, në një histori të dhimbshme, jemi takuar këtu për të filluar muajin e madh të homazheve, përkujtimeve, kujdesit, të gjunjëzimeve, të lutjeve dhe të falënderimeve ndaj njerëzve, që jo vetëm ne, jo vetëm familjet e pasardhësit e tyre, por të gjithë regjionit të Anamoravës, të gjithë

shqiptarëve kudo që janë i bëjnë krenar për reagimin e tyre, për kryengritjen e tyre për guximin dhe në fund për flijimin tyre. Sot 70 vjet, kur Europa lirohej e çlirohej nga okupimet e sundimet e fashizmit, shqiptarët e panë që liria nuk po vije, por okupimi po zëvendësohet me okupim tjetër. Duke qenë gjithmonë në ballë të thirrjes, që burra e gra të luftojnë për atdhe, për Zot e për vatan, për familje e për mbrojtjen e lirisë së shqiptarëve kudo që janë. Ajo thirrje e madhe e Mulla Idriz Gjilanit ka bërë jehonë të madhe, dhe natyrisht që jehona ka qenë aq e madhe sa që është arritur të mobilizohen prej Bujanocit e te Nasala, e gjithkund në gollak e Karadak, deri në Gjilan e Moravën e epërme, për ta ruajtur dhe rikthyer lirinë e kërkuar përkundër shtypjes së madhe e cila është paguar shtrenjtë. Këta emra të mëdhenj, qofshin luftëtarë, hoxhallarë, dijetarë, profesorë të kohës, apo njerëz që populli i ka dashur dhe u ka shkuar prapa, na kanë bashkuar neve sot”, ka vlerësuar kryetari Haziri.

Kryetari i Gjilanit tha se që ky muaj i homazheve, i lutjeve, ky muaj i ndezjes së qirave, simbolika e kujdesit dhe përkujtimit, na bënë që të mos e harrojmë të kaluarën, ku sipas historianëve, 60 për qind e popullatës së asaj kohe janë vrarë.

“Jam shumë i nderuar, që si kryetar i Gjilanit t’ju njoftoj që ky muaj i homazheve, i lutjeve, ky muaj i ndezjes së qirave, simbolika e kujdesit dhe përkujtimit, na bënë që të mos e harrojmë të kaluarën, ku sipas historianëve, 60 për qind e popullatës janë vrarë dhe nuk ka pasur mashkull

më të moshuar se 15 vjeç për shkak të represionit të madh. Ne duhet ta përkujtojmë këtë histori dhe këtë gjak, këtë lumë që nëpër Gjilan flitet e shkruhet se është mbuluar dhe ka rrjedh gjak të bashkëvendasve tanë. Unë e di që s'ka asnjë shtëpi në Gjilan nuk s'ka qenë e prekur prej kësaj masakre dhe prej këtij represioni dhe dënimi të asaj kohe. Ai gjak ka bërë dritë edhe pas 70 vjetëve dhe po bënë dritë dhe do të bëjë edhe pas 70 vjetëve të tjera dhe duhet ta ruajmë kujtimin”, ka shtuar kryetari Haziri.

Haziri tha se në mesin e të vrarëve në mbrojtje të kufirit dhe në thirrje të kryengritjes dhe rezistencës, është vrarë në Luftën e Dytë Botërore edhe gjyshi i tij, Hetem Haziri. “Në një vizitë para pak ditësh tek baca Gani Hajrullahu, me tha se ‘ke mbet borxh diçka, po i përmend të tjerët, por s’po e përmend diçka duhet ta thuash sepse je borxhli ndaj të parëve të tuaj’, dhe po e them se edhe unë e kam humb gjyshin Hetem Hazirin në Luftën e Dytë Botërore, unë jam nipi i tij, pasardhës i tij, i cili është vrarë në mbrojtje të kufirit shqiptar, në thirrje të kryengritjes dhe rezistencës dhe ai, poashtu, është djali i një të burgosuri të madh të kohës së tij për shkak të kryengritjes dhe bashkëluftëtar i Idriz Seferit. Po e përmend për ta larguar atë borxh, i cili që një javë po më sillet në kokë”, ka nënvizuar kryetari Haziri.

Kreu i Gjilanit tha se amaneti i të gjitha viktimave, martirëve, dëshmorëve dhe heronjve nuk ka shkuar akoma deri në fund. “Ata për flamur, vatan dhe Zot kanë dashur që nën këtë flamur të bëhen bashkë të gjithë shqiptarët kudo që janë, të jetojnë dhe të fitojnë lirinë. Deri atëherë, kemi ende punë!”, ka deklaruar Haziri në Akademinë e sotme përkujtimore.

Kryetari Lutfi Haziri është shprehur se Gjilani do t'i kujtoj për një muaj dëshmorët, martirët dhe heronjtë si dhe mijëra të zhdukur që ende pas 70 vjetëve nuk dihet fati i tyre.

“Përveç kësaj Akademie përkujtimore, ju lus që një muaj ta ulim gëzimin pak, nuk do të gëzohemi sikur që gëzohen nahi të tjera në ndërrimin e motmoteve . Do të urojmë shëndet e të mira për çdo familje, por do t'i përkujtojmë shumë prej tyre, e në veçanti mijëra të zhdukur që ende pas 70 vjetëve nuk dihet fati i tyre. Gjilanit sot është në krye të historisë kudo që jetojnë shqiptarët. Le të kthehen pak kokën kah Anamorava, kah lufta e Gjilanit dhe kah lufta e udhëheqësve, patriotëve dhe heronjve të Gjilanit sepse ata njerëz, duke mbrojtur këtë vend, kanë çu mesazh deri në Janinë dhe kudo që kanë jetuar shqiptarët dhe trimëria e jehona e tyre, më së miri përshkruhet me “kushtrimin të Kosovës”. Ajo këngë, në kohën e Idriz Seferit ka qenë himn dhe thirrje për luftë, e cila ka vazhduar deri në ditët e sotme. I përjetshëm qoftë kujtimi për ta!”, ka përfunduar kryetari Haziri.

Në këtë Akademi iu referuan me kumtesat e tyre për 70 vjetorin e Masakrës së Gjilanit prof. dr. Fehmi Rexhepi, mr. Aliriza Selmani, MA. Blerim Haziri, prof. Reshat Ramadani dhe mr. Naim Musliu.

Akademia përkujtimore për 70 vjetorin e Masakrës së Gjilanit është mbyllur me disa pika muzikore të realizuara nga nxënësit e shkollës së muzikës në Gjilan.

Donatorët zotohen në përmbushjen e premtimeve për ndërtimin e shtëpive për njerëzit në nevojë në Gjilan

Gjilan, 26 dhjetor 2014

Donatorët që kanë premtuar ndërtimin e shtëpive me çelësa në dorë janë zotuar sot para autoriteteve komunale të Gjilanit që këto premtime janë të gatshëm t'i realizojnë menjëherë.

Në këtë mënyrë edhe po realizohet prioriteti i kryetarit të Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, që gjatë mandatit t'i zgjidhë problemet me strehim dhe banim.

Zotimet janë bërë sot në takimin në mes të Valon Shefkut, drejtor i Urbanizimit dhe i caktuar nga kryetari Haziri për implementimin e projektit për strehim dhe banim, Hazir Mustafa, kryesues i Komisionit ad hoc dhe drejtorit të QPS, Mursel Zymberi me donatorët që kanë premtuar ndërtim të shtëpive: Abdyl Brestovci- "City Projekts", Jeton Hyseni – "Ceni Company", Selman Sylejmani, Sabri Bunjaku si dhe Jashar dhe Nexhat Zymberi.



Drejtori i Urbanizimit Valon Shefkut, pasi i ka falënderuar të pranishmit për zotimet e tyre, ka thënë Komuna e Gjilanit do të vazhdojë ta implemtojë projektin për strehim social për t'ua ndërtuar shtëpitë familjeve në nevojë, në mënyrë që të bëjnë jetë të dinjitetshme.

Kryetari i Komisionit ad hoc, Hazir Mustafa tha se tashmë kanë nisur së ndërtuari 3 shtëpitë e para, duke filluar nga ajo e Zijadin Marovcës nga donatori i cili është lajmëruar pas mbrëmjes humanitare "Pak nga ne, shumë për ata" Ruzhdi Bunjaku, Nevrije Kërçelit me donator kompaninë "CDC" dhe Astrita Mustafës me donacion të Jashar dhe Nexhat Zymberit.

Edhe pronari i kompanisë "Fluidi" nga Gjilani, Fejzulla Mustafa, ka konfirmuar ndërtimin e dy shtëpive, sikurse edhe pronari i "Vali Ranch", Fehmi Fetahu për një shtëpi.

Përveç ndërtimit të shtëpive, tashmë ka nisur edhe meremetimi i shtëpive sipas kërkesave të qytetarëve të Komunës së Gjilanit.

Ndryshe, Komuna e Gjilanit i ka ndarë 100 mijë euro për zgjidhjen e problemit të strehimit dhe banimit, ndërsa deri tash në fondin humanitar të Komunës së Gjilanit janë deponuar nga njerëzit e vullnetit të mirë mbi 82 mijë euro dhe mbi 15 mijë franga dhe çdo deponim është bërë publik të ueb faqen zyrtare të Komunës së Gjilanit.

Në Gjilan hapet Zyra për Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë - Haziri mban premtimin

30 dhjetor 2014

Komuna e Gjilanit ka hapur sot zyrtarisht Zyrën për Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, e cila ka qenë premtim i kryetarit të Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, në fushatën elektorale të vitit të kaluar.

Në ceremoninë e hapjes ka marrë pjesë kryetari Lutfi Haziri, kryesuesja Valentina Bunjaku Rexhepi, kryetari i lëvizjes “Vatra”, Sejdulla Kadriu, zëvendësministri në detyrë i MPB-së, Izmi Zeka, drejtori i Zhvillimit Ekonomik i Komunës së Bujanocit, Nexhat Behluli si dhe asambleistët e Kuvendit Komunal të Gjilanit.



“Sot me këtë rast sipas vendimit të Kuvendit dhe Rezolutës për Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, ne po e hapim sot këtë Zyrë. Është realizuar sot një borxh i vogël ndaj bashkëqytetarëve tanë për të drejtat civile, për të drejta të barabarta dhe për mundësi të barabarta në Gjilan që do t’i garantojmë bashkë. Është vetëm një zyrë që fillon t’i grumbulloj dhe t’i administroj problemet, për t’i

përcjellë në qeveri për të ndikuar në ndryshim të ligjit dhe rregullim të dokumentacionit. Komisioni i Kuvendit Komunal, poashtu do të jetë për bashkëpunim dhe do të udhëhiqet nga këshilltari komunal, njeriu i cili është marrë me dekada për këtë punë, Sejdulla Kadriu, ndërsa koordinator i përkohshëm i kësaj zyre do të jetë dikush që punon në Komunën e Gjilanit”, ka thënë me këtë rast kryetari Lutfi Haziri.

Kryetari i Lëvizjes “Vatra” Sejdulla Kadriu ka falënderuar kryetarin Haziri për kontributin e tij të madh për Kosovën Lindore, ndërsa u shpreh i bindur se që “kjo Zyrë do të jetë një dritare e vogël që do t’i mbrojë interesat e komunitetit që jeton këtu dhe për edhe pakicës kombëtare që jeton në trojet etnike shqiptare – në Kosovën Lindore”.

Nga ana e tij, zëvendësministri në detyrë, Izmi Zeka, tha se institucionet komunale në krye me z. Haziri dhe qeverinë e Kosovës tashmë kanë filluar një përkushtim më esencial për pjesën e

Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës, duke vlerësuar se ky është vetëm një hap i madh dhe pritet të ketë reflektime të mëdha.

“Ne jemi vëllezër dhe për herë të parë po e them që e pres që një ditë edhe Presheva, Bujanoci dhe Medvegja të jetë pjesë e territorit të Kosovës”, tha Zeka.

Ndërsa, drejtori i Zhvillimit Ekonomik i Komunës së Bujanocit, Nexhat Behluli, theksoi se ndihet mirë që kryetari Haziri ka realizuar premtimin, duke uruar që të jetë i mbarë ky fillim i komunikimit dhe bashkëpunimit edhe në të ardhmen.

Haziri: Kaluam një vit jashtëzakonisht të vështirë sepse kemi shlyer mbi 2 milionë euro

30 dhjetor 2014

Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka paraqitur sot raportin nëntëmujor të punës së tij para asambleistëve të Kuvendit Komunal të Gjilanit.

Gjatë seancës së fundit për vitin 2014, Haziri ka falënderuar të gjithë asamblistët, pozitë e opozitë, për rolin e tyre, për kritikën, sugjerimet e rekomandimet.

“Duke qenë autoriteti më i lartë ekzekutiv i zgjedhur drejtpërdrejt nga qytetarët, mua më ka bërë



të përgjegjshëm dhe vazhdoj të sillem si i tillë karshi Kuvendit Komunal, si organi më i lartë vendimmarrës dhe kontrollues i autoriteteve tjera që përfshin edhe Zyrën e Kryetarit dhe vetë kryetarin e Komunës, autoritet i cili po fuqizohet çdo ditë në ushtrimin e detyrave ligjore për dallim nga e kaluara. Jam falënderues për të gjithë këshilltarët komunal, pozitë e

opozitë, që janë të zgjedhurit e popullit për të kontrolluar, sugjeruar, monitoruar dhe shpesh herë për të qortuar Zyrën time dhe mua personalisht në realizimin e objektivave”, tha Haziri.

Duke folur për peripecitë e punës së tij gjatë kësaj periudhe kohore, kryetari Haziri tha se këtë vit e kaluam me një vështirësi të madhe shkaku i borxheve të trashëguara.

“Kaluar një vit jashtëzakonisht të vështirë në kuptimin buxhetor. Duke vendosur prioritetet që

lidhen me disiplinën e ashpër buxhetore, disiplinën e ashpër në punë dhe sjellja e zyrtarëve karshi detyrës, e në veçanti servisimin borxheve si barra kryesore për buxhetin tonë, ne kemi arritur që gjatë këtij viti të zbardhim tabelarin tonë dhe jo vetëm përballë qytetarëve, por përballë të gjithëve që përfshin qeverinë, donatorët e në veçanti njerëzit e Gjilanti, duke treguar qartë që angazhim serioz dhe me një përkushtim të përbashkët kemi arritur që t'i shlyejmë një numër të madh të obligimeve të trashëguara që nga viti 2009. Këto obligime nuk kanë përfunduar dhe po paralajmëroj se edhe viti i ardhshëm do të jetë barrë e njejtë në realizimin e këtij objekti. Shlyerja e 2 milionë eurove borxhe, që Komuna me ose pa vetëdije ka rrëshqitur në këto probleme, tregon qartë që ne dëshirojmë të lirohemi nga këto obligimet e Komunës dhe të fillojmë të planifikojmë ndërtim, zhvillim dhe prosperitet për qytetarët tanë. Natyrisht, që secili i zgjedhur në vitin e parë, do të kishte vendosur të punoj me 2 milionë euro, e jo t'i paguaj borxhet, por duke e pasur përvojën e jetës në zyre të tilla, e vecanërisht në Komunën e Gjilanit, pa asnjë hezitim kam vendosur që t'i shlyej të gjitha obligimet, të gjitha borxhet në mënyrë që të lirohemi nga kjo barrë, sepse siç thotë populli 'borxhi nuk pret ditë ët bardhë', ka shtuar Haziri.

Si sfidë tjetër gjatë këtij viti, Haziri ka përmendur edhe mbingarkesa e stafit, e cila ka qenë një barrë jashtëzakonisht e madhe për buxhetin e Komunës

“Sfida tjetër kryesore ka qenë mbingarkesa e stafit. Duke qenë Komunë e cila ka pasur 132 të angazhuar në punë, ka qenë një barrë jashtëzakonisht e madhe për buxhetin e Komunës, e cila ka marrë shumë mjete buxhetore. Lirimi nga këto obligime, zvogëlimi deri në pikën minimale, ka bërë që pjesa më e madhe e buxhetit të kursehet dhe të planifikohet një mënyrë tjetër e realizimit, apo të gjetjes së mënyrës për plotësimin e hapësirave të punës sepse, për shembull, shëndetësia primare dhe administrata ka nevojë për staf shtesë. Paralelisht kësaj, ne kemi arritur që përveç largimit të kësaj barre, si rekomandim edhe të auditorit të pavarur dhe ai i brendshëm, të krijojmë mundësi që ngarkesën plotësuese të stafit ta realizojmë me detyrë shtesë apo me punë sekondare të stafit të njejtë, kryesisht në zyrën e kryetarit. Më lejoni t'ju kërkoj falje që në këtë raport nuk është paraqitur puna e zyreve të kryetarit të Komunës, por kjo zyre bartë kryesisht detyrat sekondare apo shtesë të të gjithë stafit ne mungesë në administratë sepse është krijuar komoditeti nga ato pozita që ne më herët i kemi gjetur si pozita të 'ftuara' apo të kontraktuara për nevoja të ish-administratës”, ka thënë kreu i Komunës para asambleistëve të Kuvendit Komunal të Gjilanit.

“Problemi i cili i tejkalon të gjitha këto situata është thyerja e kufijve buxhetor. Ne, së bashku me ndihmën e këtij Kuvendi, me arsyetimin që e kemi paraqitur para qeverisë, e në veçanti mbrëmë pas funksionalizimit të Kuvendit të Republikës, kemi ndikuar që të miratohet një buxhet për Komunën e Gjilanit, i cili, thyen kufijtë për 4.2 milionë euro në kategoritë që vërtet kanë qenë zbraztësira serioze për investime në Komunën e Gjilanit, për rregullimin e stafit dhe sektorëve të mëdhenj siç është arsimi. Ne kemi arritur ta bindim qeverinë që thyerja e kufijve buxhetor për Gjilan është vetëm fillim i rehabilitimit të buxhetit dhe këtë do ta bëjmë edhe në të ardhmen. Në kategorinë e investimeve, Gjilani ka qenë i diskriminuar dhe i përjashtuar e në anën tjetër ka qenë i trajtuar e barabartë kur ka ardhur puna e prerjeve buxhetore në shërbime dhe mallra.

Thyerja e këtyre kufijve buxhetor, rehabilitimi i buxhetit tonë dhe shpresa që buxheti i vitit të ardhshëm të jetë buxhet i investimeve, tregon për një fillim të ri për qytetarët e Gjilanit sepse do të hapen korridoret, rrugë dhe investime për prosperitet që qytetarët e Gjilanit të kenë mundësi të barabartë qarkullimi dhe aksesit në të gjitha korridoret që i jep shteti ynë”, ka shtuar ai.

Problem tjetër me të cilën është përballur gjatë punës së tij, kryetari Lutfi Haziri ka thënë se është ai i mungesës së banimit dhe strehimit.

“Problemi tjetër që dua ta nënvizoj në këtë raport nëntëmujor është banimi. Përkundër që ekziston një numër i madh i shtëpive të zbrazura, e që janë pronarë mërgimtarët tanë, ndërkohë që ne kemi evidentuar një numër të madh të familjeve që janë pa banim. Sipas një grupi punues që është marrë me këtë punë gjatë tërë vitit, ne e kemi arritur ta kategorizuar banimin social, banimin si zgjidhje për disa familje sidomos për sektorin e arsimit apo shëndetësisë, apo shtresa e qytetarëve tanë që ka të ardhura por nuk ka banim të rregulluar dhe kategoria tjetër është banimi për çiftet e reja, që kanë problem serioz dhe është njëri nga problemet që duhet të trajtohet. Ne i kemi dhënë përparësi fondit social, duke vendosur fondin për këtë, duke organizuar solidaritet qytetar për zgjidhjen e këtij problemi dhe duke hyrë në aranzhman tripalësh, në mes të Komunës, donatorit dhe përfituesit në mënyrë që 120 familjet e para të përfitojnë në ndërtim të shtëpive, meremetim dhe pagesë për qira”, u shpreh ai.

Sa i përket investimeve në sektorin e bujqësisë, Haziri tha se kemi arritur që këtë vit t'i subvencionojmë të gjitha kërkesat për mbjelljet vjeshtore, ndërsa shtoi se për vitin 2015, përveç 1.2 milionë euro sa janë ndara, Komuna ka përfituar edhe 600 mijë euro të tjera nga një grant i Komisionit European.

“Bujqësia si sektor ka qenë në vëmendjen tonë në këtë nëntëmujor. Duke e parë se buxheti është problem kryesor, ne kemi arrit që edhe në rastin e këtij sektori të madh siç është bujqësia, ne kemi krijuar mundësi për të gjithë barabarësisht, pa kushte dhe pa kriteret e sforcuara që përjashtojnë shumë familje bujqësore, ne kemi arritur që edhe këtë vit t'i subvencionojmë të gjitha kërkesat për mbjelljet vjeshtore. Ndërsa, vitin e ardhshëm natyrisht se përveç buxhetit të planifikuar prej 1.2 milionë euro, ne jemi përfitues edhe të një granti të madh nga Komisioni European, si partner implementues me KE, prej 600 mijë euro, për sektorin e bujqësisë, në të cilin hyn edhe programi me qeverinë turke dhe programet me qeveritë tjera, duke e rritur fondin e bujqësisë dhe duke krijuar mundësi që të gjitha familjet që merren me bujqësi, përveç që kanë mundësi të subvencionohen me kosto zero, ne kemi mundësi t'i zgjedhim përfituesit, apo t'i zgjedhim vendbanimet, lagjet, fshatrat që i realizojnë këto programe 100%, ne do t'i ndajmë një grant prej 50 mijë euro për projekt komunitar”, ka thënë kryetari i Gjilanit.

Haziri tha se gjatë kësaj periudhe e kemi thyer vëmendjen së Prishtinës si kryeqytet politik dhe administrativ dhe i Tiranës në raport me Gjilanin ka qenë njëri prej aktiviteteve konkrete.

Duke qenë si njëra prej Komunave të anashkaluara edhe në raport buxhetor por edhe politik, ne kemi arritur që me një angazhim më serioz, me një arsyetim detal, ta kthejmë vëmendjen e kryeqytetit – Prishtinës, që nënkupton Qeverisë, Kuvendit dhe Presidencës në raport me Gjilanin duke i trajtuar njerëzit e saj në kuptimin buxhetor. Ne nuk kemi nevojë me na dashur askush më shumë apo më pak, kemi nevojë të trajtohem barabarësisht dhe natyrisht kemi nevojë të trajtohem në mënyrë të drejtë. Shpallja “Qytetar Nderi” i kryetarit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, i cili shënon vizitën e parë të një autoriteti të madh politik të Republikës së Shqipërisë, në Gjilan, për herë të parë në historinë e Gjilanit, tregon qartë që edhe Kuvendi Komunal, edhe ne si qytetarë të Gjilanit, nderohemi”, tha ai.

Ai tha se do të punojmë shumë që Gjilanit t’ia kthejmë edhe vëmendjen e partnerëve, miqve tanë që i kemi gjetur në këto 15 vjetët e fundit, kudo që janë në Europë, Amerikë, në mënyrë që Gjilani të ketë vëmendjen e atyre qeverive siç e ka edhe sot, duke e rritur edhe më shumë kujdesin për absorbimin e fondeve më të shumta, në absorbimin e të mirave dhe mundësive që këto shtete i ofrojnë për qytetarët e Kosovës.

Haziri theksoi se Gjilani duhet të jetë krenar për arritjen e shkallës së bashkëpunimit me qeverinë Amerikane që e ka nëpërmjet USAID-it në Kosovë, me GIZ-in Gjerman, me qeverinë Zvicerane, me Komisionin European në veçanti dhe me qeveritë e tjera që japin fonde për Ballkan dhe Kosovë, shumica absolute e tyre ka ndarë fonde për Komunën e Gjilanit.

“Vitin e ardhshëm këto fonde do të rriten, këto fonde nuk janë dhurata, por, fitohen duke konkurruar dhe duke e arsyetuar konkurrimin. Nuk marr pjesë në garën e “pështymave”, dhe nuk jam autoritet i zgjedhur i cili kopjoj apo të sillem karshi situatave me paragjykim. Në asnjë situatë nuk do të sillem jashtë asaj që jam rritur, jam kultivuar në jetën politike të Gjilanit. Kultura ime është lindë, është rrit dhe është pjekur në Gjilan. Nuk mund të sillemi në asnjë mënyrë tjetër pos ashtu siç janë qytetarët e Gjilanit, të përgjegjshëm, të sjellshëm, të kujdesshëm, në raport me njëri-tjetrin, në raport me ata që kanë mendim tjetër politik, në raport me ata që kanë etni tjetër, fe tjetër dhe besim tjetër”, tha Haziri.

Kryetari i Gjilanit theksoi se 35 projekte të ish-qeverisjes janë në hetime në prokurorinë speciale.

“Bëhet fjalë për projektet nga viti 2009 deri në 2013 dhe është çështje e hetuesve, çka bëjnë me ato lëndë, dhe njëra prej lëndëve është edhe Kodra e Dëshmorëve. Kjo është arsyeja që unë nuk dalë personalisht si kryetar Komune në atë vend të shenjtë me vendos lule, sepse ai vend, ai projekt është nën hetime. Derisa nuk kryhen hetimet, derisa nuk rregullohet ai park, na e pamundëson, le të bartin atë barrë ata të cilët e kanë sjellë situatën në këtë gjendje”, është shprehur kryetari Haziri.

AI informoi asambleistët e Kuvendit Komunal të Gjilanit se Raporti njëvjeçar do të vjen në seancën e parë të janarit, ku do të përfshijë edhe programin, angazhimin dhe formatin krejt tjetër nga ky raport.

Krejt në fund, Haziri tha se “më lejoni që deri në gjunjëzim t’i nderojmë të rënë në masakrën e Gjilanit, në veçanti, jam i nderuar që qyteti i Gjilanit, të masakruarit, të vrarit, dëshmorët, heronjtë, janë dekoruar me dekoratën “Urdhrin e Lirisë”, që e jep presidentja e Republikës dhe është një mirënjohje e veçantë për kontribut që për herë të parë shteti i Kosovës, ia atribuon të rënëve për liri Komunës së Gjilanit”.



KDI: Kuvendi Komunal i Gjilanit me nivelin më të lartë të transparencës në Kosovë-ekzekutivi i dyti

Gjilan, 13 nëntor 2014 - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) përmes një Transparometri të realizuar në Gjilan, Gjakovë, Prishtinë, Graçanicë, Prizren dhe Deçan, e ka nxjerrë Komunën e Gjilanit si e dytën në nivel vendi me transparencën më të lartë me 26.8 pikë nga 35 maksimale, duke e lënë pas Komunën e Prishtinës me 20.4 pikë, derisa Gjakova ka dalë e para në matjen kryesisht në katër fusha thelbësore të qeverisjes lokale.

Ndërsa, në matjen e transparencës vetëm për Kuvendin Komunal, Gjilani zë vendin e parë me transparencë në nivel vendi me 29.3 pikë, nga 35 maksimale, Gjakova me 23 pikë, Prishtina 17 pikë, Graçanica 22, Prizreni 20, derisa Deçani është vlerësuar me 24 pikë.

Në paraqitjen e rezultateve për transparencën nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), në emër të kryetarit Lutfi Haziri ka marrë pjesë kryesuesja e Kuvendit Komunal të Gjilanit, Valentina Bunjaku Rexhepi, e cila tha se ndihet krenare sidomos sa i përket rezultatit për Kuvendin Komunal në veçanti dhe për nivel të përgjithshëm të vlerësimit për Komunën e Gjilanit.

“E falënderoj Institutin Demokratik të Kosovës për vlerësimin objektiv që e ka bërë, duke e radhitur Gjilanin si Komunën e dytë me transparencën më të lartë në Kosovë. Unë jam krenare me rezultatet, sidomos për Kuvendin Komunal të Gjilanit që jemi të parët në Kosovë, derisa ju premtojmë se në të ardhmen do të edhe si Komunën do të jemi të parët. Ky rezultat dëshmon për punën e mirë që ne jemi duke e bërë në mënyrë të vazhdueshme për qytetarët e Gjilanit”, ka thënë zonja Bunjaku Rexhepi.

Ndryshe, muaj më parë Gjilani është zgjedhur si Komunë model në nivel vendit sa i përket qasjes në dokumente zyrtare.

